

MEDIUS

BOTIM I INSTITUTIT MEDIUS

**MEDIAT SOCIALE,
RRUGA PËR TE TJETRI,
APO VETË TJETRI?**

**POLITIKA,
PUSHTETI DHE
MEDIAT SOCIALE**

**TEKNOKULTURA
QË KOLONIZON
SHOQËRINË SHQIPTARE**

TEKNOLOGJIA SFIDAT DHE DILEMAT NË JETËN TONË

**ANA E ERRËT E
TEKNOLOGJISË**

**TEKNOLOGJIA,
EKONOMIA
DHE LIRIA E
INDIVIDIT**

syoss

THE No1 PROFESSIONAL BRAND IN RETAIL



Exclusive Group Albania distributor zyrtar i Henkel për Shqipërinë, me brande të njohura si SYOSS, Dixan, Taft, Perwoll, Gliss, Persil, Schauma, Loctite, Bref, Ceresit

ARAN Cucine Store
Blv. Gjergj Fishta, Nr 146
TIRANE, ALBANIA
☎ +355 68 2067733
✉ cucinatua@gmail.com

**OUR WORLD
INTO YOUR KITCHEN**

 **ARAN**
CUCINE
S T O R E





The Plaza Tirana 5 Star Hotel, at the city center!

Rr. 28 Nentori, Tirane AL ♦ +355 (0) 422 112 21 ♦ info@plazatirana.com ♦ www.plazatirana.com


THE
PLAZA
TIRANA
★★★★★
Excellence redefined.

MEDIUS

Sfidat e jetës teknologjike

••
Eshhtë gati e pamundur të shmangim sot debatin mbi ndryshimet që ka pësuar jeta jonë nga teknologjia, nga ritmi i komunikimit. Rrugët për te tjetri, për te dija, për te mundësia për të patur një jetë më të shëndetshme e më të gjatë, tashmë janë rrugë që gërshe-tohen të gjitha me praninë e jashtëzakonshme të fuqisë teknologjike.


Por, në fakt, cilët do të jemi ne pas disa vitesh kur teknologjia të ketë zënë një vend edhe më të madh në jetët tona? A mund të flasim njësoj për moralin, besimin, për demokracinë e, sidomos, për të vërtetën, atëherë kur robotika të jetë bërë pjesë normale e përditshmërisë? Cili do të jetë kuptimi ynë për “Veten” dhe “Tjetrin”? Përballë një realiteti ku algoritmet dhe teknologjia do të kenë krijuar “njeriun e jashtëzakonshëm”, shumë nga pikëpyetjet e derisotme, përmes të cilave kemi projektuar dhe jetuar rrrugëtimin dhe komunikimin tonë, rrezikojnë të humbin kuptimin me të cilin jemi mësuar dhe kemi ndërtuar apo rindërtuar jetët tona. Fuqia e disave që do të kenë më shumë mundësi përmes teknologjisë dhe fati i shumë të tjerëve që nuk do të kenë të njëjtat mundësi mund të krijojë hendeqe të mëdha dhe të gjithanshme, duke rrezikuar krijimin e grupeve shoqërore pa asnjë lidhje dhe interes për t’u marrë me njëri-tjetrin. Hendeku i parë është ai që përjetohet sot brenda familjeve, ku teknologjia krijon zhvendosjen e menjëhershme të kujtdo dhe prania fizike e dikujt nuk nënkupton më edhe praninë mendore e shpirtërore të tij me ata që gjenden afër tij. Në këtë aspekt, shumë prindër gjenden në një vështirësi të jashtëzakonshme për të komunikuar me fëmijët e tyre, duke ngritur pikëpyetje lidhur me të ardhmen e vetë familjes.

Ndërkohë, spektakli i ka zënë vendin meditimit, ndërsa e vërteta është transformuar në cirkun e pafundmë të aparencës. Zhgënjimi dhe trullosja kanë zënë vendin e optimizmit dhe të meditimit. Por, nga ana tjetër, arritjet në shkencë dhe në mjekësinë gjenetike, apo bioteknologjinë bujqësore, i kanë dhënë njeriut një avantazh më të madh në kohë dhe një kontroll edhe më të madh ndaj shëndetit dhe prodhimeve të gjithanshme. Komunikimi dig-jital ka shmangur shumë ecejake të njeriut duke shkurtuar distancat, ndërkohë që botime të pafundme apo komunikime shkencore arrijnë në të njëjtën kohë në mbarë globin.

E sërish... sërish kemi nevojë për shumë përgjigje. “Medius” në këtë numër, kushtuar pasojave të teknologjisë në jetët tona sot dhe në të ardhmen, ka hapur veçse një dritare të këtij debati të cilit nuk mund t’i ikim, por veçse duhet ta përballim. Ndaj, në këtë nxitim komunikimesh, ne na mbetet të gjejmë një rrugë për të kuptuar veten sot dhe dilemat mbi të ardhmen përballë një furie teknologjike që çdo ditë prodhon dhe zhvillohet...



AGIM BAÇI
 KRYEREDAKTOR



TEKNOKULTURA QË SHKATËRRON SHOQËRINË SHQIPTARE

Ergys Mërtiri **116**



132

AEROPLANË TË DRUNJTË MBI BOSFOR

Ervin Hatibi

28 TEKNOLOGJIA, EKONOMIA DHE LIRIA E INDIVIDIT Selami Xhepa



80 TEKNOETIKA, SI TEKNOLOGJI QË NUK E NDAN NJERIUN NGA ATRIBUTET E TIJ Redi Shehu



I rrethuar nga të gjitha anët me mundësi të pafundme, të cilat shkurtojnë në mënyrë të vazhdueshme pengesat dhe distancat, njeriu, sot, duket se ka nënshkruar një pakt pothuaj të përjetshëm me teknologjinë.

92 MBI POLITIKËN, PUSHTETIN DHE MEDIAT SOCIALE Ervin Muço

Ndër çështjet më të hasura në temat e lëngshmërisë së botës moderne, është thyerja e marrëdhënies midis politikës dhe pushtetit.



148 ARTI DHE TEKNOLOGJIA, HISTORIA E NJË BASHKUDHËTIMI JO EDHE AQ PAQËSOR Armand Bora




36 TEKNOLOGJIA DHE TË DHËNAT PERSONALE

Brikena Kasmi



48 LEX TEKNOLOGJIA

Fabian Zhilla



104 NË KURTHIN VRASTAR TË FRANKENSHTAJNIT Fitim Zekthi

MEDIUS

BOTIM I INSTITUTIT MEDIUS

BOTIMIT NR.02
VITI I BOTIMIT 2018

PRILL-QERSHOR 2018

KRYEREDAKTOR

Agim Baçi

BORDI EDITORIAL

Redi Shehu
Kim Mehmeti
Milazim Krasniqi
Armand Bora
Emine Sadiku
Fitim Zekthi
Ergys Mërtiri
Doan Dani
Fabian Zhilla

DESIGN

Rudin Janku

SHTYPSHKRONJA

Mediaprint

COPYRIGHT 2018

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Instituti i Komunikimit "Medius". Përbajtja nuk mund të riprodhohet, shitet ose transmetohet pa lejen e "Medius".

PER KONTAKTE

info@mediusinstitute.com



KOMUNIKIMI

Mediat sociale, rruga për te tjetri, apo vetë tjetri?

Silvana Loka

58



PASOJAT E JETËS TEKNOLOGJIKE DHE INTELIGJENCËS ARTIFICIALE

Inteligjenca artificiale mund të kthehet në shkatërrimin e vetvetes. "Përpara perspektivës së një shpërthimi të inteligjencës, ne njerëzit jemi si fëmijët e vegjël që po luajnë me një bombë.

Agim Baçi- Enkelejda Suti

8

68 ANA E ERRËT E TEKNOLOGJISË
Klementin Mile

158 TEKNOLOGJI NË KAPSULË
Ada Çapi




18 "HOMO DIGITALIS" NUK KA PSE IKËN NGA VETJA, DUHET TË GJEJË PAQEN ME VETEN
Milazim Krasniqi

Pasojat e jetës teknologjike dhe të **INTELIJENCËS ARTIFICIALE**

Inteligjenca artificiale mund të kthehet në shkatërrimin e vetvetes. **“Përpara perspektivës së një shpërthimi të inteligjencës, ne njerëzit jemi si fëmijët e vegjël që po luajnë me një bombë.** Kaq e madhe është mospërputhja ndërmjet fuqisë së lojës sonë dhe mungesës së maturisë në sjelljen tonë.


AGIM BAÇI & ENKELEDA SUTI




CDO TË NDODHË NËSE PËRZGJE-DHJA NATYRORE e deritanishme do të zëvendësohet nga dizenjimi teknologjik? Cili do të jetë ndikimi i inteligjencës artificiale mbi kulturën, ekonominë e sidomos në marrëdhëniet shoqërore? A do të kemi të njëjtat pyetje për veten, për tjetrin, për demokracinë? A do t'i besojmë sërish zemrës kur ajo të jetë një pjesë elektronike e vendosur nga jashtë në trupin tonë? A do të flasim sërish për besimin dhe moralin siç flasim sot?

Debatuesit e sotëm mbarëbotërorë mbi pasojat e teknologjisë dhe të ardhmen e inteligjencës artificiale bashkohen të paktën në një pikë - që këtyre debateve tashmë nuk mund t'u shmangemi, por vetëm se mund dhe duhet t'u paraprijmë me kërkime mbi pasojat që ka dhënë deri tani dhe për pasojat që do të ketë teknologjia mbi të ardhmen tonë, pasi përndryshe njerëzimi do të përballet me ndikime që nuk do të mund t'i kontrollojë dot.

Historiani dhe filozofi izrealit, Noah Harari, autor i librave “Sapiens” dhe “Homo Deus”, është ndër debatuesit më të zjarrtë të kësaj çështjeje duke na sjellë edhe një parashikim që nuk duhet ta nënvleftësojmë: një epokë algoritmesh dhe teknologjie të re të cilat mund të na transformojnë në ‘supernjerëz’ dhe ku ne do të tentojmë cilësi si ato të Zotit. Harari ka shtjelluar disa nga rrjedhat njerëzore në epokën e inteligjencës artificiale, duke rreshtuar çështje që mund të ndryshojnë tërësisht marrëdhëniet njerëzore. “Një algoritëm i jashtëm, që ka shumë të dhëna rreth meje dhe fuqi të madhe përpunimi kompjuterik, mund t'i kuptojë dëshirat, emocionet, mendimet, vendimet e mia, mund të kontrollojë dhe të më manipulojë mua në një shkallë të gjerë. Dhe kjo gjë fillon me gjëra shumë të vogla, me vendime shumë të thjeshta në jetë, si për shembull, se çfarë libri të blesh. Më parë, nëse ju dëshironit të blinit një libër, ju



“Historiani dhe filozofi izrealit, Noah Harari, autor i librave “Sapiens” e “Homo Deus”, është ndër debatuesit më të zjarrtë të kësaj çështjeje duke na sjellë edhe një parashikim që nuk duhet ta nënvleftësojmë: **një epokë algoritmesh dhe teknologjie të re të cilat mund të na transformojnë në ‘supernjerëz’** dhe ku ne do të tentojmë cilësi si ato të Zotit.



vareshit nga vetë ndjenjat tuaja dhe ndoshta nga rekomandimet e miqve dhe të anëtarëve të familjes, të cilët ju njihnin juve dhe shijet tuaja. Por, gjithnjë edhe më shumë, këto vendime të thjeshta, se çfarë libri të blini dhe të lexoni, do të bëhen për mua nga një algoritëm kompjuterik, si p.sh., algoritmat e Amazon-it”, shprehet Harari, duke paralajmëruar krijimin e klasave të paparashikuara komunikuese në një epokë ku inteligjenca artificiale do të marrë në dorë gjuhën e përditshmërisë. Madje, pikërisht, krijimi i një i një marrëdhënieje të tillë me inteligjencën, sipas Hararit, do të krijojë edhe një “klasë të padobishme”, pasi shumë nga punët që bën sot njeriut do të jenë të digjitalizuara. Gjithashtu, sipas Hararit, teknologjia mund të prodhojë një diskriminim të ri, që do të jetë një diskriminim jo për shkak të besimit, ngjyrës apo orientimit seksual, por

për shkak të njohjes ekstreme që do të ketë teknologjia mbi individin. “Në shekullin e XX-të, diskriminimi është përdorur kundër grupeve të tëra bazuar në disa veçori, apo paragjykime. Megjithatë, ai ishte fleksibël, sepse ato paragjykime nuk ishin të vërteta dhe viktimat mund të bashkoheshin së bashku dhe të ndërmerrnin aksione politike. Por në vitet dhe në dekadat e ardhshme ne do të përballemi me diskriminim individual dhe, me shumë mundësi, ai do të bazohet në një vlerësim të mirë të asaj që ne/ju jeni në të vërtetë”, shprehet Harari.

Pra, duke parë vetëm këtë panoramë të përshkruar nga Harari dhe debatues të tjerë të fushës, vlen të pyesim: çfarë rrezikojmë më shumë nëse i dorëzohemi inteligjencës artificiale? A ka vetëm të mira, apo njerëzimi rrezikohet më shumë nga ajo që prodhon kjo inteligjencë?



Nick Bastrom, filozof dhe profesor i Universitetit të Oxford-it, autor i librit shumë të diskutuar në rrethet shkencore, “Superinteligjenca”, shprehet se inteligjenca artificiale mund të kthehet në shkatërrimin e vetvetes. “Përpara perspektivës së një shpërthimi të inteligjencës, ne njerëzit jemi si fëmijët e vegjël që po luajnë me një bombë. Kaq e madhe është mospërputhja ndërmjet fuqisë së lojës sonë dhe mungesës së maturisë në

sjelljen tonë”, shkruan ai. Madje, edhe shkencëtari më i famshëm britanik, Stephen Hawking, që ndërroi jetë vetëm pak kohë më parë, e që komunikonte me zërin e tij sintetik që i ishte mundësuar nga një formë bazë e inteligjencës artificiale, ka qenë ndër ata që kanë folur më shumë mbi këtë çështje. “Zhvillimi i një inteligjence të plotë artificiale do të thoshte fund i rracës njerëzore,” i ka thënë ai BBC-së në një diktumim mbi këtë çështje. Ndërsa

Elon Musk, sipërmarrësi miliarder që qëndron pas Tesla Motors dhe që është një investitor aktiv në fushën e inteligjencës artificiale, ka shkruar në tweet-erin e tij: “Ja vlen të lexosh librin mbi superinteligjencën nga Bostrom. Ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm me inteligjencën artificiale. Potencialisht ajo është më e rrezikshme sesa armët bërthamore.”

Fizikani Richard Jones, Zëvendëskancelar i Kërkimit dhe Inovacionit të Uni-

MBROJTËSIT E TRANSHUMANZIMIT

Në anën e atyre që përfaqësojnë dhe mbrojnë transhumanzimin janë ata që tentojnë rritjen apo zhvillimin drejt një “personi postnjerëzor” të formatit të njohjes së sotme: ata dëshirojnë të arrijnë lartësi intelektuale mbi çdo qenie tjetër, të jenë rezistentë ndaj sëmundjeve dhe të paprekur nga plakja, të kenë rini dhe gjallëri të pakufizuar; të ushtrojnë kontroll mbi dëshirat, gjendjet e tyre të humorit dhe gjendjet mendore, të jenë në gjendje të shmangin ndjesinë e lodhjes, urrejtjes, apo shqetësimit nga gjërat e vogla, të kenë një rritje të kapacitetit të tyre për kënaqësi, dashuri, vlerësim artistik dhe qetësi; të përjetojnë gjendje të reja të vëtdijes, të cilat qeniet njerëzore ashtu siç ne i njohim sot nuk mund t’i arrijnë dot. Transhumanzimi beson në personat postnjerëzorë, që do të ishin inteligjenca artificiale sintetike, ose ato do të ishin ngarkime të fuqizuara, ose rezultat i shumë përshtatjeve të vogla të realizuara mbi një njeri biologjik. Alternativat e mëvonshme, me shumë mundësi, do të kërkonin ridizenjimin e organizmit njerëzor duke përdorur nanoteknologjinë e përparuar ose fuqizimet e saj radikale duke përdorur një kombinim të teknologjive, të tilla si inxhinjria gjenetike, psikofarmakologjia, terapitë e mosplakjes, kontrolli i trurit nëpërmjet kompjuterit, instrumente të përparuara për menaxhimin e informacionit, ilaçe për fuqizimin e kujtesës, pjesë kompjuterike të cilat mund të vishen në trupin e njeriut dhe teknika të përparuara konjitive.

versitetit të Sheffield-it, shprehet se ideja e drejtimit të botës në mënyrë sa më inteligjente ka qenë një ëndërr e hershme e njerëzimit. Por ai beson se pohimet e transhumanizmit për zhdukjen e plakjes dhe të vdekjes janë boshe, pavarësisht shumë hapave pozitivë lidhur me kurimin e sëmundjeve të rënda, sidomos në moshën e tretë. Sipas tij, robotët, software-t dhe inteligjenca artificiale mund t’i bëjnë jetët e shumë njerëzve më të lehta – ose ato mund t’i

bëjnë shumë pak njerëz shumë më të pasur, duke lënë çdo njeri tjetër në një situatë me një rritje më të madhe të pasigurisë ekonomike. “Shumë nga pohimet e transhumanizmit janë të gabuara teknikisht, rrënjët ideologjike të lëvizjes janë të dyshimta dhe qarkullimi i gjerë i këndvështrimeve transhumaniste është duke dëmtuar mënyrën se si ne flasim për teknologjinë sot”, shprehet Jones në debat me filozofin, politikanin dhe gazetarin amerikan Zoltan

Istvan, i cili nga ana e tij beson se transhumanizmi kërkon ta përdorë shkencën dhe teknologjinë për të kapërcyer vështirësitë dhe vuajtjet. “Nëse ti e do jetën dhe dëshiron ta ruash atë, dhe transhumanizmi është një filozofi e mrekullueshme dhe një lëvizje sociale për të marrë pjesë në dhe për ta përqafuar atë. Unë besoj se bota ka nevojë për transhumanizmin për të arritur sa më shumë që ai të mundet nga ekzistenca jonë e çmuar në tokë..”, shprehet

“Tani gjendemi në një ndërprerje morale ku nuk jemi gjendur kurrë më parë si specie. Në vitin 1945 ne ishim në një botë kur një vend i vetëm mund të na vriste të tërëve dhe kjo ishte SHBA-ja. Unë mendoj se ne tani **jemi në një botë ku një person i vetëm mund të na vrasë të gjithëve** dhe në të njëjtën kohë të gjithë ne mund të ndreqim çdo gjë.

Istvan, i cili e sheh debatin për transhumanzimin të lidhur ngushtësisht edhe me debatet fetare rreth kësaj çështjeje. Duke iu referuar SHBA-ve, që janë popullsi shumë fetare, Istvan shprehet se është nevoja që edhe përfaqësuesit e fesë të bëhen pjesë e debatit teknologjik, për shkak se mund të vërë në pikëpyetje jo vetëm kufijtë e vdekjes, por edhe ndryshime të rëndësishme morale të funksionimit të shoqërisë.

Ndërkaq, për Jones, është e nevojshme të jesh një transhumanist për të përdorur shkencën dhe teknologjinë që ta bësh njerëzimin më të mirë. Sipas tij, ajo që shkenca dhe teknologjia bëjnë për ne, varet nga zgjedhjet që bëjmë ne si shoqëri. “Vizionet e transhumanistëve i turbullojnë këto zgjedhje duke sugjeruar se ka vetëm një drejtim të mundshëm që teknologjia të ecë përpara”, shprehet Jones, i cili merr si shembull teknologjinë për dizenjimin e bebeve që mbështesin transhumanistët, ku pretendohet se mund të përmirësojmë specien njerëzore edhe përpara se ajo të lindë. “Shumë njerëz që e lexojnë këtë do të pyesin: kush do të vendosë se çfarë përbën përmirësim? Nga ta dimë se teknologjitë e reja do të na çojnë në më shumë begati për të gjithë sesa të na çojë në një polarizim më të madh ndërmjet atyre që kanë para dhe pushtet dhe ato që nuk i kanë këto?”, pyet Jones. Ai bashkohet me Istvan, që pranon deri diku dimensionin gjysmë fetar të transhumanizmit. Por ai shpreh dyshimet në modelin dhe qëllimin e mbështetësve.

NOAH HARARI- TOMAS FRIDMAN

Tri herë fituesi i çmimit Pulitzer, gazetari Tomas Fridman shprehet se debati i sotëm mbi teknologjinë është i domosdoshëm dhe socializimi i shoqërisë me atë që pritet të ndodhë është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Teksa rrëfen për librin e tij “Lexuesi dhe pema e ullirit”, që e shkroi pasi kishte lexuar librin e Frank Okayamas për fundin e historisë, Fridman thotë se “ajo që unë mendoj se do të formësojë të ardhmen është tensioni që do të krijohet ndërmjet të gjitha këtyre gjërave të cilat janë të vjetra në këtë botë - feja, komuniteti, sektet, fiset—dhe ndërveprimin ndërmjet tyre dhe teknologjisë”. Fridman mbështet Hararin teksa flet për çështjen e besimit në Zot në hapësirën kibernetike, një hapësirë që, sipas tij, i ka bërë njerëzit që, pa lëvizur nga një karrige, të blejnë, të shesin, të gjejnë bashkëshortin apo bashkëshorten, të blejnë shtëpi, të shkruajnë libër, të gjenerojnë lajme apo



edhe të marrin kredi, etj., etj. “Përkufizimi im për hapësirën kibernetike është që ne jemi që të gjithë të lidhur, por askush nuk mban përgjegjësi. Pra nuk ka gjykata në hapësirën kibernetike dhe ne jemi duke jetuar në një sferë, në një fushë e cila nuk ka Zot brenda. Dhe për shkak të këtyre përshpejtimeve teknologjike që ne kemi folur, ne tani gjendemi në një ndërprerje morale ku nuk jemi gjendur kurrë më parë si specie. Në vitin 1945 ne ishim në një botë kur një vend i vetëm mund të na vriste të tërëve dhe kjo ishte SHBA-ja. Unë mendoj se ne tani jemi në një botë ku një person i vetëm mund të na vrasë të gjithëve dhe në të njëjtën kohë të gjithë ne mund të ndreqim çdo gjë. Sepse për herë të parë këto përshpejtime kanë krijuar një botë ku njëri prej nesh mund të na vrasë të gjithëve dhe nëse ne e mbledhim mendjen për këtë, ne i kemi mjetet për të ushqyer, strehuar dhe veshur dhe arsimuar çdo njeri në planet”, shprehet Fridman në një bashkëbisedim me Noah Hararin lidhur me të ardhmen teknologjike. Ai thekson se gjeopolitika, etika, komuniteti dhe vendet e punës janë fushat më të prekura nga epoka digjitale. Duke theksuar thyerjen e rregullave

“ Për Jones, është e nevojshme të jesh një transhumanist për të përdorur shkencën dhe teknologjinë që ta bësh njerëzimin më të mirë. Sipas tij, ajo që shkenca dhe teknologjia bëjnë për ne, varet nga zgjedhjet që bëjmë ne si shoqëri.

KUR KA NISUR TË FUNKSIONOJË “IA”

Në një histori të shkurtrër shkruar në vitin 1942, biokimisti dhe shkrimtari Isaac Asimov ka prezantuar “Tre Ligjet e robotikës”, të cilat kanë shërbyer si një kuadër i përgjithshëm reference për debatin mbi këtë fushë që nga ajo kohë. Asimov, më vonë, shtoi edhe një ligj të katërt ose ‘zeroth’, ligjin që i kalonte gjithë të tjerat për nga rëndësia: “Një robot mund të dëmtojë njerëzimin si një të tërë, ose, nga mosveprimi, ta lejojë njerëzimin që të vijë për të dëmtuar.” Termi “inteligjencë artificiale” është shpikur në vitin 1956. Në fakt inteligjenca artificiale është bërë më e njohur sot falë rritjes së volumit të të dhënave, algoritmeve të përparuara dhe përmirësimeve në fuqinë kompjuterike të përpunimit dhe të ruajtjes së të dhënave. Kërkimet e hershme të inteligjencës artificiale në vitet 50-të të shekullit të kaluar merreshin me eksplorimin e tematikave, të tilla si zgjidhja e problemeve dhe metodat simbolike. Në vitin 1960, Departamenti i Mbrojtjes i Shteteve të Bashkuara të Amerikës filloi të interesohej në një punë të re dhe filloi trajnimin e kompjuterave për të imituar arsyetimin bazë njerëzor. Këto punë të hershme shtruan rrugën për automatizimin dhe arsyetimin formal që ne shikojmë sot te kompjuterat, duke përfshirë sistemet e mbështetjes për vendimet dhe sistemet e kërkimit, të cilat mund të dizajnohen për të plotësuar dhe rritur aftësitë njerëzore. Por, ideja e ndryshimeve që sjell komunikimi intensiv ka qenë në fokusin e sociologëve. Kështu, sociologu amerikan Harvey Sacs, në një leksion të tij në vitin 1968, duke analizuar dështimet kryesore të ëndrrave teknokratike, shprehej: “Ne kemi shpresuar gjithmonë që, vetëm në qoftë se ne do të kishim prezantuar një makinë të re fantastike komunikimi, bota do të transformohej”. Dhe epoka digjitale ka shënuar këtë transformim që Sacs e parashikoi.

morale që po përjeton shoqëria përmes jetës në hapësirën kibernetike, Fridman beson se është rikthyer domodoshmëria e familjeve të forta dhe komuniteteve të forta, për të shmangur rënien në banalitet dhe për pasojë edhe në mosbesimin e thellë ndaj gjithçkaje.

Ndërkaq historiani Harari, duke analizuar frikërat që sjell epoka digjitale, shprehet se edhe pse komunikimi teknologjik i sotëm ka rritur me shpejtësi çështjen e së

pavërtetës, apo të një vërtete që bazohet në klikime, por jo në kuptim apo në verifikim, shoqëria mund të ketë qenë gjithnjë duke jetuar një kohë “post- të vërtete”. Duke parashikuar tronditjet që janë shënuar dhe që pritet të shtohen në marrëdhëniet shoqërore, Harari bën thirrje që sociologët, psikologët dhe, padyshim, klerikët fetarë të bëhen pjesë e debatit me qëllim që teknologjia ta ndihmojë njeriun për një botë më të mirë, e jo për ta kontrolluar botën

pa njohur veten. “Nëse shikoni trajektoren afatgjatë të historisë, do të kuptoni se për mijëra vite ne njerëzit kemi qenë duke kontrolluar botën jashtë nesh për ta formësuar atë sipas dëshirave tona. Ne kemi marrë kontrollin edhe të kafshëve të tjera, të lumenjve, të pyjeve, dhe i kemi riformësuar ato tërësisht, duke shkaktuar shkatërrim mjedisor. Dhe ne prapë nuk jemi të kënaqur me këtë që kemi arritur”, shprehet Harari.

PO KU QËNDRON DOBËSIA E PREKSHME TEKNOLOGJIKE?

Familja, ekonomia, marrëdhëniet shoqërore, kultura, sportet e gjithçka tjetër ka pësuar ndryshime të rëndësishme për shkak të intensitetit që ka krijuar hapësira kibernetike. Askush nuk mund të thotë se ka të njëjtat mjete si më parë për të diksutuar më fëmijët, me familjarët. Bashkëbiseduesi yt kulturor mund të jetë një krejt i panjohur, ndërkohë që shkëmbyesi yt tregtar është veçse një numër.

Ndërkohë, bashkë me përhapjen e jashtëzakonshme të komunikimit virtual është përhapur edhe piratimi informatik. Pasoja e piratimit janë paniku që mbillet në persona të veçantë apo edhe në shoqëri të ndryshme. Jetë njerëzish ndryshojnë tërësisht për shkak se humbasin të dhënat, ndërmarrje mund të falimentojnë, ndërkohë që komunikimi global krijon pasoja krejt të paparashikueshme edhe për ndryshimet më të largëta.

Debati më i fundit që arriti në Kongresin Amerikan për Facebook-un, i cili bën fjalë për piratim dhe keqpërdorim të

dhënash, vjedhja e taksës amerikane të sigurimit shëndetësor “Anthem”, bashkë me të dhënat e 80 milionë personave, piratimi i Forbes.com për të hyrë në faqet e web-it të ndërmarrjeve të sektorit të mbrojtjes dhe të shoqërive financiare, treguan vetëm disa nga pasojat më të dukshme të pasigurisë. Duke iu referuar këtyre pasigurive të kohës teknologjike, gazeta “The Washington Post”, në një artikull të para pak kohëve mbi “pjesën e errët të teknologjisë”, shkruante se, “Ne jemi bërë të varur në një teknologji që na vendos përballë një forme të re prekshmërie të

frikshme”.

Ndërsa Tom Chatfield në një nga kolonat e tij për “BBC Future”, duke shkruar për kompleksitetin e epokës digjitale shkruante: “Nga erozioni i fshehtë i historisë digjitale, në heshtjen e teknologjisë së “zgjuar” nëpërmjet sekreteve të pista të emaile-ve dhe rëndësinë e harresës, unë dëshiroj të eksploroj tensionet midis mjeteve digjitale dhe vetvetes analoge - jo për shkak se teknologjia duhet që të anashkalohe apo të dënohet, por për shkak se ajo mbetet e zhyer në histori, politikë dhe dobësi njerëzore, si çdo gjë tjetër që ne prekim”. ■



Fizikani Richard Jones, Zëvendëskancelar i Kërkimit dhe Inovacionit të Universitetit të Sheffield-it, shprehet se idea e drejtim të botës në mënyrë sa më inteligjente ka qenë një ëndërr e hershme e njerëzimit. Por ai beson se **pohimet e transhumanizmit për zhdukjen e plakjes dhe të vdekjes janë boshe, pavarësisht shumë hapave pozitivë lidhur me kurimin e sëmundjeve të rënda, sidomos në moshën e tretë.**

“HOMO DIGITALIS”

**nuk ka pse ikën nga vetja,
duhet të gjejë paqen me veten**

Përveç nevojave e interesave, **njeriu tashmë ka edhe, thjesht, një lloj varësie psikologjike e kulturore nga kjo formë e komunikimit**, e cila ia ka zëvendësuar deri në njëfarë mase edhe nevojën për raportet familjare, për kinemanë, për teatrin, për librat dhe madje edhe për shkollën. Rrjedhimisht, ky nuk është vetëm “konsumator digjital”, si e quan Fared Zakaria, por **është bërë edhe “Homo Digitalis”**



MILAZIM KRASNIQI



KRIZA E FUNDIT QË PO KALON FACEBOOK-U, si pasojë e manipulimit me identitetin e pesëdhjetë milionë njerëzve në SHBA, nga ana e Kembrixh Analitica, në kuadër të fushatës së presidentit amerikan, Donald Tramp, ka rikthyer sërish vëmendjen e njerëzve jo vetëm të lidhur me manipulimet e kësaj natyre, por më edhe në raportin/varësinë e njerëzve nga interneti dhe produktet e tij. Ftesat për t'u shkëputur nga shërbimet e Facebook-ut kanë gjetur njëfarë përgjigjeje, por ajo është ende larg caktimit ku do të dërrmohej prestigji i Facebook-ut si rrjet global dhe varësia prej tij, për sa kohë shërbimet e tij i përfitojnë aktivisht dy miliardë e dyqind milionë njerëz.

ZBEHJA

Fared Zakaria është i mendimit se në versionet e deritashme, të monopolit dhe të qenit jashtë kontrollit të publikut, Facebook-u po edhe Google do të marrin fund pas këtyre goditjeve.

Ai mendon se masat që po merren në Bashkimin Evropian, por edhe në SHBA, madje edhe në Indi, do të sjellin një situatë të re.

“Ndryshimi po vjen dhe ai do ta transformojë botën e teknologjisë. Nëse menaxhohet si duhet, mund të prodhojë tregje më të lira dhe më shumë fuqizim të individit”, shprehet Zakaria.



KONSUMATOR DIGJITAL A “HOMO DIGITALIS”, APO TË DYJA BASHKË?

Megjithatë, në këtë pikë, mendimet janë të polarizuara. Fared Zakaria është i mendimit se në versionet e deritashme, të monopolit dhe të qenit jashtë kontrollit të publikut, Facebook-u po edhe Google do të marrin fund pas këtyre goditjeve. Ai mendon se masat që po merren në Bashkimin Evropian, po edhe në SHBA, madje edhe në Indi, do të sjellin një situatë të re. “Ndryshimi po vjen dhe ai do ta transformojë botën e teknologjisë. Nëse menaxhohet si duhet, mund të prodhojë tregje më të lira dhe më shumë fuqizim të individit”, shprehet Zakaria. Por, Mark Skot është i mendimit se “nuk ka shpëtim nga Facebook-u”, pasi ai është i mbrojtur edhe nga platforma të tjera, si Instagram dhe FacebookMessenger, që do të thotë se ngado që të sillësh, në një formë, do të kesh të bësh me Facebook-un.

Po të analizohen pasojat momentale që e kanë goditur Facebook-un, pas zbulimit të

manipulimit të kompanisë “Kembrixh Analytica” me identitetet e pesëdhjetë milionë njerëzve në SHBA, ato duken shokuese, pasi mbi gjashtëdhjetë miliardë llogaritet vlera e rënies së aksioneve. Gjithashtu disa milionë njerëz kanë hequr dorë nga Facebook-u. Por, këto janë pasoja momentale dhe të përkohshme, si një reaksion psikologjik i atyre që ndihen të zhgënjyer nga një dashuri e madhe, por së cilës janë të gatshëm t’i kthehen sërish. Fakti që së paku rreth një miliard njerëz vazhdojnë të shohin reklamën e Facebook-ut, ia ruan atij fuqinë e pacenuar edhe në të ardhmen e afërt. Pse? Për arsye se Facebook-u dhe platformat e tjera tashmë i kanë mundur njeriut një komunikim shumë më intensiv dhe informacione të cilat ia lehtësojnë punët dhe ia mundësojnë argëtimin. Përtej këtij raporti praktik, kjo formë komunikimi tashmë ka krijuar edhe një lloj varësie psikologjike e kulturore të individit nga interneti dhe nga format e komunikimit në të, njëfarë internetmanie virulente. Pra, përveç nevojave e interesave, njeriu tashmë ka edhe, thjesht,

FUQIA



Por, Mark Skot është i mendimit se “nuk ka shpëtim nga Facebook-u”, pasi ai është i mbrojtur edhe nga platforma të tjera, si Instagram dhe Facebook Messenger, që do të thotë se ngado që të sillesh, në një formë do të kesh të bësh me Facebook-un. Fakti që së paku rreth një miliard njerëz vazhdojnë të shohin reklamat e Facebook-ut, ia ruan atij fuqinë e pacenuar edhe në të ardhmen e afërt. Pse? Për arsye se Facebook-u dhe platformat e tjera tashmë i kanë mundësuar njeriut një komunikim shumë më intensiv dhe informacione të cilat ia lehtësojnë punët dhe ia mundësojnë argëtimin.

një lloj varësie psikologjike e kulturore nga kjo formë e komunikimit, e cila ia ka zëvendësuar deri në njëfarë mase edhe nevojën për raportet familjare, për kinemanë, për teatrin, për librat dhe madje edhe për shkollën. Rrjedhimisht, ky nuk është vetëm “konsumator digjital” si e quan Fared Zakaria, por është bërë edhe “Homo Digitalis”, sikundër e emërton David Patrikarakosi. Një shembull karakteristik i varësisë nga interneti është eksperimenti që pati bërë me veten e vet gazetari Paul Miller, i portalit teknologjik “The Verge”. Miller-i e kishte nisur eksperimentine tij me veten, i provokuar nga pohimet se “interneti po na bën të marrë dhe të vetmuar.” Ai thotë: “Desha të dija çka po më bënte interneti, që t’ia ktheja goditjen.” Pas një viti të plotë abstenimi, Miller konstatoi se interneti nuk ishte aspak fajtor për problemet e tij. Madje, ai ka thënë një deklaratë epike, se më mirë është të kesh në Facebook miq të rremë sesa të mos kesh miq fare. Rikthimi në aktivitetet e plota të punës e të argëtimit në internet e ka bindur se ai është Paul-i i vërtetë i cili “i përket in-

ternetit”, e jo ai Paul-i që e kalonte kohën shtrirë në krevat, gjatë agjërimit nga interneti. “E kisha në plan ta braktisja internetin, që ta njihja Paul-in e vërtetë, dhe të vija në komunikim me jetën e vërtetë, por Paul-i i vërtetë dhe bota e vërtetë janë të lidhura në mënyrë të pandashme me internetin”, ka deklaruar “zbuluesi” i vetes së vërtetë, të pandarë nga interneti. Kjo pandarësi nga interneti ilustruhet edhe me këto shifra: vetëm brenda një minute, në internet plasohen më shumë se dyqind milionë email-e, një milion e treqind mijë video në You Tube dhe shihen rreth 6 milionë faqe në Facebook. Edhe numri i aparateve me qasje në internet, tashmë është i përafërt me numrin e njerëzve që jetojnë në planetin tonë. Prandaj, njeriu i sotëm është edhe konsumator digjital, por edhe “njeri digjital”.

IKJA NGA REALITETI NUK PËRBËN KURRFARË ZGJIDHJEJE

Po qe se i besohet përvojës së një gazetari të fushës së teknologjisë së informa-

cionit dhe shifrave të tilla, zgjidhje nuk është largimi nga interneti e as nga platforma të caktuara, sepse tashmë ne i përkasim kësaj kohe e kësaj fryme. Ne thjesht nuk kemi as ku të arratisemi nga kudondodhja e internetit dhe e produkteve të tij. Sikundër dihet, njëra nga karakteristikat e postmodernizmit është ndikimi i madh i mediave në jetën e përditshme të njerëzve. Akbar Ahmedi, në studimin e tij, “Postmodernizmi dhe Islami” pohon se “postmodernizmi bashkekziston dhe përkon me epokën e medias. Në shumë drejtime të gjithanshme media është t pari qendror dinamik, Zeitgeist-i, përcaktues i postmodernizmit.” Pra, edhe po ta shikosh nga një përvojë personale si ajo e Paul Miller-it, edhe po ta shikosh nga aspekti thjesht teorik, njeriu postmodern është i varur nga mediat, nga komunikimi, nga bota shumë- ngjyrëshe virtuale, që ofrohet me anën e internetit. Me një fjalë, ikja nga ky realitet nuk përbën kurrfarë zgjidhjeje. Prandaj, zgjidhjet duhet të kërkohen në një drejtim tjetër, në gjetjen e mënyrave të duhura të ba-

shkëjetesës së dobishme e paqësore me “me veten tonë të vërtetë”, që është e varur edhe nga interneti. Në këtë kontekst, që në krye të herës, duhet të bëhen përpjekje që prirjet dhe devijimet autodestruktive dhe ato sociopatologjike të individëve dhe të grupeve sociale të luftohen e të mposhten në jetën reale, pa u dhënë mundësinë që ato të na përfaqësojnë edhe në komunikimin në internet. Luftimi i këtyre prirjeve mund të bëhet me anën e përmirësimit të moralit të individit dhe në shoqëri, me përmirësimin e arsimit publik dhe me rritjen e efikasitetit të kuadrit ligjor, përkatësisht të mbrojtjes ligjore për përdoruesit jokorrekt në komunikimin në internet. Nëse do të kishte përmirësime në këto tri drejtime: moralit, arsimit e ligjshmërisë, atëherë komunikimi në internet do të ishte më paqësor, më miqësor dhe më i dobishëm për të gjithë konsumatorët. Por, derisa të arrihen këso përmirësimesh, të cilat në botën konfuze në të cilën jetojmë tingëllojnë bukur utopike, veçmas dy të parat, kuadri ligjor mund të përshtatet e të funksionalizohet më shpejt, përfshirë këtu edhe vetërregullimin e platformave. Në këtë kontekst do të duhej që rregullimi ligjor, që ka përfshirë penalizimin e aktiviteteve terroriste në internet, të përshtatet edhe për format e tjera të komunikimit të deformuar e të dhunshëm, natyrisht në pajtim me pasojat që llogaritet se shkaktojnë. Kësisoj sulmet “ad hominem”, duke nisur që nga shpifjet, thashethemet dhe intrigat, të cilat nuk kanë vendlindje internetin,

“ Zgjidhje nuk është largimi nga interneti e as nga platforma të caktuara, sepse tashmë ne i përkasim kësaj kohe e kësaj fryme. **Ne thjesht nuk kemi as ku të arratisemi nga kudondodhja e internetit dhe e produkteve të tij.** Sikundër dihet, njëra nga karakteristikat e postmodernizmit është ndikimi i madh i medieve në jetën e përditshme të njerëzve



duhet të marrin një përgjigje konkrete ligjore. Ndonëse ato kanë ekzistuar që kur mbahet mend dhe kanë prodhuar çrregullime në komunikim dhe në raportet ndërmjet njerëzve, tash në internet janë më të strukturuar, më të orkestruara, të planifikuara, e jo si shpërthim emocional i momentit. Si të tilla, ato kanë më shumë fuqi rrënuese mbi jetën e individëve, që bëhen cak i sulmeve të kësaj natyre. Fushatat denigruese e linçuese në internet, veçmas në Facebook, përngja efektet propaganduese, u konkurrojnë histerizmave të dikurshme bizantine, programeve propagandistike bolshevike dhe poshtërimeve publike të realizuara në kuadër të Revolucionit Kulturor Kinez. Këto fushata denigruese e linçuese, sot për sot, nuk shoqërohen me ngulje në hunj, me copëtim gjymtyrësh me karroca, me tërheqje zvarrë shesheve, por shoqërohen me thyerje shpirtërore të viktimave. Nëse nuk i vihet një digë kësaj forme të re të shpërthimeve

histerike kolektive që atakojnë shpirtin e njeriut, një ditë mund të ndodhin edhe linçimet dhe pogromet fizike. Është shumë ilustrues rasti i cicerones Lindsey Stone, e cila për një publikim të një fotoje, ku vuri paksa në lojë patriotizmin amerikan, duke bërë foto pranë flamurit e veteranëve me gishtin e mesëm të ngritur lart, nga turma e padukshme, por shumë histerike e Facebook-ut, u shpall armiku numër një i shtetit në SHBA. Pas asaj fushate ajo u përjashtua edhe nga puna e iu ekspozua për një kohë sulmeve ditore në jetën sociale, gjë që e futi në një depresion të rëndë, pra thjesht e sëmurën. Por nuk është as i vetmi dhe as më dramatik. Me mijëra njerëz u ekspozohen çdo ditë sulmeve dhe etiketimeve të shëmtuara, veçmas në Facebook, pa pasur mundësi të mbrohen, të shpjegohen përballë turmave të padukshme histerike, që dinë të bëjnë edhe thirrje për



Ata kanë shkallë minimale konfliktualiteti në jetën reale, ndërsa e forcojnë atë në komunikimin virtual dhe, nga ana tjetër, për shkak të moshës, i menaxhojnë me shumë vështirësi pasojat e komunikimit të dhunshëm në internet. Prandaj, **bullizmi është bërë më shqetësues për shkak të pasojave, nganjëherë fatale, që shkakton te fëmijët dhe adoleshentët.**

vrasje. Personalisht, kam qenë disa herë cak i fushatave brutale në Facebook dhe e di se sa e rëndë është kur brenda pak orësh të etiketojnë si “tradhtar”, “terrorist”, “mbetje orientale” ose “racist.” Madje, në rastin e fundit, kur më shpallën racist për një sintagmë të nxjerrë qëllimisht nga konteksti (“bijtë e shkinave”), fushata historike e filluar në Facebook u bart në portale e në televizione, por mbeti vetëm në botën virtuale e mediale. Pas fushatës disaditore, një grup personash, të shoqëruar nga kamera e një medieje elektronike me frekuencë nacionale në Kosovë, erdhën për të më sulmuar edhe fizikisht në orën e leksioneve me studentë në universitetin më të rëndësishëm publik në Kosovë. Ishte ndjenjë shumë e rëndë të dilje nga leksioni e të të dërgonte policia në banesë me mbrojtje të afërt, për shkak se ishe i kërcënuar fizikisht. Sulmet e filluara në Facebook kishin arritur të shndërroheshin në një lloj uragani dhe po të synonin të ktheheshin në sulm fizik. Rasti ka vite që është në gjykatë, ende nuk e ka marrë epilogun, ndonëse personalisht kam vendosur t’i fal ata prishës të rendit kurdo që të mbahet ajo seancë gjyqësore, sepse thjesht edhe ata kanë qenë viktimat të indok-

trinimit të imponuar nga grupime parapolitike anarkiste, që i kanë keqpërdorur jo vetëm ata, po edhe rrjetet sociale e mediat e reja dhe vizive. Pra, konflikti edhe në këtë rast ka ekzistuar në jetën reale, e nuk ka qenë produkt original i komunikimit në rrjete shoqërore e në media, por Facebook-u dhe mediet e tjera i kanë bërë më të forta dhe më kërcënuese ulërimat. (Ndoshta edhe mbi këtë përvojë, njërin nga librat e mi, botim vetëm elektronik, e kam titulluar “Hipopodromedia- Rikthimi i ulërimave të hipodromit”).)

BULLIZMI, VAMPINGU, FRIKA DHE PANIKU

Përderisa te të rriturit konfliktet janë më të forta në jetën reale dhe ato pastaj i sforcojnë ulërimat në jetën virtuale, problem më alarmant në internet, madje më shumë si produkt i tij, sesa i jetës reale, paraqet përdorimi i komunikimit të dhunshëm ndërmjet fëmijëve. Ata kanë shkallë minimale konfliktualiteti në jetën reale, ndërsa e forcojnë atë në komunikimin virtual dhe, nga ana tjetër, për shkak të moshës, i menaxhojnë me shumë vështirësi pasojat e komunikimit të dhunshëm në internet. Prandaj, bullizmi është



bërë më shqetësues për shkak të pasojave, nganjëherë fatale, që shkakton te fëmijët dhe adoleshentët. Kjo ndodh sepse, sipas disa hulumtimeve, ndër të cilat më i rëndësishmi është ai që është realizuar nga Digital Lives, me kërkesë të Google dhe të Vodafone, moshat e reja nuk e ndajnë qartësisht botën reale nga bota virtuale. Mbase, për këtë arsye, ata edhe sulmet në komunikimin virtual i përjetojnë si të ishin sulme në jetën reale, gjë që shkakton frikë e panik. Edhe vampingu, si një fenomen i ri, që ka të bëjë me të rinjtë që rrinë natën vonë të angazhuar në rrjete sociale, për t'u dukur më "in" në raport me bashkëmoshatarët, e ka brenda vetes tharmin e të përjetuarit të botës virtuale si botë reale dhe rrezikun që varësia nga interneti të bëhet patologjike. Natyrisht edhe kjo ka të bëjë me një shkallë tjetërsimi në jetën reale, që nga familja, shkolla e bashkësia, sepse po të mos kishin atë shkallë tjetërsimi në raport me jetën konkrete dhe me shoqërinë, ata nuk do të investonin gjithë energjinë, përkatësisht entropinë e tyre, në komunikimin vampingist në rrjetet

sociale. Por, varësia prej vampingut pastaj ua shumëfishon pasojat. Çështja bëhet edhe më dramatike po të kihet parasysh se tjetërsimi në jetën reale familjare, shkollore e shoqërore, përveç bullizmit e vampingut, ka rrezik të provokojë edhe përqafimin të ideve apokaliptike të ekstremizmit dhe të terrorizmit. Edhe në këtë rast, tjetërsimi në jetën reale është shkak i fillestarit të orientimit drejt ideve ekstremiste dhe veprimeve terroriste, por interneti dhe platformat e komunikimit në të mund t'i bëjnë më virulente sjelljet e tyre.

Duhet të kihet parasysh se në të gjitha rastet e tilla nuk është fjala për "homo digitalis"-in e vërtetë, por për një lloj revanshi ndaj tij. Fshehja pas profileve të rreme, pas identiteteve të rreme e stimulon manifestimin e destruktivitetit në komunikim, ndaj për këtë arsye rrjetet sociale, por edhe mediat e reja, duhet të nxjerrin rregulla që eliminojnë tërësisht këtë mënyrë të fshehjes së identiteteve. Edhe pse nuk janë bërë hulumtime në këtë drejtim, është e mundshme që njerëzit frikacakë e ata me



prirje për çrregullime mendore t'i përdorin këto maskime më shumë sesa të tjerët, ashtu sikundër që, pikërisht, të tillët të jenë më të ekspozuar ndaj rreziqeve për t'u atakuar nga idetë ekstremiste.

“NJERIU I RI SOCIALIST”, SI NJERIU I SHPIFUR DIGJITAL

Lidhur me manifestimin e destruktivitetit në komunikim, me anën e identiteteve të rreme, nëpërmjet keqcitimeve, shpifjeve, thashethemeve dhe intrigave, në rastin tonë shqiptar ia vlen të merret në konsideratë edhe trashëgimia nga e kaluara, e cila është mjaft e lidhur me oralitetin dhe anonimitetin. Informata e bartur nga goja në gojë e nga veshi në vesh, e shndërruar në keqcitim, perifraxim dhe deformim të mesazhit, përshkon

historinë më të gjatë të komunikimit ndërmjet nesh, shqiptarëve. Komunikimet e kësaj natyre nuk kanë pasur autorë, nuk kanë pasur adresë, kështu që për një ngjarje janë krijuar vazhdimisht më shumë versione, më shumë motërzime, duke e relativizuar dhe maskuar të vërtetën. Ky ka qenë diskursi dominant ndër shekuj, por është prezent edhe në ditët tona dhe jo pa ndikim edhe në komunikimin në internet. Marshall McLlluhani ka gjetur se te popujt që e kanë përdorur shkrimin më herët, është përfutur një komunikim më preciz, më standard sesa te popujt ku ka dominuar komunikimi oral. Në të ardhmen duhet të hulumtohet se si përkthehet ajo përvojë në komunikimin në internet, veçmas në rastin tonë, të shqiptarëve, ku analfabetizimi i masave ka përkuar fillimisht me



komunizmin dhe, së voni, edhe me përhapjen e internetit. Sa është bartur ajo prirje e keqcitimeve, e deformimit të mesazhit, e denoncimit, e thashethemnajës dhe e relativizimit të së vërtetës, e cila ka qenë e sedimentuar nga komunikimi oral dhe nga ideologjia komuniste në komunikimin digjital? Është pyetje e mirë, por duhet të presë ende për një përgjigje të qartë. Sidoqoftë, njeriu shqiptar, i dalë nga komunikimi mijërvjeçar oral dhe nga regjimi gjysmëshekullor komunist e i futur befas në komunikimin digjital, është konkret dhe nuk ka kaluar nëpër ndonjë proces transformimi signifikant, as moral, as arsimor, as ligjor. Madje, ky është njeri edhe me trashëgiminë autodestruktive bizantine, me trashëgiminë cubnore e ka-

nunore provinciale, njeriu me sedimente të mentalitetit sllav dhe njeriu me tjetërsimin moral e ideologjik të projektit të “njeriut të ri socialist”. Kjo sajësë, tash, është shndërruar mekanikisht në “njeri digjital”. Platformat e komunikimit digjital i mundësojnë atij të shprehë edhe të gjitha frustrimet, meritë, urrejtjet, krahas ëndrrave, iluzioneve, idealeve dhe vlerave. Kakofonia, në formë të krizës postmoderniste mbi identitetin social, fetar e nacional, ekziston brenda tij. Mungesa e subtilitetit dhe e imagjinatës bën që të shprehë më shumë të parat sesa të dytat. Këtu jemi. Në të ardhmen interneti mund të përdoret që ta arrijmë transformimin moral, arsimor e ligjor, rrjedhimisht që të gjejmë akordin me kohën kur jetojmë dhe paqen me veten, pa pasur nevojë të ikim prej vetes. Por, nëse interneti nuk përdoret në këtë drejtim, ai do ta stimulojë edhe më shumë autodestruksionin me prejardhje bizantine, cubninë me prejardhje kanunore dhe imoralitetin me prejardhje komuniste. Në vend që të kontribuojë në transformim, mund të ndikojë në shtimin e virulencës së atyre veseve edhe më shumë sesa sot. Pra, nëse duhet të iket nga ndonjë gjë, duhet të iket nga trashëgimia kobzezë e autodestruksionit bizantin, e rebelizmit kanunor dhe e çmoralizimit komunist. Më saktë, duhet të shkëputemi nga trashëgimia e hidhur. Jo nga e tashmja, jo nga vlerat e saj. Pra, duhet të gjejmë paqen, duke synuar paqen me veten, si stadin final të vetërealizimit. ■



Informata e bartur nga goja në gojë e nga veshi në vesh, e shndërruar në keqcitim, perfrazim dhe deformim të mesazhit, përshkon historinë më të gjatë të komunikimit ndërmjet nesh, shqiptarëve.

Komunikimet e kësaj natyre nuk kanë pasur autorë, nuk kanë pasur adresë, kështu që për një ngjarje janë krijuar vazhdimisht më shumë versione, më shumë motërzime, duke e relativizuar dhe maskuar të vërtetën.

Teknologjia, EKONOMIA dhe liria e individit

Në qoftë se Revolucioni i Parë Industrial krijoi klasën e proletariatit marksist, e cila prodhoi historinë sociale dhe politike në shekujt e nëntëmbëdhjetë dhe njëzetë, gjasat janë që **Revolucioni i Katërt do të prodhojë klasën e të papunësueshmëve.**



SELAMI XHEPA*

NJERËZIMI KA NDËRVEPRUAR GJITHNJË ME TEKNOLOGJINË, madje që në kohët e lashta. E veçanta e fillimit të Revolucionit Industrial në fundin e shekullit të tetëmbëdhjetë ishte se shpejtësia me të cilën përparimi teknik e teknologjik po revolucionarizonte jo vetëm marrëdhëniet midis prodhuesve, furnizuesve dhe konsumatorëve, duke shënuar kështu lindjen e një ekonomie të re, por edhe se transformoi në një mënyrë të paimagjinueshme të gjithë sistemin e marrëdhënieve njerëzore dhe të vlerave të shoqërisë. Që nga ajo kohë, bota ka ndryshuar me një shpejtësi të frikshme. Gjatë dy shekujve në vijim bota ka lëvizur nga epoka e përdorimit të ujit dhe avullit në




përdorimin e energjisë elektrike si burim lëvizjeje dhe më pas në përdorimin e teknologjive elektronike dhe të informacionit në automatizimin e proceseve të prodhimit. Por, që nga fundi i shekullit të njëzetë kemi hyrë në epokën e ekonomisë digjitale që, siç e thotë profesor Schwab, po i shkrin ndarjet midis sferave fizike, biologjike dhe digjitale. Për fat, tranzicioni nga një epokë në tjetrën është shoqëruar me një progres material të paprecedentë në historinë njerëzore.

Në sajë të këtij progresi material të pashoq, koncepti i nevojave konsumatore, gjithashtu, nuk ka njohur kufij. Ekonomisti amerikan Galbraith e shikonte me shqetësim këtë rritje të pacak të shoqërisë së

konsumit. Për më tepër, firmat, më shumë se plotësimin e kënaqësisë konsumatore, duket se kanë synuar të manipulojnë konsumatorin duke krijuar nevoja të paqena nëpërmjet marketingut dhe reklamës manipuluese. Sovraniteti konsumator presupozon se janë konsumatorët ata që vendosin se çfarë duhet të prodhojnë firmat. Në fakt, shkakësia duket se ndjek drejtimin e kundërt: janë firmat që sundojnë mbi konsumatorët duke u shërbyer nevojave të shitjeve të veta. Krijimi i nevojave të paqena sigurisht që krijon një problem shoqëror pasi konsumon burimet ekonomike të kufizuara të planetit në qëllime që nuk janë shoqërisht të dobishme. Ai bënte thirrje që

INDRUSTRIA 4.0

Revolucioni industrial nxiti një sistem vlerash të përfaqësuara nga kreativiteti dhe sipërmarrja, inovacioni dhe risitë. Mënyra jonë e jetesës, sistemet e vlerave dhe vetë ideologjitë kanë ndryshuar gjithashtu. I tillë ishte, për shembull, triumfi i kejnsonianizmit dhe më pas i monetarizmit dhe ekonomisë liberal neoklasik. Me fillimin e këtij shekulli, qartazi, janë shfaqur tiparet e një bote të re, një bote virtuale ku kufijtë e botës fizike po shuhen, ku ndërveprimi njerëzor po zëvendësohet nga ndërveprimi i rrjeteve. Në fushën e ekonomisë, lindja e industrisë 4.0 lidhet me “smart factory”, ku mund të zhvillohet një kopje virtuale e botës fizike dhe vendimmarrjes së decentralizuar .




qeveritë duhet t'i kontrollojnë aktivitete të tilla, por logjika e tregut edhe në këto raste mund të veprojë si një rregullator edhe më efektiv. Galbraith është i njohur si një ekonomist intervencionist në ekonomi. Thuhet, madje, se kur ish-Presidenti Truman po kërkonte një ekonomist për këshilltar që të merrej me rregullimin e pagave dhe çmimeve, pasi i kishte telefonuar Galbraith, ky i ishte përgjigjur” - Po ju keni një duzinë me ekonomistë shumë të mirënë fushën e çmi-

meve dhe pagave. - E di, drejtin, por asnjëri prej tyre nuk pranon ta kryejë këtë detyrë”, i ishte përgjigjur Presidenti, dhe kështu Galbraith do të bëhej këshilltari që do të promovonte gjithnjë e më shumë idetë për një qeveri të madhe dhe kufizimine konsumit.

Krijimi i shoqërisë së bollëkut ka sjellë me vete dhe një sërë problemesh të menaxhimit të tij, që po rezultojnë të paktën po aq serioze sa dhe menaxhimi i urisë, i varfërisë dhe i rrallësisë. Pyetjet që shtro-

REVOLUCIONI INDUSTRIAL

TRANSFORMIMI I INDUSTRISË DHE INOVACIONI



heshin dikur se “si të shpëtojmë nga uria dhe varfëria” kishin një përgjigje të thjeshtë, “duke punuar dhe prodhuar më shumë”. Ndërsa pyetjeve të tanishme, se si të shpëtojmë nga kurthi bollëkut, duket se janë më të vështira që t’iu përgjigjesh. Shpresat (ndoshta të vetme) mbeten te një faktor themelor: teknologjia. Ekonomistë dhe filozofë të mëdhenj të dijes, që nga David Ricardo dhe Malthus, nga Marksi te Piketty, përvijuan një të ardhme shqetësuese për


shoqërinë njerëzore. Një rritje ekonomike stanjante, shoqëruar me rritjen shpërthyes të popullsisë, do të prodhonin një të ardhme të pasigurt për njerëzimin. Fatmirësisht asnjë nga profecitë e tyre nuk është përmbushur dhe arsyeja kryesore është se asnjëri prej tyre nuk kishte arritur të parashikonte forcën me të cilën teknologjia do të thyente çdo barrierë ndaj zhvillimit. Kjo transformoi në mënyrë rrënjësore dhe vetë shoqërinë, sistemin politik dhe shoqëror,

BRENDA VITIT

2033

NË SHBA
RREZIKOJNË TË
ZHDUKEN

47%

e vendeve të
punës dhe ato
të kryhen nga
algoritmet
kompjuterike.

vlerat dhe normat. Revolucioni industrial nxiti një sistem vlerash të përfaqësuara nga kreativiteti dhe sipërmarrja, inovacioni dhe risitë. Mënyra jonë e jetesës, sistemet e vlerave dhe vetë ideologjitë kanë ndryshuar gjithashtu. I tillë ishte, për shembull, triumfi i kejnsonianizmit dhe më pas i monetarizmit dhe ekonomiksit liberal neoklasik.

Me fillimin e këtij shekulli, qartazi, janë shfaqur tiparet e një bote të re, një bote virtuale ku kufijtë e botës fizike po shuhen, ku

ndërveprimi njerëzor po zëvendësohet nga ndërveprimi i rrjeteve. Në fushën e ekonomisë, lindja e industrisë 4.0 lidhet me “smart factory”, ku mund të zhvillohet një kopje virtuale e botës fizike dhe vendim-marrjes së decentralizuar (Buhr, 2015). Sistemet fizike mund të koeporojnë dhe komunikojmë midis tyre dhe me ne humanët në kohë reale, e gjitha e mundur nga shërbimet që ofrohen nga platformat e Internetit të Gjërave (IoT). Kjo do të



thotë se konektiviteti, në sajë të përdorimit të IoT, do të zëvendësojë sistemin e kapitalit në formën e vet tradicionale, duke shkuar drejt kostove marzhinale zero, një prirje e konfirmuar nga kërkuesit (Rifkin, 2017). Ky term i ri lindi nga industria gjermane dhe u përkrah e u mbështet fuqimisht nga qeveria. Ato ishin në kërkim të mënyrave të monitorimit inteligjent të proceseve të prodhimit me qëllim që të ndihmonin vendimmarrjen dhe mirëmbajtjen e teknolog-



Midis një morie faktorësh që e bëjnë Industry 4.0 një ngjarje revolucionare, ndoshta më i rëndësishmi qëndron në faktin se konsumatori vihet në qendër të sistemit pasi produktet mund të krijohen bazuar në preferencat individuale të tij. Konsumatori bëhet një bashkëprodhues.

jive, duke reduktuar kostot dhe rritur konkureshmërinë e industrive të tyre. Kjo sot është adoptuar si një filozofi në të gjithë industrinë europiane. Midis një morie faktorësh që e bëjnë Industry 4.0 një ngjarje revolucionare, ndoshta më i rëndësishmi qëndron në faktin se konsumatori vihet në qendër të sistemit pasi produktet mund të krijohen bazuar në preferencat individuale të tij. Konsumatori bëhet një bashkëprodhues. Në fakt, e gjithë qenia njerëzore vihet në qendër të sistemit prodhues, edhe vetë punëtorët e fabrikës. Punëtorët do të alokohen atje ku kërkohet ndihmë, si dhe një kërkesë më e lartë do të krijohet për aftësi profesionale në menaxhimin e projekteve komplekse. Ky progres teknologjik jep shpresë se dhe çështjet e mjedisit dhe tështerimit të burimeve do të marrin një zgjidhje të përshtatshme. Edhe vetë kërkimi shkencor mbi zgjidhjen e problemeve të ekonomisë dhe shoqërisë do të jetë më ndihmues. Për ta ilustruar idenë: ne vazhdojmë ta masim fenomenin e inflacionit, një kategori ekonomike shumë e rëndësishme për politikat ekonomike dhe sociale, në mënyrën tradicionale të “shportës përfaqësuese” të mallrave dhe shërbimeve. Në kushtet e shkallës shumë të lartë të diversifikimit të produkteve dhe perspektivës së kalimit drejt produktit personal të konsumatorit, kjo teknikë e matjes së infla-

“ **Problemi është se si vendi do të mund të ballafaqohet me këtë paradigmë të re ekonomike që po vjen shumë shpejt:** se si bizneset mund t’i mbijetojnë kësaj formë të re të konkurrencës; si do të mundet të ruajmë dhe të krijojmë vendet e reja të punës për këto sisteme të reja prodhimi dhe tregtimi; si të gjejmë vendin tonë në këtë realitet të ri të zinxhirit global të prodhimit kur ne akoma nuk kemi arritur të jemi pjesë as edhe e zinxhirit tradicional në marrëdhëniet furnizues-prodhues-konsumator. Pjesa tjetër e transformimeve shoqërore dhe kërcënimi i individit në raport me lirinë janë çështje që nuk presin ndonjë zgjidhje prej nesh, vetëm.

cionit është shumë e vjetëruar. Ndërkohë që të dhënat mbi shitjet nga rrjeti tregtoresh apo supermerkatave është i disponueshëm (metadata). Pikërisht nga ky pool i big data ne mund të përpunojmë të dhënat reale për të matur gjendjen dhe dinamikat e çmimeve të mallrave në ekonomi. Një projekt i tillë i nisur së fundmi nga Massachusetts Institute of Technology (MIT), për shembull, po studion kalimin nga indikator i CPI (consumers price index) tek DPI (digital price index). Moria e pafund e të dhënave, së bashku me inteligjencën artificiale gjithnjë e më të sofistikuar, do të ndryshojnë të gjithë mënyrën se si operon shoqëria, duke dhënë përgjigje të reja novatore problemeve që sot ne vazhdojmë t’i adresojmë me mënyrën tonë tradicionale. Problemet e shëndetit, të edukimit, të sipërmarrjes dhe prodhimit, madje edhe vetë institucionet demokratike të shoqërisë do të marrin zgjidhje të reja në sajë të adoptimit të një qasjeje më holistike që do të mundësojnë teknologjitë e reja. Nëse edukimi, në konceptin tradicional, për shembull, përfshinte një periudhë të mësuarit dhe pastaj zbatimin e dijeve në praktikë, tani do të duhet të rizbulojmë vetveten në

çdo moment të jetës. Të mësuarit është një çështje e gjithë jetës, prandaj dhe kurrikula mësimore duhet të mendojë seriozisht të kërkojë qasje të reja inovative.

Por, edhe pasiguritë dhe rreziqet që pozon Revolucioni i Katërt Industrial janë të mëdha. Ne veçanti, “cyber security” për proceset e prodhimit, humbja masive e vendeve të punës për shkak të automatizimit dhe cyber crime në shoqëri do të rriten eksponencialisht. Një invazion algoritmik të vendeve të punës e quan profesor Harari (Homo Deus) kërcënimin e këtij revolucioni teknologjik ndaj tregut të punës. Dy profesorë të Universitetit të Oxford-it bënë një kërkim (2013) mbi të ardhmen e tregut të punës (The future of work) dhe rezultati ishte se, brenda vitit 2033, 47% e vendeve të punës në SHBA rrezikojnë të zhduken dhe të kryhen nga algoritmet kompjuterike. Në qoftë se Revolucioni i Parë Industrial krijoi klasën e proletarietit marksist, e cila prodhoi historinë sociale dhe politike në shekujt e nëntëmbëdhjetë dhe njëzet, gjasat janë që Revolucioni i Katërt do të prodhojë klasën e të papunësueshmëve. Një kompani nga Hong Kongu kishte emëruar në vitin 2014



në bordin e vet drejtues një algoritëm të quajtur VITAL, i cili voton si të gjithë anëtarët e tjerë të bordit. Rezultatet tregojnë se algoritmi kishte kapur, të paktën, një aspekt të votimit nga humanët: nepotizmin. Edhe detyrat e larta menaxheriale mund të pushohen nga algoritmi! Individualizmi, e për pasojë liberalizmi, është në rrezik gjithashtu. Qeniet njerëzore sot njihen më mirë nga algoritmet e Facebook-ut sesa nga komuniteti ku jeton individ, madje dhe nga vetë familja. Gjasat e një realiteti orwellian të paimagjinueshëm në raport me racën tonë njerëzore pritet të shfaqen në të ardhmen e afërt dhe ku vetë liria e individit do të jetë kryqëzuar në një rrjet kompjuterik të pakontrollueshëm. Që tani kanë filluar të shfaqen, gjithnjë e më fort, fenomenet e humbjes së privatësisë dhe bashkë me të edhe të lirisë së

individit. E ardhmja pritet të jetë edhe më dominuese për individin nga teknologjia.

Problemi është se si vendi do të mund të ballafaqohet me këtë paradigmë të re ekonomike që po vjen shumë shpejt: se si bizneset mund t'i mbijetojnë kësaj forme të re të konkurrencës; si do të mundet të ruajmë dhe të krijojmë vendet e reja të punës për këto sisteme të reja prodhimi dhe tregtimi; si të gjejmë vendin tonë në këtë realitet të ri të zinxhirit global të prodhimit kur ne akoma nuk kemi arritur të jemi pjesë as edhe e zinxhirit tradicional në marrëdhëniet furnizues-prodhues-konsumator. Pjesa tjetër e transformimeve shoqërore dhe kërcënimet e individit në raport me lirinë janë çështje që nuk presin ndonjë zgjidhje prej nesh, vetëm. ■

***President i
Institutit European Pashko**

TEKNOLOGJIA dhe të dhënat personale

Nëse interneti do të rregullohet si uji apo transporti publik dhe do të konsiderohet shërbim publik, kjo do të ngadalësonte zhvillimin inovator dhe kompanitë kryesore do të humbisnin interesin për progres. Por, **shpërndarja e informacionit, prej kohësh, që në fillim të viteve 1990, ka sjellë, së bashku me avantazhet dhe përfitimet, edhe shqetësimin e cenimit të jetës private.**



AV. DR. BRIKENA KASMI



NË ERËN DIGJITALE, TEKNOLOGJIA, për garantimin e një shërbimi ecën me ritme më të shpejta se hartimi i legjislacionit shoqëruës. E kemi fjalën këtu dhe për sfidën e legjislacionit për t'iu përshtatur kërkesave të sistemeve të ndryshme teknologjike. Çështja “Delfi kundër Estonisë”, e ndryshme nga paraardhëset Google, L’Oreal, Ebay, ka prodhuar një debat sfidë për avokatët e medias. Ky debat konsiston në ndarjen e roleve dhe funksioneve të lirisë së shprehjes në funksion të një media të lirë dhe të pavarur, si dhe tregtimit në internet të informacioneve të ndryshme. Nga njëra anë, portali në internet i një gazete është shërbim mediatik i një shoqërie informacioni dhe nga ana tjetër, është një shërbim thjesht transmetimi të informacionit nga përdoruesit të publiku ISISP (Internet Society

Information Service Provider).

Facebook, Twitter, Insta, AirBNB, Google Home MINI apo Amazon Echo Dot janë platformat më të reja të shpikura nga njerëzimi, funksioni i parë i të cilëve është plotësimi i nevojave të publikut për komunikim, ndërveprim, opinione, blerje, socializim, etj.

Bashkë me plotësimin e nevojave, këto shpikje paraqesin sfidën e rregullimit ligjor për të shmangur cenimin e të drejtave themelore të individit. Rregullimi ligjor si funksion parësor ka kufizimin e ushtrimit arbitrar të pushtetit nëpërmjet ligjeve të mirëpërcaktuara dhe të miratuara paraprakisht. Aktualisht profesorët e shquar të së drejtës së medias janë përfshirë në debatin juridik që ndryshe quhet ‘paanshmëria e rrjetit’. Debatu filloi nga profesori i universitetit të Kolumbias, Tim Wu, i cili përcakttoi shërbimin e internetit si një shërbim publik informacioni. Sipas tij, shërbimi i internetit është i ngjashëm me shërbimin e ujit, të gazit, telefonisë, transportit. Ky gjykim e shtyu rregullatorin amerikan (FCC) që në 2015-ën të miratonte rregulla të detyrueshme për paanshmërinë e rrjetit. Rregullat kërkonin nga ofruesit e shërbimit të internetit dhe/apo me bandë të gjerë që të mos kufizonin dhe të trajtonin njësoj të gjitha informacionet, videot, lojërat, komentet apo çdo përmbajtje që ngarkohej dhe/apo transmetohej në internet. Subjekt i ankimeve të vazhdueshme për këto rregulla ishin kompanitë e fuqishme të shpërndarjes së internetit me bandë të



PAANSHMËRIA E RRJETIT

Facebook, Twitter, Insta, AirBNB, Google Home MINI apo Amazon Echo Dot janë platformat më të reja të shpikura nga njerëzimi, funksioni i parë i të cilave është plotësimi i nevojave të publikut për komunikim, ndërveprim, opinione, blerje, socializim, etj. Bashkë me plotësimin e nevojave, këto shpikje paraqesin sfidën e rregullimit ligjor për të shmangur cenimin e të drejtave themelore të individit. Rregullimi ligjor si funksion parësor ka kufizimin e ushtrimit arbitrar të pushtetit nëpërmjet ligjeve të mirëpërcaktuara dhe të miratuara paraprakisht. Aktualisht profesorët e shquar të së drejtës së medias janë përfshirë në debatin juridik që ndryshe quhet ‘paanshmëria e rrjetit’.

gjerë, si Verizon Wireless për ngadalësimin e videove në Netflix apo Youtube, AT&T për ngadalësimin e FaceTime, Comcast për ngadalësimin e P2P, etj.

Paanshmëria e rrjetit u sfidua në fundin e vitit 2017 për shkak të pretendimeve në lidhje me komentet e identiteteve të rreme në internet. Kundërshtarët kryesorë të ‘paanshmërisë së rrjetit’ mbështetën argumentet në favor të konkurrencës së lirë dhe zhvillimit inovator. Nëse interneti do të rregullohet si uji apo transporti publik dhe do të konsiderohet shërbim publik, kjo do të ngadalësonte zhvillimin inovator dhe kompanitë kryesore do të humbisnin interesin për progres. Por, shpërndarja e informacionit, prej kohësh, që në fillim të viteve 1990, ka sjellë, së bashku me avantazhet, dhe përfitimet, edhe shqetësimin e cenimit të jetës private.

Nga njëra anë, shpikjet inovatore ndihmojnë në lirinë e shprehjes dhe forcimin e konkurrueshmërisë në biznesin e kompanive të informacionit (medias) dhe nga ana tjetër zhvillimi i vrullshëm i teknologjisë përbën një

risk potencial për respektimin e jetës private, si dhe të shkeljes së të dhënave personale. Doktrina ka pranuar dhe legjislacioni ka rregulluar se “Liria e shprehjes nuk është një e drejtë absolute”. Jurisprudenca e GJEDNJ-së ka theksuar gjithmonë rolin e kësaj të drejte në raport me respektimin e të drejtave të tjera. Disa nga të drejtat e tjera që kufizojnë zbatimin e lirisë së shprehjes, përveç së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare, janë: “e drejta për një proces të rregullt gjyqësor; e drejta e pronës; rregullimi i tregut, i infrastrukturës së shërbimit të medias; rregullimet përmbajtjesore sipas mjeteve të ndryshme të medias; rregullimet e profesionit të gazetarit; mosdiskriminimi; e drejta e jetës; apo e drejta për t’u organizuar”.

Respektimi i jetës private e familjare përbën një nga kufizimet më të shpeshta të lirisë së shprehjes. Në disa sisteme ligjore ky kufizim është i shprehur në ligj. Ndërkohë që parashikimet e përgjithshme të kufizimit i gjejmë të shprehura në ligj, zbatimin e tyre në praktikë e gjejmë të konso-

NENI 8 I KENDJ-SË

“1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.”

liduar në jurisprudencën e gjykatave. Në sistemin evropian, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka shpjeguar në arsyetimet e vendimeve të saj rastet e kufizimit të lirisë së shprehjes në përputhje me nenin 10 dhe përparësinë që ka respektimi i jetës familjare dhe private në përputhje me nenin 8 të Konventës.

Neni 8 i KENDJ-së parashikon se:

“1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit

publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.”

Gjykata, në formimin e jurisprudencës së saj, ka paraqitur në vazhdimësi disa kritere që shërbejnë për të bërë testin e shkeljes së lirisë së shprehjes. Në këtë kuadër ky test shërben për të pasur si garanci vetjake që individit gëzon në lidhje me të drejtat e tij për një jetë familjare, private. Përhapja e informacioneve që lidhen me jetën private përbëjnë një kufizim të fortë të lirisë së shprehjes. Përjashtimisht në çështjen *Lingens vs. Austria*, Gjykata ka pranuar se në rastet që aplikanti (ankuesi) është person publik, liria e shprehjes do të ketë përparësi në respektimin e saj krahasimisht me të drejtën për jetë private që mbro-

het nga neni 8 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Megjithëse gjykatat e çdo sistemi, GJEDNJ-ja apo dhe gjykatat kombëtare, e zhvillojnë praktikën e tyre të konsolidimit në zgjidhjen e konfliktit ndërmjet lirisë së shprehjes dhe së drejtës për respektimin e jetës private, zhvillimi i teknologjisë është shpesh më i shpejtë dhe ecën me ritme shumëfish më të larta. **Debati mbi raportin e së drejtës për informim dhe jetës private është ngritur në një standard tjetër në vitet e fundit, atë të zbulimit të personalitetit dhe evidencimit të karakteristikave, profileve dhe pëlqimeve të individit.**

Shpikjet teknologjike si, Hi Google apo Hello Al-



exa kanë thyer muret e shtëpive tona. Tashmë jetojmë në një botë pa mure. Muret ndarëse të shtëpisë janë një perceptim thjesht fizik, por ato nuk sigurojnë më një jetë private të ndarë nga kolektivi. Debatet online në lidhje me përgjimin e platformave të ndryshme për qëllime reklamimi janë konsideruar shpesh si teori konspirative. Në shumë faqe interneti, njerëzit janë ankuar se janë përgjuar në lidhje me pëlqimet e tyre. Dhe derisa të mos ketë një ligj të shkruar apo një vendim gjykatë që konfirmon njërën apo tjetrën anë të debatit, ato mbeten teori konspirative. Për shembull K.B. ankohej se ajo vazhdimisht kishte folur, por nuk kishte postuar në asnjë vend online në lidhje me dëshirën e saj për të pasur një mace. Pas kësaj, ajo kishte filluar të shihte shpesh reklama me dyqane macesh apo mace në çdo faqe interneti që ajo klikonte.

Krijimi i profilit të blerësve potencialë për qëllime reklamimi është një nga akuzat e përditshme ndaj gjigantëve të medias, si Facebook, Fortune 500 apo Amazon. Çështjet që në fillim të viteve 2000 u shfaqën si një shqetësim i vogël në lidhje me shitjet online dhe reklamimin e biznesit, sot janë përqendruar në disa aspekte kryesore. Për qëllime të këtij shkrimi, do të arsyetojmë vetëm pesë prej këtyre aspekteve.

“**Debati mbi raportin e së drejtës për informim dhe jetës private është ngritur në një standard tjetër në vitet e fundit**, në atë të zbulimit të personalitetit dhe evidentimit të karakteristikave, profileve dhe pëlqimeve të individit.

Debati dhe **hetimet në lidhje me transferimin e të dhënave personale nga Facebook-u te Cambridge Analytica shkaktuan një tërmet në fitimet e Facebook-ut**. Të dhënat e shkurtit 2018 raportojnë se interesi në aksionet e Facebook-ut u ul me 13.9%.

Aspekti i parë lidhet me krijimin e profileve për qëllime biznesi pa pëlqimin e përdoruesit të internetit konsumator. Përdoruesit e internetit më së shumti fillojnë përdorimin e internetit për qëllime të shpërndarjes së informacionit apo të informimit mbi jetën kulturore, sociale, ekonomike, si dhe ndërveprimin social. Këto qëllime janë bërë më të lehta falë teknologjisë dhe mekanizmave që ofrohen nga gjigantët mediatikë, si Facebook, Twitter, Instagram apo rrjete të tjera. Sipas portalit më të madh të statistikave Statista.com, numri i përdoruesve të Facebook-ut në tremujorin e katërt të 2017 ka arritur në **2.2 bilionë përdorues** aktivë në muaj. Mbi 1.74 milionë përdorues e përdorin Facebook-un nëpërmjet telefonisë së lëvizshme.

Përdorimi masiv dhe në rritje solli me vete dhe shqetësimin e respektimit të jetës private të individit. Në shkurt të këtij viti, media botërore u pushtua nga debati mbi çështjen e raportit ndërmjet përdorimit të të dhënave personale të Facebook-ut nga shoqëria Cambridge Analytica. Komisioni Amerikan Federal për Tregtinë

(FTC) urdhëroi një hetim “jo-publik” mbi Facebook-un dhe përdorimin e të dhënave personale.

Praktikat e menaxhimit të të dhënave personale janë urat e komunikimit të brishtë ndërmjet qëllimit fitimprurës të biznesit të medias dhe interesit publik për lirinë e shprehjes dhe shpërndarjen e informacionit në bazë të garantimit të respektimit të jetës private. Shërbimi i masmedias ka disa veçori kryesore, të cilat luajnë rol të rëndësishëm në ofrimin e vetë shërbimit, si dhe në mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të organeve të masmedias. Këto janë:

- Shërbimi ofrohet në mbrojtje të interesit publik;

- Shërbimi ofrohet nga sfera private fitimprurëse (përfshijmë institucionet shtetërore/publike);

- Shërbimi duhet të funksionojë si një mbikëqyrës i shtyllave të tjera të pushtetit, pra ekzekutiv, ligjvënës dhe gjyqësor;

Shërbimi duhet të ketë rol informues, argëtues, investigues, edukativ, kulturor, shkencor, sipas vetive të komunitetit të një vendi;

- Shërbimi duhet të jetë i pavarur nga çdo ndërhyrje tjetër, qoftë dhe të interesave fitimprurëse të personave që e drejtojnë këtë shërbim (përfshij aksionarët, drejtorët, pronarët).

Themeli i debatit ndërmjet balancimit të qëllimit fitimprurës të biznesit të medias dhe interesit publik të lirisë së shprehjes është transferuar tashmë nga televizionet



në rrjetet sociale. Debati dhe hetimet në lidhje me transferimin e të dhënave personale nga Facebook-u te Cambridge Analytica, shkaktuan një tërmet në fitimet e Facebook-ut. Të dhënat e shkurtit 2018 raportojnë se interesi në aksionet e Facebook-ut u ul me 13.9%. Vetëm në mëngjesin e datës 16 mars 2018, interesi i aksioneve të Facebook-ut ra me 6%. Të dhënat raportojnë për një humbje deri në 70 bilionë dollarë përgjatë një jave. Tronditja e biznesit në bursë dhe luhata e tregjeve financiare ishte rrjedhojë e cenimit të respektimit të jetës private nëpërmjet përdorimit (sikurse pretendohet) të të dhënave personale të 50 milionë përdoruesve të Facebook-ut nga shoqëria britanike Cambridge Analytica. Ngjarja solli edhe një herë vëmendjen e ligjberësve në rang botëror që

t'i përkushtohen **rregullimit të përdorimit të të dhënave nga shpërndarësit e internetit me qëllim që të ruhet balanca ndërmjet qëllimit fitimprurës dhe interesit publik.** Qëllimi fitimprurës nuk duhet të

PROFILET

Krijimi i profilit të blerësve potencialë për qëllime reklamimi është një nga akuzat e përditshme ndaj gjigantëve të medias, si Facebook Fortune 500 apo Amazon. Çështjet që në fillim të viteve 2000 u shfaqën si një shqetësim i vogël në lidhje me shitjet online dhe reklamimin e biznesit, sot janë përqendruar në disa aspekte kryesore.



avantazhohet nga teknologjia në dëm të respektimit të jetës private. Sigurisht që çështja është ende nën hetim dhe u takon hetimeve të sqarojnë nëse përdorimi i të dhënave personale nga Facebook-u është kryer në kundërshtim me termat dhe referencat e përcaktuara në marrëveshjet që çdo përdorues lidh online me Facebook-un.

2 **Aspekti i dytë** lidhet me krijimin dhe përdorimin e profileve dhe karakteristike të pavetëdijshme të përdoruesit të internetit konsumator për qëllime fushatash marketingu, zgjedhore apo politikëbërëse. Skandali i Facebook-ut prodhoi ndër të tjera dhe një debat më të thelluar në lidhje me përpunimin e të dhënave personale. Drejtori ekzekutiv i Facebook-ut pohoi në mars të 2018-ës se Facebook-u përgjatë viteve kishte ruajtur përmbajtjen e telefonatave dhe mesazheve të disa përdoruesve. Reagimi i menjëhershëm i konsumatorëve


solli humbjen e besimit të më shumë se 51% të konsumatorëve të Facebook-ut.

“Teknologjitë e reja kanë sjellë sfida të reja për autoritetet rregullatore” – ishte ky mesazhi i Gjykatës Margaret McKeown në shqyrtimin e ankesave për ‘paanshmërinë e rrjetit’. Gjykata Federale e Kolumbias vendosi t’i jepte juridiksion Komisionit Federal të Tregtisë për shqyrtimin e çështjeve që lidhen me përdorimin e të dhënave personale nga shpërndarësit e internetit. Në arsyetimin e vendimit, gjykata, ndër të tjera, sqaron se një kompani telefonike nuk është më vetëm një kompani telefonike. Transformimi i shërbimeve të informimit dhe funksioni i dyfishtë i teknologjisë digjitale tregon se operatorët e telekomunikacionit nuk kanë më një funksion telekomunikimi të mirëfilltë, por ata janë zgjeruar në operimin me bazë interneti, shpërndarjen e videove, prodhim, shërbime dhe pajisje ndërvepruese për argëtim, sigurinë e shtëpisë dhe shumë të tjera. Për këtë arsye, rregullimi apo vetërregullimi duhet të zbatohen menjëherë.

3 **Aspekti i tretë** është krijimi i profileve dhe orientimi i detyrueshëm pa pëlqimin e vetëdijshëm të përdoruesit të internetit konsumator për qëllimet e biznesit të shpërndarësit të internetit. Gjithkujt i ka ndodhur që t'i telefonojnë kompanitë e marketingut duke i sqaruar cilësitë e produkteve apo shërbimeve që ata ofrojnë. Sipas Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, një shoqëri mund të telefonojë përdoruesin e telefonisë **vetëm në rast se ky përdorues konsumator e ka kërkuar një gjë të tillë dhe/apo ka shprehur pëlqimin e tij për marrjen e telefonatës apo reklamës** nëpërmjet shërbimit të internetit apo të telefonisë. Në këtë debat janë përfshirë gjigantët e medias online, përveç atyre që njihen në vendin tonë si “call centers”. Ndryshe nga call centers, gjigantët online përdorin mjete apo teknologji më të shpejta dhe më të zhvilluara, që shpesh nuk arrijnë të garantojnë në kohë mospërdorimin abuziv të të dhënave personale, shijeve dhe karakteristikave të përdoruesve konsumatorë. Debat i juridik është përqendruar në sasinë e kufizimeve dhe kushteve që duhet të plotësojë një person fizik apo juridik për të përdorur mesazhe, email-e apo për të shpërndarë informacion pa pëlqimin e tjetrit. Debat i shtrihet nga **ekstremi i telefonatave për reklamime dyshekësh** deri në **ekstremin e mesazheve për organizimin e një feste** që përfshin 1000 persona të interesuar për një birrë të re. Rregullat dhe praktika e gjykatave lëviz sa në njërin skaj, në tjetrin në favor herë të jetës private, herë të lirisë së informacionit. Shoqëria Fortune 500, një nga më të njohurat në rankimin vjetor të shoqërive më të suksesshme, u përfshi në disa procese gjyqësore. Përdorimi i telefonatave për qëllime të krijimit të listës së shoqërive më të suksesshme për vitin 2017, i shkaktoi asaj një gjobë për cenimin e të dhënave personale nga FCC, e cila më pas u shfuqizua nga gjykata e distriktit të Kolumbias.

“ Shoqëria “Fortune 500”, një nga më të njohurat në rankimin vjetor të shoqërive më të suksesshme, u përfshi në disa procese gjyqësore. **Përdorimi i telefonatave për qëllime të krijimit të listës së shoqërive më të suksesshme për vitin 2017 i shkaktoi asaj një gjobë për cenimin e të dhënave personale nga FCC**, e cila më pas u shfuqizua nga gjykata e distriktit të Kolumbias.

4 **Aspekti i katërt** është siguria dhe garancia e profileve online. Krijimi i profileve të rreme dhe përdorimi i tyre për orientimin e sondazheve me qëllim përfitimin e një kompanie, ka qenë një nga akuzat më të reja gjatë këtij viti për gjigantët e medias. Në nëntor të vitit 2017 Prokurori i Përgjithshëm i Shtetit të Nju-Jorkut, z. Eric Schneiderman, hapi hetime në lidhje me komentet e rreme të postuara gjatë konsultimit publik të disa politikave të Rregullatorit Federal të Komunikimeve (FCC). FCC kishte marrë më shumë se 22 milionë komente dhe shumica e tyre vinin nga profile të rreme online. **Debat i juridik i profileve të rreme ka prodhuar pasiguri në sondazhe, politikëbërje, si dhe fusha të ndryshme përveçse mbrojtjes dhe respektimit të jetës private.**



FAspekti i pestë është krijimi i profilit dhe përdorimi i jetës private nëpërmjet pëlqimeve, postimeve kundër vetë përdoruesit të internetit konsumator. Si për shembull, largimet në masë nga puna për shkak të opinioneve të shprehura në rrjete sociale. Disa nga shoqëritë e mëdha të biznesit dhe në disa raste të jashtëligjshme edhe administrata zyrtare publike, kanë miratuar rregullore që nuk i lejon punonjësit e tyre të shprehen kundër politikës së shoqërisë në rrjete sociale. **Gjurmimi i postimeve në rrjete sociale nga persona të punësuar në shoqëritë e mëdha apo administratë publike, në cenim të respektimit të të dhënave personale, është kthyer**

në një frenim dhe vetëkufizim të lirisë dhe jetës private nga përdoruesit konsumatorë. Sipas rrjetit Athletics Business, volejbollistja S.H. ishte larguar pa të drejtë nga skuadra për shkak të postimit të fotove shumë seksi të saj në Instagram.

Teknologjitë e reja kanë vënë në një rrezik potencial **garantimin e së drejtës për punë, palëvizshmërinë në punë dhe mosndërhyrjen në jetën private.** Përkundrejt kësaj, shpërndarësit e internetit, sikurse provohet nga praktikat e shumta gjyqësore, përpunojnë të dhënat personale nëpërmjet krijimit të profileve të detajuara dhe hartimit të karakteristikave të personalitetit të përdoruesit konsumator. Në debatin

GJURMIMI I TË DHËNAVE

Gjurmimi i postimeve në rrjete sociale nga persona të punësuar në shoqëritë e mëdha apo administratë publike, në cenim të respektimit të të dhënave personale, është kthyer në një frenim dhe vetëkufizim të lirisë dhe jetës private nga përdoruesit konsumatorë. Sipas rrjetit “Athletics Business”, volejbollistja S.H. ishte larguar pa të drejtë nga skuadra për shkak të postimit të fotove shumë seksi të saj në Instagram. Teknologjitë e reja kanë vënë në një rrezik potencial garantimin e së drejtës për punë, palëvizshmërinë në punë dhe mosndërhyrjen në jetën private. Përkundrejt kësaj, shpërndarësit e internetit, sikurse provohet nga praktikatat e shumta gjyqësore, përpunojnë të dhënat personale nëpërmjet krijimit të profileve të detajuara dhe hartimit të karakteristikave të personalitetit të përdoruesit konsumator.

që po zhvillohet botërisht tashmë mbi raportin e Facebook dhe Cambridge Analytica, drejtori ekzekutiv i shoqërisë Apple, z. Tim Cook, u shpreh se: “mbajtja e informacionit të detajuar personal të përdoruesve të Facebook-ut nuk duhet të ekzistojë pasi cenon seriozisht lirinë dhe respektimin e jetës private”. Cook shtoi se të dhënat personale dhe garantimi i tyre hyjnë në të drejtat themelore dhe duhet të mbrohen nga çdo ofrues shërbimi publik.

Asketet e përmendura më sipër janë subjekt ndryshimi të vazhdueshëm në raport me zhvillimet e teknologjisë. Gjithsesi është detyrë e ligjberësit që të vrapojë pas zhvillimit të teknologjisë. Rregulli i përgjithshëm se duhet të krijohet baza ligjore përpara sistemit ka

ndryshuar bindshëm në favor të zhvillimit të sistemit pavarësisht ekzistencës së bazës ligjore. Edhe pse politikatat rregullatore, sikurse u përmend më lart, përbëjnë një nga kufizimet e lirisë së shprehjes dhe të të bërit biznes në Shqipëri, rregullimet e tregut janë ende larg zhvillimeve të teknologjisë.

Respektimi dhe mbrojtja e të dhënave personale nëpërmjet rrjeteve sociale apo portaleve të ndryshme është një top loje në fushë asnjënjëse, lojtarët e të cilës duhet të jenë Autoriteti i Medias Audiovizive (AMA), Agjencia e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), Autoriteti i Konkurrencës (AK) dhe Komisionari për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. ■



LEX

TEKNOLOGJIA

Edhe “**demokracia digjitale**” nuk do t’i shpëtojë kritikës në lidhje me të drejtat dhe aksesin në vendimmarrje sipas **modelit të shtetit ligjor**. Duke qenë se individi është sot nën varësinë e teknologjisë, ai mundësinë e dhënies së mendimi të lirë dhe shprehjes së tij e ka të kushtëzuar nga mundësitë për t’u përfshirë në një teknologji bashkëkohore dhe të përditësuar.



FABIAN ZHILLA

MARRËDHËNIET MIDIS TEKNOLOGJISË DHE SHTETIT LIGJOR janë tashmë pjesë e një debati të hapur edhe në fushën e jurisprudencës. Teknologjia po krijon hapësira virtuale të cilat janë shpeshherë të vështira të rregullohen sipas parimeve të shtetit ligjor. Sot gjendemi përballë epokës së cyber-lirisë, ku secili është i lirë të shprehet, të komunikojë dhe të ndajë ide me kriterin e vetëm etik - atë personal. Liria që ofroi teknologjia u njësuara në një demokraci të një ere të re - demokracinë digjitale. Liria ose demokracia digjitale, me gjithë fillimet e saj konceptuale në vitet 1990, u promovua nga The Times Magazine, ku çmimi si “njeriu i vitit” në vitin 2006 iu dha YouTube dhe MySpace me idenë se nëpërmjet këtyre platformave po mundësohet ndarja e mendimit të lirë. Qëllimi kryesor ishte promovimi i fjalës së lirë dhe mbrojtja e organizimeve shoqërore nga dhuna e qeverive autoritare. Ndërkohë në shtete ku media konvencionale është e kontrolluar, qytetari “digjital” do të kishte mundësinë të bënte publik mendimin e tij.

Me gjithë përfitimet që sjell demokracia digjitale, nuk kanë qenë të pakët kritikët rreth natyrës së shtetit ligjor që pro-




Me gjithë përfitimet që sjell demokracia digjitale, nuk kanë qenë të pakët kritikët rreth natyrës së shtetit ligjor që promovon hapësira virtuale. Për shembull, **një ndër debatet që lidhet dhe me legjitimitetin si burimi kryesor i ligjit është “demosi” ose komuniteti i formuar në mënyrë demokratike.**

movon hapësira virtuale. Për shembull, një ndër debatet që lidhet dhe me legjitimitetin si burimi kryesor i ligjit është “demosi” ose komuniteti i formuar në mënyrë demokratike. Howard Rheingold, në këtë aspekt, është treguar i kujdesshëm të bëjë një dallim të qartë midis konceptit marksist të kolektivizimit dhe aksionit kolektiv që promovon demokracia digjitale. Nëse, sipas Rheingold, individi në kolektivizim nuk është vetvetja, pra vepron jo sipas mendimit të tij të lirë, por në mënyrë të kushtëzuar si një refleksion i grupit, në aksionin kolektiv digjital çdo anëtar i komunitetit virtual vendos lirisht pjesëmarrjen në të dhe mënyrën sesi do të kontribuojë pa qenë i detyruar nga një autoritet i centralizuar.

Sidoqoftë, edhe “demokracia digjitale” nuk do t'i shpëtojë kritikës në lidhje me të drejtat dhe aksesin në vendimmarr-

INDIVIDIDI

Sipas Rheingold, individi në kolektivizim nuk është vetvetja, pra vepron jo sipas mendimit të tij të lirë, por në mënyrë të kushtëzuar si një refleksion i grupit, në aksionin kolektiv digjital çdo anëtar i komunitetit virtual vendos lirisht pjesëmarrjen në të dhe mënyrën sesi do të kontribuojë pa qenë i detyruar nga një autoritet i centralizuar.



je sipas modelit të shtetit ligjor. Duke qenë se individi është sot nën varësinë e teknologjisë, ai mundësinë e dhënies së mendimit të lirë dhe shprehjes së tij e ka të kushtëzuar nga mundësitë për t'u përfshirë në një teknologji bashkëkohore dhe të përditësuar. Dhe kjo vjen me kosto shpeshherë të lartë, e cila pamundëson ose vështirëson pjesëmarrjen e asaj pjese të shoqërisë që nuk ka kapacitetet financiare të nevojshme. Në këtë kontekst "demokracia digjitale" nuk është immune ndaj kapjes së elitave të korruptuara, të cilat kanë mundësitë financiare për të investuar në teknologji të avancuar. Pra, liria e shprehjes,

që të mundet të të mundësojë hapësira digjitale, përballet me të njëjtat problematika që përballet liria e mendimit në hapësirën reale. Duke pasur parasysh këto vështirësi, teknologjia lejon mundësinë e platformave klandestine, të cilat rriten gradualisht dhe të cilat formësojnë mendimin e tyre virtualisht për ta shpërndarë atë më pas në botën reale. Por ky lloj komunikimi i dyzuar (hapësira formale v. hapësirave reale), shpeshherë me identitetet të paqartë, nuk lejon transparencë dhe në vend që të formojë njerëz në bazë bindjesh dhe parimesh, bën të kundërtën, kthehet në një mjet propagandistik të pakontrolluar

dhe manipulativ.

Pra koncepti i “cyber-lirisë” jo pa qëllim mund të njësohet me një fare Woodstock-u virtual, një platformë digjitale antikulture ose si një hapësirë virtuale, ku grupime të ndryshme të vetërregulluara sfidojnë ligjin dhe traditën. Këto “xhungla” virtuale, në emër të cyber-lirisë, mund të kapërcejnë kufijtë e shtetit ligjor dhe si rrjedhim t’i shmangen përgjegjësisë ligjore. Pra, funksionojnë dhe vetërregullohen në mungesë legjitimiteti si rrjedhojë e mungesës së legjitimitetit shoqëror mbi të cilat këto hapësira virtuale pluskojnë dhe tentojnë t’i imponohen opinionit publik.


Jo vetëm në aspektin e mënyrës së qasjes ndaj shtetit ligjor, por teknologjia ia ka arritur që të ndikojë edhe në marrëdhënien midis individit dhe së drejtës. Nëse ligji është menduar si mjete kryesor mbi të cilin shoqëria ndërton një marrëveshje për të rregulluar marrëdhëniet e saj në hapësirë dhe në kohë, teknologjia i ka thyer këto barrierë. Parimi i njohur, sipas të cilit ligji apo e drejta është shprehje e konsensusit “consensus facit legem”, tashmë jo pak herë është vënë në diskutim nga teknologjia. Kjo e fundit ka arritur të jetë sfiduesja e radhës. Jo më kot, studies, si Vivek Wadhwa, e kanë krahasuar ndikimin e teknologjisë si ndikimin që pati printimi i shtypit të shkruar në rrënimin e Perandorisë Romake. Teknologjia ka arritur të dekonstruktojë aureolën mbrojtëse që procedura ligjore i ofron individit nga keqpërdorimi i ligjit nga aparati shtetëror. Nëse, sipas shtetit ligjor, një akt juridik duhet të respektojë një filtër procedural, i cili përpiqet ta mbrojë atë nga ana ligjore, por dhe morale, teknologjia lejon hapësira që këto filtra të anashkalohen. Kështu, nëse një institucioni do t’i duhej të respektonte të drejtën e privatësisë gjatë procesit të intervistës së punës, ai tashmë, fare thjesht, mund t’i mësojë këto të dhë-

na personale nëpërmjet aksesit në mediat sociale. Një institucioni financiar nuk do t’i duhen shumë “firma” për të marrë dhe për të mësuar rreth historisë së biznesit të dikujt apo dhe problemeve me kreditë e këqija me klientë të dyshimtë të tij. Mjafton që institucioni financiar të navigojë në internet nëpërmjet Google apo çdo motori tjetër kërkues në internet.

Shteti ligjor bazohet në gjithëpranimin shoqëror me të drejtat dhe detyrimet e tij për të normuar dhe mbrojtur shoqërinë nga keqpërdorimi i mjeteve formale rregulluese (ligjet), por dhe i mjeteve normative informale, duke i formalizuar ato në një të drejtë të përbashkët në mjedise multinormative (p.sh. traditat, sjelljet, besimet). Që në krye të herës, Aristoteli do të bënte një dallim midis ligjit të njeriut (rule of man) dhe shtetit të së drejtës (rule of law) duke nënvizuar se kjo e fundit i ka gjasat të jetë më racionale. Ndërkohë që burimi kryesor i legjitimitetit të



Teknologjia ka arritur të dekonstruktojë aureolën mbrojtëse që procedura ligjore i ofron individit nga keqpërdorimi i ligjit nga aparati shtetëror. Nëse, sipas shtetit ligjor, një akt juridik duhet të respektojë një filtër procedural, i cili përpiqet ta mbrojë atë nga ana ligjore, por dhe morale, teknologjia lejon hapësira që këto filtra të anashkalohen.



ligjit sipas shkollës natyrore të ligjit është morali, i cili, sipas Dworkin, është ai ku mbështeten parimet ligjore. Janë këto të fundit të cilat orientojnë ligjin paçka pasojave, dhe jo situatat. Në këtë kuptim, shteti ligjor është deri diku reflektim i moralit të një shoqërie që e formalizon

atë nëpërmjet konsensusit demokratik. Ndërkohë, ky lloj legjitimiteti që ka shteti ligjor nuk ndjek të njëjtat hapa dhe procedura që ndjek ligjëbërja në hapësirat virtuale, të cilat, kryesisht, nuk kanë një juridiksion të përcaktuar dhe kanë një demos johomogjen.

Në këtë kontekst, nëse

shteti ligjor udhëhiqet nga parimi i rregullimit të shoqërisë vetëm nëpërmjet ligjit, hapësira virtuale duket se është krijuar për të mos u rregulluar. Një ndër ekspertët më të njohur të fushës, si Lawrence Lessig, e pranon faktin se hapësira virtuale është e panormuar dhe se vetë arkitektura e hapësirës virtuale të vetmin rregullator real që ka është gjuha e kodit të ndërtimit të programit. Sipas Lessig, ajo që është e pakapshme në hapësirën virtuale është të dish kush është ku. Pra, siç u cek më lart, juridiksioni virtual karakterizohet nga mungesa e përgjegjësisë



Teknologjia ka arritur gjithashtu të relativizojë përgjegjësinë ligjore duke ndikuar në thelbin e së drejtës “fiat justitia ruat caelum” (vendos drejt pavarësisht pasojave).

HAPËSIRA VIRTUALE

Në këtë kontekst, nëse shteti ligjor udhëhiqet nga parimi i rregullimit të shoqërisë vetëm nëpërmjet ligjit, hapësira virtuale duket se është krijuar për të mos u rregulluar. Një ndër ekspertët më të njohur të fushës, si Lawrence Lessig, e pranon faktin se hapësira virtuale është e panormuar dhe se vetë arkitektura e hapësirës virtuale të vetmin rregullator real që ka është gjuha e kodit të ndërtimit të programit. Sipas Lessig, ajo që është e pakapshme në hapësirën virtuale është të dish se kush është ku. Pra, siç u cek më lart, juridiksioni virtual karakterizohet nga mungesa e përgjegjësisë ligjore. Sipas Lessig, në fakt, diskutimi nuk duhet orientuar drejt rregullimit dhe mosrregullimit të hapësirës kibernetike, pasi atë në mënyrë automatike e bëjnë programuesit e programeve, të cilët, duhet cilësuar, nuk janë të zgjedhurit tanë.

ligjore. Sipas Lessig, në fakt, diskutimi nuk duhet orientuar drejt rregullimit dhe mosrregullimit të hapësirës kibernetike, pasi atë në mënyrë automatike e bëjnë programuesit e programeve, të cilët, duhet cilësuar, nuk janë të zgjedhurit tanë. Por, debati, nënvizon Lessig, është se cilat duhet të jenë parimet që udhëheqin rregullimin e hapësirave virtuale. Pra, a duhet teknologjia të shërbejë për të na mbrojtur privatësinë, apo për të rritur aksesin e të tretëve në jetën tone private? A duhet teknologjia të ndihmojë në rritjen e pjesëmarrjes sonë në vendimmarrje në demokraci, apo ta kufizojë atë nëpërmjet rritjes së censurës?

Një tjetër problem nga pikëpamja e jurispruencës është edhe para-

doksi i “përgjegjësisë ligjore të qytetarit digjital”. Pra, përplasja midis përgjegjësisë ligjore të qytetarit virtual dhe qytetarit real. Kjo lloj përplasjeje juridike e vë në vështirësi zbatimin e ligjit dhe si rrjedhim shtetin ligjor. Teknologjia ofron lehtësinë e komunikimit nëpërmjet identiteteve të rreme ose dhe komunikimit extraterritorial. Pra, dikush mund të ofendojë, të fyejë ose dhe të prodhojë lajme të rreme për Shqipërinë në shqip duke qenë qytetar i një juridiksioni tjetër. Ky fenomen sjell probleme juridike kur një vepër penale nuk konsiderohet e tillë në të dy shtetet respektive, pra një vepër penale konsiderohet e tillë në shtetin ku personi në fjalë sillet si qytetar digjital, por kjo vepër nuk konsiderohet e

jashtëligjshme në shtetin ku qytetari aderon formalisht, jo virtualisht.

Nga ana tjetër, e gjithë jeta personale e dikujt në mediat sociale është përkthyer në një provë mbi të cilat agjencitë ligjzbatuese mund të ndërtojnë çështje dhe të vendosin kriteret kontrolli që lidhen me sigurinë publike. Nëpërmjet teknologjisë shumë kompani mund të diskriminojnë mbi baza gjinore, moshe, besimi fetar dhe ideologjik apo dhe origjine, në mënyrë të fshehtë, duke vendosur filtra preferencialë ndaj aplikantëve për punë ose projekte.

Teknologjia ka arritur gjithashtu të relativizojë përgjegjësinë ligjore duke ndikuar në thelbin e së drejtës “fiat justitia ruat caelum” (vendos drejt pavarësisht pasojave). Teknologjia ka



mundësuar platforma komunikimi, të cilat mundësojnë një individ shumëdimensional dhe me shume identitete juridike. Sot e ashtuquajtura gjenerata e teknologjisë (net generation), lindur midis viteve 1982-1991 mundet të komunikojnë

në të njëjtën kohë dhe, pse jo, të kryejnë veprime me pasoja juridike me disa individë (fizikë ose juridikë) njëkohësisht. Pra, në të njëjtin moment individi është konsumator, ofrues shërbimi nëpërmjet përmbajtjes së mesazhit që përcjell, por

NDIKIMI

Sot teknologjia ka arritur të ndikojë seriozisht në marrëdhënien politike dhe sociale të individit dhe shtetit ligjor. Ajo ka arritur që të ridimensionojë aulën e diskursit shoqëror mbi ligjin që Habermasi e konsideron si burimin kryesor të legjitimitetit të ligjit. Sot platformat digjitale mund të ndërtohen nga kushdo dhe për këdo dhe të paralelizojnë fare mirë aulat ku diskutohet ligji. Nga ana tjetër, teknologjia ka mundësuar anashkalimin e moralit të brendshëm të ligjit. Teknologjia krijon mundësinë e një terreni ambig, jo transparent dhe shumë manipulativ.

mund edhe të keqinformojë nëpërmjet shpërndarjes së një lajmi të pavërtetë.

Teknologjia ka ndikuar gjithashtu në marrëdhënien midis publikes dhe personale. Ndërsa privatësia është një e drejtë kushtetuese, ajo vitet e fundit është

parë si një e drejtë inferiore përballë sigurisë kombëtare, kjo falë përhapjes së teknologjisë. Vetëm brenda një viti (2015-2016), kompanisë “Apple” do t’i duhej të kundërshtonte rreth 11 vendime gjykatash të cilat i kërkonin asaj t’i lejonte agjencive



Sipas Fuller-it, nëse ligji do të jetë publik, koherent, stabël, i qartë, i mundshëm dhe praktik, vetëm atëherë ai mund të jetë imun nga influenza e procesit ligjbërës të korruptuar të elitave drejtuese. Parë në në kontekstin e moralit ligjor të Fuller-it, **teknologjia aq sa mund të jetë ndihmuese në ekspozimin e proceseve të manipuluarra të ligjbërjes, po aq mund të kthehet gjithashtu në një instrument për ta certifikuar manipulimin e ligjbërjes.**

ligjzbatuese, si FBI, aksesin në të dhënat personale të përdoruesve të telefonave mobile iPhone.

Nga ana tjetër, teknologjia ka mundësuar formimin e “tregjeve të zeza” virtuale siç është rasti i “dark web”, të cilat janë tërësisht jashtë rregullimit ligjor dhe kontrollit të shtetit ligjor. Këto njihen si parajsa të krimit kibernetik, të cilat shfrytëzohen nga krimi i organizuar, politikanë të korrumpuar dhe organizata terroriste.

Pra, sot teknologjia ka arritur të ndikojë seriozisht në marrëdhënien politike dhe sociale të individit dhe shtetit ligjor. Ajo ka arritur që të ridimensionojë aulën e diskursit shoqëror mbi ligjin që Habermasi e konsideron si burimin kryesor të legjitimitetit të ligjit. Sot platformat digjitale mund të ndërtohen nga kushdo dhe për këdo dhe të paralelizojnë fare mirë aulat ku diskutohet ligji. Nga ana tjetër, teknologjia ka mundësuar anashkalimin e moralit të brendshëm të ligjit. Teknologjia krijon mundësinë e një terreni ambig, jo transparent dhe shumë manipulativ. Filozofi i njohur Lon Fuller nënvizon se “gjërat e këqia ndodhën në errësirë dhe jo në shkëlqimin e dritës së ligjit”. Sipas Fuller-it, nëse ligji do të jetë publik, koherent, stabël, i qartë, i mundshëm dhe

praktik, vetëm atëherë ai mund të jetë imun nga influenza e procesit ligjbërës të korrumpuar të elitave drejtuese. Parë në në kontekstin e moralit ligjor të Fuller-it, teknologjia aq sa mund të jetë ndihmuese në ekspozimin e proceseve të manipuluarra të ligjbërjes, po aq mund të kthehet gjithashtu në një instrument për ta certifikuar manipulimin e ligjbërjes.



Ndërkohë, teknologjia ka mundësuar komunikimin gati të personalizuar midis liderit dhe individit duke kapërcyer institucionet e ndërmjetme. Dikush sot mund t'i kërkojë punë në kohë reale kryeministrit dhe ky i fundit e zgjidh këtë çështje paçka se kjo u takon autoriteteve që merren me punësimin dhe ndihmën sociale. Në këtë kontekst, përgjegjshmëria ligjore e qeveritarit përballë qytetarit është bërë krejtësisht informale dhe personale. Kjo qasje e re godet pikërisht atë që Hayek ka parasysh me veçoritë e shtetit ligjor – mospersonalizmin e shtetit ligjor dhe mbrojtjen e individit nga ndërvarësia e shtetit.

Raporti i teknologjisë me ligjin, pra, është shumë i brishtë dhe gati sfidues. Për vetë natyrën e tij sociale, ligji është shumë më i “ngathët”, ndërkohë që teknologjia është shumë më e shpejtë. Kjo e vështirëson mjaftueshëm sinkronizimin



midis shtetit ligjor formal dhe shtetit ligjor virtual. Megjithëse format e e-government kanë lehtësuar marrëdhënien midis qytetarit dhe shërbimeve publike, ato nuk kanë lehtësuar pjesëmarrjen e këtij të fundit në vendimarrje. Jo vetëm kaq, por platformat virtuale (mediat sociale) po përdoren në mënyrë efikase nga elitat e qeverisë si mekanizma paralelë për të manipuluar qytetarin dhe kontrolluar atë virtualisht. Kështu Lex Teknologjia ka pështjelluar dhe ndërlikuar dem-osin dhe diskursin tonë mbi ligjin. Ajo

na ka lehtësuar komunikimin, shprehjen, pjesëmarrjen në diskutimin publik, por na ka vështirësuar identifikimin dhe moralin e autoritetit përfaqësues të ideve që ndikojnë opinionin publik. Lex Teknologjia na ka afruar me shtetarin por na ka devijuar nga kërkimi llogarisë sipas procedurave formale të shtetit ligjor. Si përfundim, Lex Teknologjia ka informalizuar shtetin ligjor duke paralelizuar diskutimin formal të kontrolluar mbi ligjbërjen me diskutimin informal digjital. ■




MEDIAT SOCIALE

Teknologjia e informacionit nuk mund të kërcënojë as kohën dhe as marrëdhëniet njerëzore, për aq kohë sa të dyja këto (koha dhe marrëdhëniet) janë të ndërtuara në kokën e njeriut dhe janë në përgjegjësinë e tij për t'i menaxhuar (të paktën teorikisht kështu duhet të ndodhë).



RRUGA PËR TE TJETRI, APO VETË TJETRI?



SILVANA LOKA

A ËSHTË TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT kërcënimi më i madh i kohës dhe i marrëdhënieve njerëzore? A janë rrjetet sociale kurthi më i madh i iluzionit për jetë dhe përkatësi sociale? A është revolucioni kibernetik një revolucion anti-human/antisocial?

Mendoj se, në këtë formë, këto çështje janë shtruar gabim. Teknologjia e informacionit nuk mund të kërcënojë as kohën dhe as marrëdhëniet njerëzore, për aq kohë sa të dyja këto (koha dhe marrëdhëniet) janë të ndërtuara në kokën e njeriut dhe janë në përgjegjësinë e tij për t'i menaxhuar (të paktën teorikisht kështu duhet të ndodhë). Koha nuk do të kishte asfare kuptim në rast se ne, unë edhe ti, nuk do të dinim çfarë të bënim me të. Është e vërtetë që askush nuk na pyeti për ndarjen e kohës në minuta, orë, ditë apo vite. Por, nga ana tjetër, askush nuk na detyron që kohën ta përdorim (në fakt ne përdorim

shumë gjëra të tjera, por kohën më së shumti e shpërdorojmë) duke e vënë veten në funksion të teknologjisë së informacionit. Sipas studimeve të ndryshme, në ditët e sotme njerëzit e kontrollojnë telefonin e tyre celular nga 80 deri në 150 herë brenda ditës. Në total kjo shkon në rreth 90 minuta në ditë, rreth 23 ditë në vit dhe rreth 4 vjet nga jeta e një njeriu me jetëgjatësi mesatare (nëse ndërkohë nuk është përplasur nga ndonjë makinë, ndërsa kontrollon celularin pa parë as semafor, as vija të bardha!). Këto shifra i japin të drejtë kujtdo që vlerëson se njeriu i ditëve të sotme harxhon gjithnjë e më shumë kohë i lidhur pas teknologjisë sesa pas vetes apo frymorëve të tjerë. Nëse skulpturat e Michelangelo do të ishin krijuar në kohët e sotme, pa asnjë dyshim, në dorën e tyre (sidomos të adoleshentëve, VIP-ave, blogerëve, politikanëve, fashionistëve, etj., etj., etj.) do të kishte pesë gishta dhe një celular si zgjatim i tyre. E vërtetë pra, ne kalojmë shumë kohë, çdo ditë e më shumë, duke përdorur teknologjinë e informacionit. Pyetja është: Çfarë mund të bënim tjetër ndërkohë? Sepse koha është një koncept që merr kuptim vetëm kur ajo konsumohet. Për sa kohëtë kemi një përgjigje për këtë pyetje, celulari, kompjuteri, tableti, etj. do të na ofrojnë një terren pjellor dhe të larmishëm për të mbushur kohën, për të shtyrë kohën, për të vrarë kohën.

Sa herë që ne bëjmë një aktivitet që na pëlqen, truri ynë

Të fajësosh teknologjinë e informacionit, rrjetet sociale dhe zhvillimin kibernetik për konsumimin pa kriter të kohës përballë tyre, është një çështje e shtruar gabim. Mos ndoshta duhet, më mirë, të pyesim veten përse njerëzit janë gjithnjë e më shumë ta gatshëm të kalojnë kohë pa kriter në këto kanale komunikimi?

siguron që trupi të pompohet nga dopamina, një hormon i cili na jep ndjenjën e vetëkënaqësisë dhe të vetëpërbushjes. Më thoni, ju lutem, cili nuk do t'i rikthehej vazhdimisht e vazhdimisht celularit, rrjeteve sociale, internetit, nëse aty do të zhvillohej një aktivitet që na ofron kënaqësi? Në këtë pikë, ne do të ishim të gatshëm të harxhonim gjithë kohën në dispozicion (njoh njerëz që do të ishin të gatshëm të merrnin edhe kohë borxh, me qira, me kredi) për t'u ndjerë mirë edhe një herë, edhe një herë, edhe një herë.

Ashtu sikurse thashë në fillim, besoj se të fajësosh teknologjinë e informacionit, rrjetet sociale dhe zhvillimin kibernetik për konsumimin pa kriter të kohës përballë tyre është një çështje e shtruar gabim. Mos ndoshta duhet, më mirë, të pyesim veten përse njerëzit janë gjithnjë e më shumë ta gatshëm të kalojnë kohë pa kriter në këto kanale komunikimi? Çfarë i bën njerëzit të ndjehen të kënaqur dhe të vetërealizuar në këto komunikime kibernetike? A është koha e shpenzuar në këto rrjete një kohë e shpenzuar për të krijuar marrëdhënie sociale (ashtu sikurse evokon edhe vetë emërtesa "rrjet social") me tjetrin, i cili në jetën reale ka një emër, një fytyrë dhe një domethënie për ne? Cili është tjetri që na bën të lumtur dhe na tërheq vazhdimisht të vendosemi përballë ekranit? Apo është kjo një kohë ku tjetri me të cilin pretendohet të komunikohet është zëvendësuar me statuse

Nëse bëjmë miq të rinj, nëpër radhë të ndryshëm, disa prej miqve të vjetër harrohen ose spostohehen. Ndërkohë, në rrjetet sociale, ne konsumojmë kohë duke komunikuar me shumë më tepër se kaq njerëz dhe, mbi të gjitha, në nivele të përziera marrëdhëniesh.

të përkthyer keq), me pëlqimet dhe komentet (edhe për njerëz dhe çështje për të cilat nuk kemi aspak interes në vetvete), me fluturimin nga një informacion te tjetri?

Një studim i disa viteve më parë, arriti në përfundimin se njeriu është në gjendje (në fakt është i përcaktuar) të krijojë marrëdhënie sociale sipas një rregulli të caktuar. Ne arrijmë të kemi deri në 150 njohje relativisht sipërfaqësore, 50 marrëdhënie më të thelluara (por pa ndarë shumë nga vetja), 15 marrëdhënie në të cilat ne investohemi më shumë dhe ndajmë më shumë detaje dhe vetëm 5 marrëdhënie të ngushta miqësore. Këto numra (sigurisht që do të duhet të merren me tolerancë) tentojnë të qëndrojnë në këto nivele. Nëse bëjmë miq të rinj, nëpër radhë të ndryshëm, disa prej miqve të vjetër harrohen ose spostohehen. Ndërkohë, në rrjetet sociale, ne konsumojmë kohë duke komunikuar me shumë më tepër se kaq njerëz dhe, mbi të gjitha, në nivele të përziera ma-



rrëdhënesh. Mos vallë komunikimi online po i bjerr apo po i transformon marrëdhëniet sociale, të paktën për mënyrën sesi i njohim ne?

A mund të jetë teknologjia e informacionit përgjegjëse për çfarë po ndodh me marrëdhëniet njerëzore? A mund të jetë përgjegjës një send për një krijesë me natyrë njerëzore sikurse janë marrëdhëniet midis nesh? Nuk ka asnjë dyshim që aftësia për të krijuar raporte sociale është ndër treguesit më të rëndësishëm të shkallës së zhvillimit të njeriut. Rëndësia e

dimensionit 'social' është kaq e madhe saqë, bazuar mbi aftësinë apo paaftësinë e krijimit të raporteve sociale, janë formuluar diagnoza të caktuara për shëndetin mendor. Me fjalë të tjera, sa më i aftë të jetë dikush në krijimin, shfrytëzimin dhe ruajtjen e raporteve sociale, aq më i shëndetshëm është ai.

Në këtë kontekst, komunikimi ndër-njerëzor është një ndër mënyrat më të sigurta për të na çuar te tjetri dhe për ta lejuar tjetrin të vijë drejt nesh. Për më tepër, mjetet dhe kanalet e komunikimit që ne

përdorim përcaktojnë (në një masë të konsiderueshme) rëndësinë dhe cilësinë e marrëdhënies si dhe pritshmëritë që kemi prej saj. Fjala vjen, nëse e fillojmë ditën me një “Mirëmëngjesi! Si u gdhive?”, shoqërimi i kësaj përshëndetjeje me (maksimumi) një buzëqeshje do të tregonte se po përshëndesim për mirësjellje dhe se jemi me edukatë. Por nga ana tjetër, nëse vazhdojmë rrugën ndërkohë që përshëndesim, i themi tjetrit (jo nëpërjet fjalëve) se nuk jemi të interesuar të dimë realisht nëse ai/ajo është gdhirë apo jo nga ana e duhur e shtratit. Poor, nëse përshëndesim dhe i afrohem tjetrit, e përqafojmë pastaj e puthim dhe e shikojmë me intensitet, këto janë sinjale shumë të forta që na tregojnë se na intereson realisht që tjetri të ketë një mëngjes të mirë. Madje, po t’i shkelim syrin përgjatë përshëndetjes, ne, ndoshta, dimë (ose duam të dimë) edhe nëse ka patur një natë të mirë apo jo.

Komunikimi ndër-njerëzor është kompleks. Ne komunikojmë përmes fjalës dhe trupit, përmes tingujve dhe shenjave, përmes atyre që themi dhe atyre që bëjmë. Dhe, në çdo rast, sigurohemi (të paktën këtë mendohet se të duhet

të bëjmë) që ne dhe tjetri të kemi të njëjtën mënyrë të kuptuari të sinjaleve që marrim përmes këtyre kanaleve të komunikimit. Sot, kur mjetet dhe kanalet e komunikimit me natyrë teknologjike jo vetëm që janë sofistikuar ndjeshëm, por edhe ndryshojnë vazhdimisht, ne duhet të ripërcaktojmë vazhdimisht ndikimin e tyre në marrëdhëniet sociale.

A i shërbejnë realisht marrëdhëniet njerëzore mjetet teknologjike të komunikimit? A ndihmon telefonia celulare në forcimin e lidhjeve sociale? A ndihmon Facebook-u, Twitter-i, Skype-i apo gjithfarë rrjeti tjetër social që, vërtet, të krijojnë rrjete sociale?

Studime të shumta tregojnë se njerëzit që janë socialë, të prirur për të bashkëbiseduar dhe

për të bashkëndarë me të tjerët, energjikë dhe të dhënë pas aktiviteteve me natyrë ndërvepruese janë gjithashtu të prirur që të konsumojnë kohë të gjatë në rrjetet sociale. Çfarë do të thotë kjo? Do të thotë se komunikimi kibernetik është plotësisht i sinkronizuar me cilësitë e tyre personale komunikuese dhe marrëdhënore dhe, mbi të gjitha, që këta ndjehen shumë mirë me raportin (edhe intensiv) që kalojnë nëpër rrjete sociale. Nga ana tjetër, rrjetet sociale kanë një ndikim shumë pozitiv të njerëzimit me natyrë të ndrojtur, të cilët e kanë të vështirë të komunikojnë ballë për ballë dhe, ca më të vështirë akoma, të krijojnë marrëdhënie që do të varen pikërisht nga suksesi i komunikimit.

I kini parasysht njerëzimit

Nëse bëjmë miq të rinj, nëpër radhë të ndryshëm, disa prej miqve të vjetër harrohen ose spostohen. Ndërkohë, në rrjetet sociale, ne konsumojmë kohë duke komunikuar me shumë më tepër se kaq njerëz dhe, mbi të gjitha, në nivele të përziera marrëdhëniesh.

Numri i ‘miqve’ online e kapërcen shumëfish kapacitetin tonë për t’u investuar në këto raporte në botën reale.

Dhe ka një presion në rritje për ta bërë gjithnjë edhe më të madhe ‘turmën e miqve’ online, a thua se jemi në një garë të fshehtë. Në rrjetin social Facebook, p.sh., ka një rregull, sipas të cilit mund të pranohen të bëhen ‘miq’ deri në 5000 persona. Në fakt, Facebook-u qartëson se këta nuk janë ‘miq’, por janë ‘lidhje’.

e ndrojtur? Ata që skuqen kur duan të flasin? Ata që kanë vështirësi për të gjetur fjalën e duhur dhe iu merret goja? Ata që e kanë të vështirë të shihen sy më sy me të tjerët? E pra, njerëzit që e kanë të vështirë komunikimin ballë për ballë nuk janë as një, as dy. Ka të ngjarë që edhe ti që lexon këtë artikull të jesh njëri prej tyre. Komunikimi kibernetik ua lehtëson ndjeshëm jetën (madje, edhe atë sociale) këtyre individëve. Komunikimi përmes rrjeteve sociale mban në këmbë lidhjet familjare të vëna në provë dhe vështirësi nga largësitë prej emigrimit, nga lëvizjet në distancë për punë më të mira apo shkollim më të mirë, etj. Në një botë në të cilën prosperiteti përgjithë-

sisht nënkupton largësinë, komunikimi teknologjik është ura që lehtëson vazhdimësinë e lidhjeve.

Megjithatë, do të duhet të pranojmë se, përgjithësisht, jo të gjitha marrëdhëniet online arrijnë të jenë edhe marrëdhënie sociale në botën reale. Dhe kjo për disa arsye.

Së pari, sepse numri i ‘miqve’ online e kapërcen

shumëfish kapacitetin tonë për t’u investuar në këto raporte në botën reale. Dhe ka një presion në rritje për ta bërë gjithnjë edhe më të madhe ‘turmën e miqve’ online, a thua se jemi në një garë të fshehtë. Në rrjetin social Facebook, p.sh., ka një rregull, sipas të cilit mund të pranohen të bëhen ‘miq’ deri në 5000 perso-



KOHA

Sipas vetë Facebook-ut, ne shpenzojmë rreth 50 minuta çdo ditë në FB, nga të cilat vetëm ½ e kohës është komunikim ndërpersonal. Koha tjetër është një kërcim nga informacionet e shkurtra te lojërat dhe mundësitë e blerjeve online. Në këto kushte, me të drejtë, pyesim nëse komunikojmë me tjetrin, apo rrjeti social është bërë vetë tjetri?

na. Në fakt, Facebook-u qartëson se këta nuk janë 'miq', por janë 'lidhje'. Pasi plotësohet ky numër, në atë profil nuk mund të ketë më hyrje të reja, por vetëm aktivitete të tilla si 'pëlqime', 'komente', etj. A mund të përpiqemi t'i gjejmë një përgjigje pyetjes: Si mund të mbahen 'lidhje' me 5000 njerëz? Imagjinoni kohën që do të

nevojitet për të shkruajtur një fjali për secilin prej tyre. Të mendosh, pastaj, që dikush edhe mund të të kthejë përgjigje. Kur pas përgjigjes, të bën një pyetje të cilës ti duhet t'i përgjigjesh patjetër. Sa orë nga 24-orëshi i përditshëm do të merrte ky komunikim? Nuk ia vlen të lodhemi për ta llogaritur pasi askush nuk komunikon



me të gjithë 'miqtë' që ka në profil dhe, ca më pak, me 5000 të tillë. Atëherë, përse i kemi kaq shumë 'miq kibernetikë' kur nuk komunikojmë me ta për të mbajtur marrëdhënien? Sipas vetë Facebook-ut, ne shpenzojmë rreth 50 minuta çdo ditë në FB, nga të cilat vetëm 1/2 e kohës është komunikim ndërpersonal. Koha tjetër është një kërcim nga informacionet e shkurtra të lojërave dhe mundësitë e blerjeve online. Në këto kushte, me të drejtë, pyesim nëse komunikojmë me tjetrin, apo rrjeti social është bërë vetë tjetri?

Për më tepër, një pjesë e konsiderueshme e marrëdhënieve online nuk arrijnë dot asnjëherë të kthehen në marrëdhënie sociale në botën reale, për shkak të faktit se komunikimi kibernetik ka të tjera cilësi nga komunikimi njerëzor. Fjala vjen, në botën reale nuk mund të ecim me filtra në dorë për të nxjerrë më shumë në pah tiparet që na bëjnë të ndjehemi mirë dhe të sfumojmë deri në inekzistencë tiparet që nuk na pëlqejnë. Imagjinoni, a mund të ecim nëpër rrugë duke zvogëluar hundën ose veshët, duke 'zhdukur' si me magji

KOMUNIKIMI KIBERNETIK

Një pjesë e konsiderueshme e marrëdhënieve online nuk arrijnë dot asnjëherë të kthehen në marrëdhënie sociale në botën reale, për shkak të faktit se komunikimi kibernetik ka të tjera cilësi nga komunikimi njerëzor. Fjala vjen, në botën reale nuk mund të ecim me filtra në dorë për të nxjerrë më shumë në pah tiparet që na bëjnë të ndjehemi mirë dhe të sfumojmë deri në inekzistencë tiparet që nuk na pëlqejnë. Imagjinoni, a mund të ecim nëpër rrugë duke zvogëluar hundën ose veshët, duke 'zhdukur' si me magji kokën qerose dhe duke i falur vetes edhe nja 20 cm gjatësi, si pa të keq?

kokën qerose dhe duke i falur vetes edhe nja 20 cm gjatësi, si pa të keq? E pra, online ne mund të shfaqemi si modelet e koptinave të modës së fundit në Paris apo Milano, kur në fakt jemi thjesht një grua rreth të dyzetave, me rrudha rreth syve dhe kile të tepërta në bark dhe jo vetëm. Dhe kjo panoramë është vetëm gjysma e pikturës. Sepse të njëjtën gjë mund ta bëjë secili prej 'miqve tanë kibernetikë'. Dhe komunikimi online midis dy modeleve hollivudiane, kur shikon dritën e botës reale, i largon këta dy njerëz (në mos nuk iu jep asnjëherë mundësinë të takohen përballë). Dhe sërish na lind pyetja nëse komunikojmë me tjetrin, apo rrjeti social është bërë vetë Tjetri?

Tek e fundit, teknologjia e informacionit është një tregues zhvillimi. Do të ishim të padrejtë ta akuzonim zhvillimin e teknologjisë së informacionit për panoramën e sotme të marrëdhënieve sociale. Në ditët e sotme dëgjojmë për gjithfarëlloj marrëdhëniesh humano-kibernetike; terapist kibernetik (terapist i cili e ofron shërimin online dhe me të cilin pacienti nuk takohet asnjëherë ballë për ballë); bebisiter teknologjik (celulari dhe çdo mjet tjetër i komunikimit teknologjik që prindërit iu lënë në dorë fëmijëve për t'i mbajtur të zënë ndërkohë që ata vetë bëjnë diçka tjetër, ose nuk janë fare në shtëpi), mësues kibernetik (mësues i

cili e ofron mësimdhënien përmes programeve kompiuterike). A janë këto lloje marrëdhëniesh të reja më të mira se ato që njohim ne? Personalisht nuk di ta them. Por, me siguri unë nuk mund të them se teknologjia e informacionit është kërcënimi më i madh i kohës dhe marrëdhënieve njerëzore. Nuk mund të them se rrjetet sociale janë kurthi më i madh i iluzionit për jetë dhe përkatësi sociale. Nuk mund të them se revolucioni kibernetik është një revolucion antihuman/antisocial.

Ajo që mund të them, me shumë siguri, është që kemi nevojë të ndalemi dhe të kuptojmë nëse rrjetet sociale, komunikimi online dhe të tjera modalitete të teknologjisë së informacionit janë realisht rruga jonë për te tjetri, apo janë kthyer në vetë tjetrin. Unë besoj se nuk ka një përgjigje të duhur për këtë dilemë. Mund të jetë edhe njëra, edhe tjetra. Vetëm se na takon përgjegjësia ta dimë se cila prej tyre është. Kështu do të dimë se si të raportohemi me veten dhe marrëdhëniet njerëzore në botën reale në të ardhmen. Në të kundërt, nëse dështojmë ta zgjidhim këtë dilemë, do të vazhdojmë t'i biem në hak pa të drejtë zhvillimit të teknologjisë, që mund të bëjë mjaft zarare të tjera, por nuk mund të jetë kursesi përgjegjës për marrëdhëniet njerëzore, që janë tërësisht (na pëlqen apo jo) përgjegjësi e vetë njerëzve. ■





KLEMENTIN MILE

ANJA

E ERRËT

E TEKNOLOGJISË





Për shkak të teknologjisë, të gjitha distancat në kohë dhe hapësirë po zvogëlohen, e megjithatë ky zvogëlim i ngutshëm distancash nuk po sjell afërsi; sepse afërsia nuk ka të bëjë me sasinë e vogël të distancës. Ne jemi bërë thujasë të paaftë për ta përjetuar këtë afërsi, e jo më për ta kuptuar atë, pasi të gjitha gjërat na paraqiten gjithnjë e më shumë si teknologjike.

TELEFONI
ZHVENDOSËS

UNË NUK E DI CILI ËSHTË MODELI më i avancuar i celularëve. Natyrisht, shumëkush mund të më quajë të prapambetur ose, së paku, të painformuar. Në fakt, rasti im qëndron në minorancë: të pak-të janë sot njerëzit që nuk dinë, thuajse, gjithçka në lidhje me avancimet në fushën e teknologjisë së telefonisë celulare. Por, sidoqoftë, ajo që më bën përsh-tytje është se celulari përdoret shumë më tepër për t'u lidhur me rrjetet sociale dhe për të bërë foto, sesa për të komunikuar me tjetrin përmes zërit. Në këtë mënyrë, celulari, tashmë, është vetëm porta kryesore nga ku duhet kaluar për të hyrë në porta dhe portale të tjera. Në fakt, në pamje të parë, kështu mund të shpjegohet prirja e habitshme e njerëzve për t'iu përkushtuar kaq shumë celularit, saqë thua-ajse i harrojnë fare njerëzit më të cilët janë ulur në tavolinën e

një lokali – një tavolinë në të cilën, pastaj, mbretëron heshtja dhe dëgjohe vetëm klikimet në ekranet 'smart' të celularëve.

Por, çfarë tregon ky fenomen për gjendjen historike të njeriut dhe, më tej, për vetë natyrën njerëzore? Së pari, është e qartë që celulari na mundëson të zhvendosemi në hapësirë. Por fakti që e përdorim celularin më së shumti për aksesuar rrjetet sociale, dhe jo aq shumë për të komunikuar me persona të tjerë për të kryer punë të ndryshme, dëshmon se është më shumë dëshira që na shtyn të zhvendosemi dhe jo detyra. Veçse pyetja mbetet: Ku është vendi i natyrshëm i njeriut në hapësirën e botës, përderisa njeriu vetëm zhvendoset? Cili është, në fakt, kuptimi i zhvendosjes?

Esenca e celularit (telefonit zhvendosës) i përket esencës së zhvendosjes dhe mund të qa-



rtësohet vetëm prej saj. Por, cila është esenca e zhvendosjes, çfarë do të thotë të zhvendosesh? A nuk do të thotë të lësh pas një vend për të shkuar te një tjetër, por edhe këtë të dytin ta lësh pas për një të tretë? Pra, të zhvendosesh do të thotë të mos kesh interesa, por vetëm të kesh gjëra interesante në jetë. Siç shkruan filozofi gjerman Martin Heidegger, termi 'interes' vjen nga latinishtja (inter+esse) dhe do të thotë të jesh midis gjërave dhe të qëndrosh aty. Nga ana tjetër, 'interessantja' nuk nënkupton qëndrimin, por largimin nga një gjë dhe zëvendësimin e saj me një tjetër – pra zhvendosjen. Në këtë mënyrë, esenca e zhvendosjes është interessantja: mungesa totale e interesit.

Humbja e interesit për njeriun do të thotë humbje të vendit në botë; do të thotë që njeriu nuk e kupton më jetën dhe prandaj e zëvendëson me jetesën; do të thotë që pyetja vlerore "Çfarë duhet bërë?" është e sikletshme dhe prandaj zëvendësohet nga pyetja programore "Si duhet bërë?". Kushdo që merr përsipër këtë zëvendësim pyetjesh është i mirëpri-

tur nga njerëzit dhe fiton mirënjohjen e tyre. Këtu qëndron edhe suksesi i teches, i teknologjisë, dhe i atyre që paraqiten si zotërues të saj: manaxherëve, administratorëve, konsulentëve, inxhinierëve, instrukturëve, teknikienëve. Të gjithë këta na ndihmojnë të bëjmë jetë interesante, pa ngritur pyetje për kuptimin e jetës sonë. Të gjithë këta na ndihmojnë të zhvendosemi, na ndihmojnë që, ashtu sikundër përfytyrohet Zoti, të jemi gjithkund dhe të largohemi prej gjithçkaje, pa qëndruar konkretisht diku dhe në ndonjë gjë.

Pra, njeriu nuk është askund "në shtëpi" në botën që jeton; nuk ka një vend të natyrshëm për të. Çdo vend në të cilin gjendet, njeriut i shfaqet si i huaj dhe vetë njeriu e sheh veten "të hedhur në botë" nga një forcë që nuk ia di as emrin, as arsyen. Prandaj njeriu, në dallim nga kafshët, bimët dhe sendet, përshkruhet që prej kohës së filozofisë dhe poezisë së lashtë greke si "i pastrehë". Një celular teknologjikisht i avancuar, qoftë ky Iphone apo Samsung, nuk i jep strehë njeriut në botë, por i jep mundësinë ta kalojë jetën si i pastrehë.

CELULARI

Esenca e celularit (telefonit zhvendosës) i përket esencës së zhvendosjes dhe mund të qartësohet vetëm prej saj. Por, cila është esenca e zhvendosjes, çfarë do të thotë të zhvendosesh? A nuk do të thotë të lësh pas një vend për të shkuar te një tjetër, por edhe këtë të dytin ta lësh pas për një të tretë? Pra, të zhvendosesh do të thotë të mos kesh interesa, por vetëm të kesh gjëra interesante në jetë.

TEKNOLOGJIA
SI ZBULESË

Kjo analizë i korrespondon shkrimeve të Heidegger-it për teknologjinë. Te vepra e tij madhore “Qenia dhe Koha” ai zhvillon argumentin që veprimtaritë teorike, siç janë shkencat natyrore, varen nga këndvështrime të kohës dhe të hapësirës që e ngushtojnë të kuptuarit implicit të mënyrës se si ne përballemi me botën e zakonshme të veprimit dhe të shqetësimit. Ne nuk mund të ndërtojmë distancë dhe drejtim të kuptimit dhe nuk mund të kuptojmë mundësitë për veprim nisur nga të kuptuarit matematik dhe neutral që ka shkencën për hapësirën dhe kohën. Në fakt, ky këndvështrim shkencor “objektiv” dhe i veçuar i botës e kufizon të kuptuarit e përditshëm. Por, e vërteta është se përvoja jonë e botës është më themelore se të kuptuarit shkencor të kohës, hapësirës dhe natyrës.

Këtë të kuptuar të përvojës Heidegger-i e fokuson më vonë te çështja e teknologjisë. Te “Leksionet e Bremenit” (1949) Heidegger shkruan se, për shkak të teknologjisë, të gjitha distancat në kohë dhe hapësirë po zvogëlohen, e megjithatë ky zvogëlim i ngutshëm distancash nuk po sjell afërsi; sepse afërsia nuk ka të bëjë



me sasinë e vogël të distancës. Ne jemi bërë thajse të paafte për ta përjetuar këtë afërsi, e jo më për ta kuptuar atë, pasi të gjitha gjërat na paraqiten gjithnjë e më shumë si teknologjike. Gjithçka na paraqitet thjesht si burim energjie ose si diçka që duhet ta organizojmë. Madje edhe kapacitetet njerëzore ne i trajtojmë sikur të ishin vetëm mjete për procedurat teknologjike, si atëherë kur një punëtor bëhet veçse instrument prodhimi. Çdo gjë që na paraqitet teknologjikisht e humbet pavarësinë dhe formën e saj dalluese. Ne i mënjanojmë ose, thjesht, nuk arrijmë t'i

“ **Edhe kapacitetet njerëzore ne i trajtojmë sikur të ishin vetëm mjete për procedurat teknologjike, si atëherë kur një punëtor bëhet veçse instrument prodhimi. Çdo gjë që na paraqitet teknologjikisht e humbet pavarësinë dhe formën e saj dalluese.**



SITUATA

Përplekjet e zakonshme për ta rregulluar situatën nuk e zgjidhin problemin dhe janë, në fakt, pjesë e problemit. Ne priremi të besojmë se teknologjia është një mjet për qëllimet tona dhe një veprimtari njerëzore që e kemi në kontroll. Por e vërteta është se kontrolli dhe drejtimi janë veçse kontroll dhe drejtim teknologjik. Teknologjia nuk mund të kontrollohet, është ajo që na kontrollon. Përplekjet tona për ta zotëruar teknologjinë mbesin brenda mureve të saj, duke i bërë ato edhe më të forta. Këndvështrimi “instrumental” i teknologjisë, sipas të cilit ajo është vetëm një mjet për të realizuar qëllimin, është patjetër korrekt, por ama nuk na tregon esencën e teknologjisë.

shohim mundësitë e tjera.

Përplekjet e zakonshme për ta rregulluar situatën nuk e zgjidhin problemin dhe janë, në fakt, pjesë e problemit. Ne priremi të besojmë se teknologjia është një mjet për qëllimet tona dhe një veprimtari njerëzore që e kemi në kontroll. Por e vërteta është se kontrolli dhe drejtimi janë veçse kontroll dhe drejtim teknologjik. Teknologjia nuk mund të kontrollohet, është ajo që na kontrollon. Përplekjet tona për ta zotëruar teknologjinë mbesin brenda mureve të saj, duke i bërë ato edhe më të forta. Këndvështrimi “instrumental” i

teknologjisë, sipas të cilit ajo është vetëm një mjet për të realizuar qëllimin, është patjetër korrekt, por ama nuk na tregon esencën e teknologjisë. Ai është korrekt, pasi thotë diçka me vend për teknologjinë, por nga ana tjetër ky këndvështrim është esencialisht i pavërtetë sepse nuk arrin të shohë se si teknologjia është një mënyrë e paraqitjes së të gjitha entiteve, jo vetëm e makinerive dhe e proceseve teknike. Sipas Heidegger-it rreziku i teknologjisë qëndron në faktin se ajo i zhvendos entitetet nga çka ishin origjinalisht, duke na bërë të paaftë për t'i përjetuar ato vërtetësisht.

**ESENCA E
TEKNOLOGJISË**


Esenca e teknologjisë është se ajo nuk mund të kontrollohet. Heidegger zbuloi katër tipare të kësaj esence.

Së pari, esenca e teknologjisë nuk është diçka e bërë prej nesh; ajo është një mënyrë të qenuri ose zbuluese. Kjo do të thotë që gjërat teknologjike kanë llojin e tyre të ri të pranisë, rezistencës dhe lidhjeve ndërmjet pjesëve dhe tërësive. Ato kanë mënyrën e tyre të paraqitjes së vetes dhe të botës ku operojnë. Për Heideggerin, esenca e teknologjisë nuk është instanca më e mirë apo më karakteristike e teknologjisë, nuk është as një përgjithësim i mjegullt, dhe nuk është as formë, as ide. Përkundër këtyre alternativave, ta konsiderosh teknologjinë esen-

cialisht do të thotë ta shohësh si një ngjarje së cilës ne i përkasim: strukturimit dhe renditjes së gjithçkaje rreth nesh dhe të neve vetë. Teknologjia e zëvendëson lidhjen familjare të pjesëve me tërësitë; gjithçka është vetëm një pjesë e këmbyeshme. Për shembull, ndërsa një ari apo pemë mund të qëndrojë më vete dhe të ketë praninë e vet, një celular nuk mundet: celulari sfidohet të prodhojë një pasojë, e cila

TIPARET


Esenca e teknologjisë nuk është diçka e bërë prej nesh; ajo është një mënyrë të qenuri ose zbuluese. Kjo do të thotë që gjërat teknologjike kanë llojin e tyre të ri të pranisë, rezistencës dhe lidhjeve ndërmjet pjesëve dhe tërësive. Ato kanë mënyrën e tyre të paraqitjes së vetes dhe të botës ku operojnë. Për Heideggerin, esenca e teknologjisë nuk është instanca më e mirë apo më karakteristike e teknologjisë, nuk është as një përgjithësim i mjegullt, dhe nuk është as formë, as ide.



gjithashtu pritet të sjellë pasoja të tjera në rrjetin e teknologjisë. Ky zinxhir nuk lëviz drejt ndonjë gjëje që ka praninë e vet, por vetëm hyn në rrjet duke rregulluar dhe siguruar burimet natyrore dhe energjitë pambarimisht. Makineritë dhe pjesët e tjera të inventarit teknologjik nuk janë pjesë të tërësive që rrinë më vete, por vijnë vetëm pjesë-pjesë. Këto pjesë janë të izoluar, uniforme dhe të këm-

byeshme. Ne mund ta zëvendësojmë një pjesë teknologjike me një tjetër. Përkundër kësaj, dora ime nuk është pjesë e imja. Unë jam tërësisht vetja në secilin gjest të dorës çdo herë.

Së dyti, teknologjia sundon edhe mbi entitete që normalisht nuk i mendojmë si teknologjike, bie fjala perënditë dhe historia. Esenca e teknologjisë sulmon gjithçka që është: natyrën dhe historinë,



“ Esenca e teknologjisë është parësisht një çështje e teknologjisë moderne dhe industriale. **Esenca e teknologjisë shfaqet në fabrika dhe procese industriale, jo në parmenda e çekiçë.** Gjithçka që na paraqitet teknologjikisht shfrytëzohet për ndonjë përdorim teknik.

njerëzit dhe perënditë. Kur teologët ndodh të përmendin bukurinë e fizikës atomike ose hollësitë e mekanikës kuantike si evidencë për ekzistencën e Zotit, Heidegger-i thotë se ata e kanë vendosur Zotin në domenin e së renditshmes. Në këtë mënyrë Zoti teknologjizohet.

Së treti, esenca e teknologjisë është parësisht një çështje e teknologjisë moderne dhe industriale. Esenca e teknologjisë shfaqet në fabrika dhe procese industriale, jo në parmenda e çekiçë. Gjithçka që na paraqitet teknologjikisht shfrytëzohet për ndonjë përdorim teknik. Nocioni i 'sfidimit' është i rëndësishëm për të kuptuar pse Heidegger-i e sheh esencën e teknologjisë të teknologjia moderne dhe industriale. Kështu, edhe pse njerëzit, që ecin mbi lumin Rin në Gjermani duke përdorur një urë të thjeshtë, duket sikur po e përdorin urën për

ta sfiduar lumin e për ta reduktuar atë në një pjesë të një zinxhiri të pafund përdorimi, ky argument nuk qëndron. Heidegger thotë se ura, në fakt, e lejon lumin të jetë vetvetja, të qëndrojë brenda rrjedhës dhe shtratit të vet. Përkundër kësaj, një hidrocentral e transformon lumin thjesht dhe vetëm në një element të një sekuence për prodhimin e energjisë.

Së katërti, për Heidegger-in teknologjia nuk është thjesht aplikimi praktik e shkencës natyrore. Përkundrazi, shkencë natyrore moderne mund ta kuptojë natyrën në mënyrë tipikisht shkencore vetëm ngaqë natyra, paraprakisht, është shfaqur si një koleksion forcash të llogaritshme dhe të renditshme – pra, teknologjikisht. Në fakt, esenca e teknologjisë nuk e ka origjinën të Revolucionit Industrial i shekullit XVIII; ajo ishte aty para rritjes së mekanizimit. Gjithashtu esenca e teknologjisë nuk e fillon mbretërimin e saj as në shekullin XVII kur lindi shkencë natyrore moderne. Marrëdhënia e shkencës me teknologjinë është e kundërta e asaj që mendojmë. Forcat natyrore dhe materialet i përkasin teknologjisë dhe jo e anasjella. Ishte mendimi teknologjik që e kuptoi fillimisht natyrën në atë mënyrë që ajo mund të sfidohej të çlironte forcat dhe energjinë e saj. Sfidimi i parapriu çlirimit; andaj, esenca e teknologjisë është para shkencës natyrore. Teknologjia moderne nuk është shkencë natyrore e aplikuar, shumë më tepër, është shkencë natyrore moderne aplikimi i esencës së teknologjisë.





SUNDIMI

Teknologjia sundon edhe mbi entitete që normalisht nuk i mendojmë si teknologjike, bie fjala perënditë dhe historia. Esenca e teknologjisë sulmon gjithçka që është: natyrën dhe historinë, njerëzit dhe perënditë. Kur teologët ndodh të përmendin bukurinë e fizikës atomike ose hollësitë e mekanikës kuantike si evidencë për ekzistencën e Zotit, Heidegger-i thotë se ata e kanë vendosur Zotin në domenin e së renditshmes. Në këtë mënyrë Zoti teknologjizohet.

**ÇFARË
RREZIKOJMË?**

Nisur nga ky këndvështrim i teknologjisë rrjedh që çdo shpjegim shkencor e errëson qenien esenciale të gjërave, përfshirë këtu edhe afërsinë e tyre. Pra, kur Heidegger-i diskuton teknologjinë dhe afërsinë, ai na siguron se nuk është duke përsëritur klishe të teknologjia e bën botën më të vogël. “Ajo që është vendimtare, – shkruan ai, – nuk është që distancat po shkurtohen me ndihmën e teknologjisë, por që afërsia mbetet e jashtëzakonshme. Për ta përjetuar afërsinë ne duhet t’i ndeshim gjërat në vërtetësinë e tyre. Dhe, pavarësisht sa shumë besojmë se shkenca do të na mundësojë të ndeshim aktualen në aktualitetin e vet, ajo në fakt na ofron vetëm përfaqësime të gjërave. Gjërat në vërtetësinë e tyre nuk mund të ndeshen kurrë prej shkencës. Shkenca ndesh vetëm atë, mënyra e përfaqësimit e së cilës e ka pranuar paraprakisht si objekt të mundshëm për vetveten.”


Te “Leksionet e Bremenit”, Heidegger-i jep një shembull për të ilustruar këtë ide. Po të flasim shkencërisht, distanca ndërmjet një shtëpie dhe një peme para saj mund të matet në mënyrë neutrale: ajo është 10 metra. Por në jetët tona të përditshme ajo distancë nuk është aq neutrale dhe as aq abstrakte. Përkundrazi, distanca është një aspekt i kujdesit tonë për pemën dhe shtëpinë: përvoja e ecjes, e të parit të trajtës së pemës të rritet ndërsa i afrohem dhe e ndarjes së rritur prej shtëpisë ndërsa i largohemi kësaj të fundit. Në shpjegimin shkencor distanca shfaqet sikur realizohet së pari nga kundërtia midis shikuesit dhe objektit. Duke u bërë indiferentë ndaj kujdesit (apo shqetësimit) tonë për gjërat, duke e përfaqësuar edhe distancën, edhe objektin si entitete matematike të thjeshta, por të dobishme, ose si ide filozofike – ne e humbasim përvojën e vërtetë të afërsisë dhe distancës. Esenca e teknologjisë nuk na pengon vetëm të ndeshim realitetin e botës, por teknologjia tashmë është bërë bota. Teknologjia mbretëron dhe ne e harrojmë tërësisht qenien dhe lirinë tonë esenciale – ne as që e kuptojmë më botën që kemi humbur. ■



LIRIA

Duke u bërë indiferentë ndaj kujdesit (apo shqetësimit) tonë për gjërat, duke e përfaqësuar edhe distancën, edhe objektin si entitete matematike të thjeshta, por të dobishme, ose si ide filozofike – ne e humbasim përvojën e vërtetë të afërsisë dhe distancës. Esenca e teknologjisë nuk na pengon vetëm të ndeshim realitetin e botës, por teknologjia tashmë është bërë bota. Teknologjia mbretëron dhe ne e harrojmë tërësisht qenien dhe lirinë tonë esenciale – ne as që e kuptojmë më botën që kemi humbur.







REDI SHEHU

TEKNO ETIKA

**SI TEKNOLOGJI QË NUK
E NDAN NJERIUN NGA
ATRIBUTET E TIJ**

L O A D I N G



“ Sot, qenia njerëzore po transformohet në një njësi shifrore e cila jeton në postmaterializëm, për shkak se teknologjia po e çon atë përtej përmbushjes së nevojave thjesht materiale.

Marrëdhëniet ndërshoqërore, si dhe ato familjare, tashmë, si asnjëherë më parë përshkohen nga digjitalizimi i ndjenjave. Nevoja të teknologjizuara, që shprehen përmes telefonisë dhe kanaleve të tjera sociale të komunikimit, të cilat katapultohen në klikime tastesh tekanjoze.



IRRETHUAR NGA TË GJITHA ANËT ME MUNDËSI TË PAFUNDME, të cilat shkurtrojnë në mënyrë të vazhdueshme pengesat dhe distancat, njeriu, sot, duket se ka nënshkruar një pakt pothuaj të përjetshëm me teknologjinë. Është pikërisht kjo e fundit që, me shpejtësinë dhe saktësinë e saj marramendëse, është kthyer në mekanizmin i cili ka modeluar këndvështrimin tonë për jetën. Ajo po përçakton agjendën tonë të përditshme, por, mbi të gjitha, ka ndryshuar konceptin tonë për kohën. Shijet tona, perceptimet tona, si dhe një sërë procesesh të natyrshme të njeriut janë modeluar në mënyrë të jashtëzakonshme falë teknologjisë. Mënyra se si jetojmë, si vishemi, si ushqehemi, informacioni që marrim, koha e lirë, së bashku me konceptet tona për të bukurën, të mirën

dhe të shijshmen, në sajë të teknologjizimit nuk janë ato të mëparshmet. Sot, ne jemi transformuar në frymorë që gjallojnë në mesin e një mjedisi rrjetesh dhe sistemesh të telekomanduara të cilat i ofrojnë këtij homo-networkus-imodern, përzgjedhje të pambarimta në një formë të organizuar dhe të strukturuar si mos më mirë. Ne jemi ata që jetojmë në një botë ku pasojat e padëshiruara të teknologjisë zgjidhen po përmes teknologjive, duke krijuar nevoja të reja që kërkojnë përsëri teknologji të reja për t'u zgjidhur.

Sot, qenia njerëzore po transformohet në një njësi shifrore e cila jeton në postmaterializëm, për shkak se teknologjia po e çon atë përtej përmbushjes së nevojave thjesht materiale. Marrëdhëniet ndërshoqërore, si dhe ato familjare, tashmë, si asnjëherë më parë,



përshkohen nga digjitalizimi i ndjenjave. Nevoja të teknologjizuara, që shprehen përmes telefonisë dhe kanaleve të tjera sociale të komunikimit, të cilat katapultohen në klikime tastesh tekanjoze. Kjo ftohtësi ndjesore, e cila përmes rrugëve teknologjike mbërrin më shpejt në destinacion, ka shkurtuar sigurisht distancat kohore, por ka zmadhuar distancat ndijore. Aroma e letrës, një ndjenjë tashmë e kyçur diku në një vend të errët të trurit, është zëvendësuar me fraza teknologjike mesazhesh të akullta. Gjithë këto ndjenja të natyrshme njerëzore mbi të bukurën, të mirën dhe shijen, nga përmasa fiziologjike, në sajë të teknologjisë, kanë marrë përmasën e digjitalizimit të koncepteve njerëzore. Po ashtu, si përmasë digjitale na shfaqet edhe e keqja. Në formë digjitale mund të ndjehesh një ndër kriminelët më të mëdhenj në botë dhe po në

formë digjitale mund të të zhvartet e gjithë llogaria jote bankare. Për më tepër, sot ke luksin që të jesh digjitalisht i paditur në organet përkatëse.

E tërë kjo rendje drejt një shoqërie one-stop-shop, ku këpucët e katalogut brenda një kohe praktikisht të shkurtër të shtrëngohen mbi çorapet e tua ngjyrë vjollcë, gatimi online, pazari elektronik, makina me pilot automatik, gëzimi i tejskajshëm i të qenurit i taksuar, por edhe i licencuar në formë digjitale, faturat elektronike, posta elektronike, lokalizimi satelitor, votimi elektronik, qeveria elektronike, hipotekimi elektronik, gjoja elektronike, dronët dhe dronomania, si dhe dhjetëra gjëgjëza elektronike janë, në fakt, promotori i përparimit të një shoqërie në kohë dhe në cilësinë e gjërave.

RENDI TEKNOLOGJIK

Rendi botëror, padyshim që po kthehet me shpejtësi në një rend të unifikuar teknologjik, ku njeriu, si qendër i këtij rendi, për shkak të tipareve mekanizuese të teknologjisë, nuk po identifikohet si thelb i një qenieje, por po objektifikohet si zgjatim i këtij rendit të ri. Ne, sot, po e trajtojmë njëri-tjetrin në marrëdhëniet tona të përditshme me një make-up teknologjik duke mos përfshirë gjithmonë e më shumë personalen dhe uniken tonë. Filozofi ekzistencialit Paul Tillich e konsideronte teknologjinë si transformuese të njeriut, nga një subjekt personaliteti në një qenie racionale dhe “jopersonale”, i cili, në mënyrë të vazhdueshme, i shkatërron angazhimin e brendshëm të tij.

DREJT KAOSIT TEKNOLOGJIK

Sot ne kemi vërtet bonuse të shumta që na vijnë nga teknologjizimi i mënyrës sonë të jetesës, duke filluar që nga standardi më i lartë që na reklamohet si progresi material, si burimi i shpresës, i cili përfundimisht do ta çlirojë njeriun e ri nga tirania e natyrës, që hap siparin e ushtrimit pakufi të lirive njerëzore dhe të shijimit të tyre si kurrë më parë. Sot, teknologjia jep mundësinë e zgjidhjeve të shumëfishta, por në të njëjtën kohë na nxjerr nga pozicioni statik i traditaionale drejt variacioneve të së resë që shpërthen në çdo touch të saj. Digjitalizimi ka çuar në përmirësim të komunikimit tonë me më shumë ndërëkëmbim dhe më shumë të kuptuar në kohë reale. Në këtë botë e cila po kapërcen në një fazë postindustriale, tashmë, pasuria, pushteti dhe fuqia, në fjalët e sociologut Daniel Bell, bazohen më shumë në dijet sesa në pronat, duke e çuar qendrën e pushtetit tashmë në institucio-

net që prodhojnë dhe shpërndajnë dije.

I gjithë ky ndryshim që na shfaqet në shtresa dhe cilësi sociale, i hap udhë ndryshimit të kufijve me të cilët bota ka qenë e formësuar deri më tani. Brendësimi teknologjik i fibrës sociale njerëzore, si ndërgjegje të ndërlidhura në një rrjet tashmë pa kufi, i jep një dimension tjetër lirisë dhe shprehjes krijuese.

Rendi botëror, padyshim, që po kthehet me shpejtësi në një rend të unifikuar teknologjik, ku njeriu, si qendër i këtij rendi, për shkak të tipareve mekanizuese të teknologjisë, nuk po identifikohet si thelb i një qenieje, por po objektifikohet si zgjatim i këtij rendit të ri. Ne, sot, po e trajtojmë njëri-tjetrin në marrëdhëniet tona të përditshme me një make-up teknologjik duke mos përfshirë gjithmonë e më shumë personalen dhe uniken tonë. Filozofi ekzistencialit Paul Tillich e konsideronte teknologjinë si transformuese të njeriut, nga një subjekt personaliteti në një qenie racionale dhe



“jopersonale”, i cili, në mënyrë të vazhdueshme, i shkatërron angazhimin e brendshëm të tij. Ky konstatimi i Tillich-it shfaq krejt të kundërtën e pretendimeve se teknologjia do të rrisë dhe përmbushë nevojat materiale të njeriut deri në atë masë sa do ta orientojë atë drejt një jete më intelektuale dhe shpirtërore. Në fakt, varësia teknologjike shkakton në mënyrë të vazhdueshme “varësi të varësisë” duke prodhuar uri të pafundme teknologjike. Kjo është karakteristikë e kohëve postnormale siç edhe Ziauddin Sardar mjeshtërisht e përshkruan zgjerimin e teknologjisë së komunikimit, e cila e bën këtë të fundit më të lehtë dhe më të shpejtë, një përshpejtim teknologjik i cili të çon drejt një “paniku të vetorganizuar” i paparashikueshëm në kufijtë e kaosit. “Sot ne nuk komuniko-

jmë për të jetuar, por jetojmë për të komunikuar -thotë ai, - dhe, si pasojë e kësaj, përshpejtimi kthehet në normë, parashikueshmëria bëhet gjithnjë më e rrallë dhe ndryshimet e vogla të çojnë drejt pasojave të mëdha.”


“**Varësia teknologjike shkakton në mënyrë të vazhdueshme “varësi të varësisë” duke prodhuar uri të pafundme teknologjike.** Kjo është karakteristikë e kohëve postnormale siç edhe Ziauddin Sardar mjeshtërisht e përshkruan zgjerimin e teknologjisë së komunikimit, e cila e bën këtë të fundit më të lehtë dhe më të shpejtë, një përshpejtim teknologjik i cili të çon drejt një “paniku të vetorganizuar” i paparashikueshëm në kufijtë e kaosit.



Gary Marcus, në një qasje të tij në “The New Yorker”, thoshte se brenda dy apo tri dekadave ndryshimet dhe pasojat e tyre do të jenë aq të mëdha, sa që diferenca mes makinave me robotë automatikë dhe atyre me shoferë njerëzorë do të shkojë deri aty sa ne humanët ligjërisht të mos lejohehi të ngasim makinën tonë, por edhe nëse do të lejohet që ta bëjmë një gjë të tillë, do të quhej e pamoralshme sepse rreziku i dëmtimit të vetes dhe i njerëzve të tjerë nga ana jonë do të ishte shumë më i madh sesa rreziku i ngjarjes së makinës nga një robot automatik. Një fakt ky që nuk duket i largët, aq sa

nuk është e largët kërkesa për t’i pajisur makineritë me një ndërgjegje apo sens moraliteti në një botë të superelektro-nizuar, ku kufijtë mes subjektit njerëzor dhe objektit teknologjik duket se po zbehen me shpejtësi.

Një shoqëri si kjo e sotmja, e automatizuar dhe kompjuterizuar, ka shumë pak shanse të prodhojë diversitet kulturor dhe tenton gjithnjë e më tepër drejt uniformitetit të mendimit dhe sjelljes, që vjen nga uniformiteti i mjeteve të komunikimit masiv si “kostum social” i të gjitha civilizimeve. Tipar i këtij “kostumi social” është të



“ Për shkak se teknologjia përshkon një sërë strukturash dhe ndërlihet me to, si në rastin e agjencive apo institucioneve qeveritare dhe korporatave të mëdha, atëherë ajo bëhet më e ndërlikuar dhe komplekse duke u quajtur shpesh edhe si “teknokompleks”, një formë ku, jo rrallë, qëllimet e kërkimit shkencor dhe të vetë teknologjisë përcaktohen nga synimet apo objektivat e institucioneve që i prodhojnë ato, ku mirëqenia e njerëzve dhe mjedisi në të cilin jetojmë kalojnë në plan të dytë.

TEKNOKOMPLEKSI

Për shkak se teknologjia përshkon një sërë strukturash dhe ndërlihet me to, si në rastin e agjencive apo institucioneve qeveritare dhe korporatave të mëdha, atëherë ajo bëhet më e ndërlikuar dhe komplekse duke u quajtur shpesh edhe si “teknokompleks”, një formë ku jo rrallë qëllimet e kërkimit shkencor dhe të vetë teknologjisë përcaktohen nga synimet apo objektivat e institucioneve që i prodhojnë ato, ku mirëqenia e njerëzve dhe mjedisi në të cilin jetojmë kalojnë në plan të dytë. Në raste të tilla, problemi më i madh që shfaqet në rrafshin etik, në lidhje me tokologjitë e aplikuar, është se pushteti i cili përcakton dizenjimin, apo edhe prodhimin e teknologjive të reja, nuk përbëhet nga struktura demokratike, por nga qarqe shpesh të mbyllura dhe interesa të ngushtë të një “elite teknologjike”, e cila është e lidhur me mijëra fije me pushtetin, duke e kthyer teknologjinë në një nga

qenurit një teknologjie pacak, e cila nuk mund të ndalet dhe ngjan tashmë me mjetin që i janë prishur frenat. Caku i saj përcaktohet deri aty ku shihen fillimet e kaosit teknologjik, deri aty ku njerëzit të kuptojnë pafuqinë e tyre për të kontrolluar dhe drejtuar sistemet teknologjike të cilat në një mënyrë apo një tjetër i skllavërojnë në formë “të vetëpëlqyer” njerëzit dhe i detyrojnë ata që t’i adaptohen asaj. Karakteristikë e këtij adaptimi është dehumanizmi ynë i vazhdueshëm drejt një rendjeje imponuese racionale në kurriz, gjithnjë e më tepër, të spontanitetit dhe lirshmërisë.

“Përmes imazhit 4K të ekranit të një pajisjeje të hollë sa kompensata e dikurshme, njeriu sot, i ulur në një cep të dhomës, i futet një soditjeje të këndit më të largët të rruzullit, duke hulumtuar për specie e krijesa njerëzore që ndryshe nuk do të kishte patur asnjë mundësi t’i shihte për sa kohë të gjallonte. Pastaj, mjafton të shtypë një buton të vetëm, dhe e tërë zallamahia e një metropoli botëror futet zhurmshëm, me efekt audio surround, në sallonin e tij. Një mesazh në celular e lajmëron se sapo ka sosur një e-mail e, kështu, me një shtrirje të dorës, kap laptop-in e vet dhe komunikon me Skype me mikun e vjetër, të cilin herën e fundit e pati takuar në adoleshencën e hershme. Një telefonatë e shpejtë në celular i jep kënaqësinë e një pice-taksi, të ardhur me shpejtësinë e imagjinatës te pragu i derës, e cila, plot avull të ngrohtë, mbyt ajrin e klimatizuar e të personalizuar të sallonit të ndenjes.

instrumentet më të madha dhe efikase të këtij pushteti.

Teknokompleksi, si fenomen, karakterizohet nga etika e egos ekonomike, e cila sigurisht që nuk garanton një shpërndarje të ristrukturuar dhe të drejtë të produktit teknologjik më afër nevojave të njerëzve dhe jo vetëm në ekskluzivitet të korporatave apo institucioneve qeveritare. Këtu nuk bëhet fjalë për smartfonët të cilët janë një mjet i sofistikuar për ta drejtuar individin e ri digjital drejt mjedisit gjithnjë e më të teknokompleksuar, i cili, për shkak të lidhjes trekëndore me pushtetin, në vend që të

kthehet në një burim lehtësimi njerëzor, në fakt prodhon skllëvërit e rinj digjitalë të postmodernitetit. Kjo e ka detyruar sot njeriun që të luhetet mes dy pozicioneve, të cilat përfaqësohen nga një rehatim deri në ekstrem me produktin teknologjik nga njëra anë dhe nga pozicioni tjetër i braktisjes totale dhe vetmisë ndaj teknologjisë si ekstremi tjetër. Pra, sa më shumë t’i largohet etikës njerëzore dhe t’i afrohet asaj të egos ekonomike, teknologjia merr trajtën e një mekanizmi dikotomik, i cili, edhe pse shfaqet kompleks, në fakt, e ndan individin e sotëm më dysh.



IDENTITET TEKNOLOGJIK ME SENS ETIK

Përmes imazhit 4K të ekranit të një pajisjeje të hollë sa kompensata e dikurshme, njeriu sot, i ulur në një cep të dhomës, i futet një soditjeje të këndit më të largët të rruzullit, duke hulumtuar për specie e krijesa njerëzore që ndryshe nuk do të kishte patur asnjë mundësi t'i shihte për sa kohë të gjallonte. Pastaj, mjafton të shtypë një buton të vetëm, dhe e tërë zallamahia e një metropoli botëror futet zhurmshëm, me efekt “audio surround”, në sallonin e tij. Një mesazh në

celular e lajmëron se sapo ka sosur një e-mail e, kështu, me një shtrirje të dorës, kap laptop-in e vet dhe komunikon me Skype me mikun e vjetër, të cilin herën e fundit e pati takuar në adoleshencën e hershme. Një telefonatë e shpejtë në celular i jep kënaqësinë e një pice-taksi, të ardhur me shpejtësinë e imagjinatës te pragu i derës, e cila, plot avull të ngrohtë, mbyl ajrin e klimatizuar e të personalizuar të sallonit të ndenjes. Pasi shijon një kafe me minieskpresin e tij digjital, jep porositë online për çështjet e punës. Më pas bën një “shtrëngim duarsh” me të

gjithë miqtë e tij në Facebook, duke u çmallur dhe duke shkëmbyer ndjenjat reciproke për gatatën e radhës.

Shfaqjet e sotme të teknologjisë kanë çuar në ndarje të diturisë nga urtësia. Kjo formë e instrumentalizon teknologjinë dhe e kthen atë në një instrument të modernitetit, i cili e përdor atë në varësi të kontekstit që mund të jetë i drejtë ose i gabuar. Pra, kjo formë kontekstuale e aplikimit të teknologjisë ka bërë që grupe të tëra komunitare njerëzish në një epokë si kjo e jona e individualizimit dhe atomizimit social, të fragmentarizuar deri në skaj, të gjejnë identitetin e tyre të përbashkët, në mënyrën si sillen dhe si mendojnë, pikërisht te teknologjia moderne. Në fakt, ky është një identitet i ri, një identitet teknologjik i cili silllet jashtë të qenurit etik dhe pa një qëllim fundor. Si e tillë, pa një qëllim e objektiva të paracaktuar, ajo i ngjan më shumë një teknologjie të post-modernitetit, e cila është në nevojë më shumë se kurrë të një thelbi etik në kontekstin e saj.

Në fillimet e veta teknologjia moderne u pa si një fenomen i cili karakterizohej nga “neutraliteti i vlerave”, që ishte më afër kuptimit instrumental mbi teknologjinë. Pra një teknologji ku etika nuk ishte pjesë e softit të vet, por që këto vlera do t’i shtoheshin asaj në varësi të kontekstit në të cilën ajo përdoret. E vetmja etikë që e bashkëshoqëron atë sot është etika e mirëqenies, që spikat si turravrap drejt këtij destinacioni i cili përthyer në të gjitha dimensionet dhe shtresat sociale e institucionale. Për këtë, e gjithë qenia e secilit, e gjithë qenia kolektive është vënë në funksion të ndërtimit teknologjik, veçanërisht dhe posaçërisht, të mirëqenies. Përveç kësaj të fundit, nuk nevojitet asgjë tjetër, sepse mirëqenia do të përcaktojë gjithçka. Pra, me pak fjalë, mirëqenie në funksion të mirëqenies! Dhe këtu fillon

gara për gjetjen e çfarëdoj mekanizmi teknologjik që prodhon mirëqenie. Kështu, në fund të hesapeve, mënyra se si konceptohet ekzistenca sot reduktohet në disa makineri teknologjike që bashkëveprojnë me disa makineri biologjike, në ca torno që prodhojnë vetëm detaje të mirëqenies, për të ndërtuar mirëqenien e madhe, e cila shumë shpejt do të ketë nevojë për përmirësime në rrugën e përqindjeve të rritjes së mirëqenies. Ku gara mes popujsh tashmë është kornizuar në disa presje dhjetore mbi mirëqenien, ku forca, e drejta dhe simpatia për popuj përcaktohen mbi këto përqindje të mirëqenies.

Kur ne krijojmë teknologji të reja, prototipe të avancuara, në një mënyrë apo një tjetër, bëjmë një zgjedhje në lidhje me vlerat. Kështu, ne vendosim ose t’i lëmë mënjane ato, ose t’ua bashkëngjimisim produkteve të reja teknologjike. Është e domosdoshme që vlerat që shoqërojnë teknologjinë e sotme, si krijimtaria, inovacioni, eksplorimi nuk duhen lënë të vetme pa u mbështetur diku, sepse ata rrezikojnë të prodhojnë të mira teknologjike të braktisura nga qëllimi fundor, nëse nuk do të viheshin në baraspeshë me qëllimshmërinë e mirë, moderimin dhe për plotësimin e drejtë njerëzor. Nëse teknologjia e sotme, në formë të pavetëdijshme, po distancon njerëzit nga atributet e tyre njerëzore duke i robotizuar ato gjithnjë e më shumë, mbështetja në një etikë të humanitetit për të prodhuar një teknologji humane i rikthen njeriut atributet e tij pa humbur sukseset teknologjike. Mosdarja e njeriut nga atributet e tij, të cenuara për shkak të zhvillimit kaotik të teknologjisë, është i një rëndësie jo vetëm në rrafshin etik, por edhe human sepse e shpëton njeriun nga prirja që zhvillimi teknologjik ka, atë të krijimit të një kulture të vetme globale të sjelljes dhe perceptimit që shkatërron ato lokalet. Siç edhe

Heidegger e përcakton në qasjen e tij fenomenologjike, ku thotë se teknologjia nuk ka të bëjë thjesht vetëm me pajisjet teknologjike, por me praktikën e kulturës teknologjike, e cila shfaq mënyrën se si bota perceptohet dhe formësohet.

Teknologjia, në fakt, duhet dhe është teknoetikë në fund të fundit, sepse çdo hap i cili e përcakton atë, që nga skicimi e deri tek produkti final, nuk mund të jetë i pavarësuar nga konteksti njerëzor në të cilin lind, nga struktura dhe softi kulturor dhe fibra sociale që e përshkon. Ajo, nga njëra anë, u jep formë kulturave të ndryshme duke i tërhequr drejt unifomizimit të tyre drejt një mënyre dhe praktike të vetme teknologjike, por nga ana tjetër është edhe pasqyrim i forcave të ndryshme kulturore që e projektojnë atë.

Shkenca dhe teknologjia kanë nevojë për etikën njerëzore në mënyrë që të jenë të ndërgjegjshme për origjinën dhe suksesin e vet. Këto janë parime etike të dinjitetit human, të vlerave të privatësisë, të mosdëmtimit të tjetrit dhe të drejtësisë. Mohimi i një etike të tillë mund të jetë një qëndrim ideologjik, por aspak shkencor. Ajo që teknologjia ka si efekt anësor në këto ritme është transformimi i ndjenjave në një format pothuajse digjital. Ky digjitalizim i ndjenjave të një shoqërie çon drejt krijimit të një brezi në anonimat të kontaktit ndjesor dhe shpirtëror, një brez individualist deri në skaj, me cilësi vetëmjaftueshmërie të theksuara, i prirur ndaj divorcit dhe i dhënë pas karrierës, kundërshtar i strukturave sociale të konsoliduara, simpatizant i vetmisë, kaosit, shpesh edhe i dhunës. Të rritur tashmë me teknologjinë, kompjuterët, celularët, laptopët, e me çfarëdolloj mjeti tjetër përçues të informacionit, ata e kanë pothuaj të pamundur të kridhen në botën e ndjenjave.

Largimi gjithnjë e më tepër nga natyra



ETIKA

Teknologjia, në fakt, duhet dhe është teknoetikë në fund të fundit, sepse çdo hap i cili e përcakton atë, që nga skicimi e deri tek produkti final, nuk mund të jetë i pavarësuar nga konteksti njerëzor në të cilin lind, nga struktura dhe softi kulturor dhe fibra sociale që e përshkon. Ajo, nga njëra anë, u jep formë kulturave të ndryshme duke i tërhequr drejt unifomizimit të tyre drejt një mënyre dhe praktike të vetme teknologjike, por, nga ana tjetër, është edhe pasqyrim i forcave të ndryshme kulturore që e projektojnë atë.

nuk ka shumë ndryshim nga fenomeni i largimit të individëve nga njëri-tjetri. Trajtimi i natyrës si një sfidë që duhet fituar nuk ka ndryshim nga trajtimi i tjetrit si inferior, i cili duhet anashkaluar. Të jetuarit gjithnjë e më tepër në një botë digjitale e në realitete digjitale, mbyllja brenda kësaj bote, komunikimi me të gjithë, por, në të njëjtën kohë, mosndijimi i të gjithëve, janë duke lënë pasojë në psikën e brezit të ri, i cili ka gjithë botën në tastierë, por ndodhet shumë larg saj për ta kuptuar atë. ■



PUSHTETI

**Mbi politikën,
pushtetin dhe**

**MEDIAT
SOCIALE**



ERVIN MUÇO

Ndër çështjet më të hasura në temat e lëngshmërisë së botës moderne, është thyerja e marrëdhënies midis politikës dhe pushtetit; zhvillimi i idesë së komunitetit nën dritën e shfaqjes së teknologjisë së re, së cilës ai i ngarkon një pjesë të përgjegjësisë për ndryshimin shoqëror që është duke ndodhur; si edhe koncepti i frikës së lëngshme - një ndjenjë e ankthit e cila ka konture të zbehta, por që është prezente kudo.


NË FILLIM TË VITEVE 2011 Afrika e Veriut dhe Lindja e Mesme u përfshinë në protesta të fuqishme kundër qeverive/regjimeve të tyre me qëllim dhënien fund dekadave të shtypjes dhe dhunës kundër qytetarëve. Protestat filluan në Tunizi dhe në vetëm pak javë u përhapën në Egjipt, Jemen, Bahrein, Libi dhe Siri.

Gjatë këtyre revolucioneve një vëmendje e veçantë i kushtua rolit të mediave sociale dhe teknologjisë, që u mundësoi qytetarëve të tejkalonin terrin informativ të mediave të kontrolluara nga shteti. Kjo i dha një kuptim të ri domethënies së hapësirës publike dhe ndikimit të teknologjisë së informacionit në organizimin e lëviz-

jeve qytetare kundër qeverive dhe regjimeve. Megjithatë, kjo pikëpamje, më tepër se sa një fakt i vërtetë, tregon për një fetishizim të teknologjisë, duke lënë në hije faktorë të tjerë të cilët luajnë një rol thelbësor në aktivizimin qytetar. Një sërë pyetjesh të tjera lindin natyrshëm, të tilla si: A është interneti një formë e hapësirës publike? A mundet teknologjia moderne të organizojë protesta qytetare, madje edhe të rrëzojë shtetet? Cili është ndikimi i internetit dhe i teknologjisë së informacionit në marrëdhëniet pushtet-politikë? A janë rrjetet sociale një zëvendësim i hapësirës publike për të reaguar kundër politikave të padrejta dhe abuzimit me pushtetin? Përse njerëzit parapëlqejnë, gjithnjë e më shumë, të protestojnë dhe të orientohen në rrjetet sociale në vend të komuniteteve reale, që ofrojnë kontakte të drejtpërdrejta mes tyre?

SHOQËRIA E LËNGËT

Zygmunt Bauman është i mirënjohur për zhvillimin e konceptit të modernitetit të lëngët, i cili karakterizohet, kryesisht, nga pasiguria, mëdyshja dhe individualizmi. Nëpërmjet këtij koncepti, ai i referohet gjendjes aktuale të shoqërisë sonë, si edhe ndryshimeve, me një ritëm të pazakonshëm, të të gjitha aspekteve të jetës, të tilla si politika, pushteti, shoqëria, dashuria e konsumi. Thellësia e analizës së tij sociologjike e ka



bërë atë ndër përfaqësuesit më të spikatur të kohës tonë.

Ndër çështjet më të hasura në temat e lëngshmërisë së botës moderne, është thyerja e marrëdhënies midis politikës dhe pushtetit; zhvillimi i idesë së komunitetit nën dritën e shfaqjes së teknologjisë së re, së cilës ai i ngarkon një pjesë të përgjegjësisë për ndryshimin shoqëror që është duke ndodhur; si edhe koncepti i frikës së lëngshme – një ndjenjë e ankthit e cila ka konture të zbehta, por që është prezente kudo.

Bauman mendon se shoqëria moderne nuk ka struktura solide, në të cilat ne mund të mbështetemi dhe të investojmë shpresat dhe pritshmëritë tona. Edhe qeveritë më të fuqishme, shumë shpesh, nuk mund t'i mbajnë premtimet e tyre. Ato nuk kanë fuqi (pushtet) të mjaftueshme për ta bërë këtë gjë. Sipas Baumanit, ne jetojmë në një gjendje mëdyshjeje të vazhdueshme, e cila na frikëson neve.

Ai e trajton lëngëzimin (liquefaction) si një çështje të lëvizjes së përshpejtuar, si edhe të kohës së vëzhgimit. Frekuenca me të cilin ndryshimi ndodh na bën ne që ta shohim qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e realitetit si jostabël. Në të vërtetë, është një ndryshim ritmik që ndikon në sjelljen tonë. Shpejtësia e ngjarjeve dhe ndjeshmëria për ndryshime të menjëhershme janë të kombinuara me përshkueshmërinë. Kjo për faktin se

“ Protestat filluan në Tunizi dhe në vetëm pak javë u përhapën në Egjipt, Jemen, Bahrein, Libi dhe Siri. **Gjatë këtyre revolucioneve një vëmendje e veçantë iu kushtua rolit të mediave sociale dhe teknologjisë, që u mundësoi qytetarëve të tejkalonin terrin informativ të mediave të kontrolluara nga shteti.** Kjo i dha një kuptim të ri domethënies së hapësirës publike dhe ndikimit të teknologjisë së informacionit në organizimin e lëvizjeve qytetare kundër qeverive dhe regjimeve.

zhvillimi dhe lehtësia në komunikim, që mundëson arritjen e informacionit në kohë reale duke arritur çdo qoshe dhe hapësirë të vogël, sjell pasoja të paparashikueshme.

Ndërthurja e këtyre elementeve ngjall një përfytyrim të realitetit të lëngët, që ne nuk mund ta kontrollojmë, që rëshket mes gishtave tanë dhe nuk është më i administrueshëm. Vështirësia qëndron në aftësinë për të kontrolluar dhe parashikuar se çfarë drejtimi do të marrë, derisa është shumë vonë dhe na ka udhëhequr drejt pasojave të pakthyeshme.

Pamundësia për të kontrolluar ndryshimet e shpejta, ka pasoja te ne që jetojmë në këtë lloj intervali ndërmjet dy mbretërive midis një mënyre jetese që nuk ekziston më dhe diçkaje të qëndrueshme që nuk ekziston ende -kjo na bën të ndi-

KRIZA

Kriza në konceptin e komunitetit nxit zhvillimin e individualizimit të shfrenuar: njerëzit nuk janë më bashkëqytetarë, por rivalë ndaj të cilëve duhet të kesh kujdes. Ky “subjektivizëm” ka kërcënuar themelet e modernitetit, e ka bërë atë të brishtë, duke prodhuar një rrethanë pa pika reference, ku gjithçka shpërbëhet në një lloj lëngshmërie. Siguria e ligjit ka humbur, gjyqësori shihet si armik dhe e vetmja zgjidhje për individët të cilët nuk kanë pika reference është që ta bëjnë veten e tyre dyshues me çdo kusht, ta trajtojnë dyshimin si një vlerë dhe të ndjekin konsumerizmin. Gjithsesi, ky nuk është një konsumerizëm që synon zotërimin e objekteve të dëshirueshme që prodhojnë kënaqësi, por një që, në mënyrë të menjëhershme, i bën këto objekte të vjetruara / të papërdorshme.

hemi të pasigurt.

NDARJA E POLITIKËS DHE PUSHTETIT

Shoqëria e lëngët është e karakterizuar nga rënia e idesë së demokracisë. Falë procesit të globalizimit, domethënë globalizimit negativ, i cili minon të drejtat dhe identitetin e pakicave, fuqia është përhapur në të gjithë planetin, kështu që nuk është më e lokalizuar në një vend të saktë. Kushtet e pasigurisë, vetmisë dhe frikës për të ardhmen, që karakterizojnë qytetarin global, nuk gjejnë zgjidhje në institucione. Kështu, shoqëria nuk mbrohet më nga shteti: ajo është e ekspozuar ndaj grabitqarisë së forcave që nuk i kontrollon (Liquid Times: Living in an Age of Uncertainty, 2006).

Gjithsesi, një këndvështrim i tillë nuk duhet të përjashtojë përfshirjen e shtetit si një aktor që synon dobësimin e aftësisë së shtetasve për të marrë pjesë në veprimtarinë politike të tij. Faktet

historike tregojnë se krimet më të rënda në botën moderne, në çfarëdo lloji përkufizimi të arsyeshem, janë aktet e sponsorizuara, të nxitura apo të mbështetura në një shtrirje/masë të gjerë, nga qeveritë dhe zyrtarët e tyre, si p.sh. gjenocidi, tortura dhe korrupsioni (ISCI). Pavarësisht kësaj, për pjesën më të madhe të historisë, një kriminologji e krimeve të shtetit ka qenë tërësisht një dukuri e padukshme (Watts, 2008, f. 4). Një numër i vogël studimesh sugjeron se shumë “njerëz të zakonshëm” ose nuk e shohin dhunën shtetërore si një dhunë kriminale, ose janë të përgatitur që ta përkufizojnë atë si të ligjshme. Shumë studiues shfaqen mëse të gatshëm për të pasuar ndjenjat popullore në lidhje me këtë (Watts, 2008, f. 212).

Green dhe Ward kontribuan në një vlerësim gjithëpërfshirës të formave që mund të marrë krimi shtetëror. Autorët detajuan se krimet shtetërore



mund të ndodhin nëpërmjet korporatave, dhunës policore, korrupsionit, përfshirjes së qeverisë në krimin e organizuar, terrorizmin e sponsorizuar nga shteti, torturat, krimet dhe gjenocidin. Është e rëndësishme që të theksohet se motivimet politike dhe ekonomike udhëheqin krimet shtetërore në shkallë të ndryshme (Winter, 2013, f. 16).

Ndërkohë, sipas Watts-it, krimet shtetërore përfshijnë ato raste kur shtetet kanë qenë, qëllimshëm, të përfshira në politika dhe dhunë kriminale (vrasëse), terror sistematik, ndarje (shpërbërje) të qëllimshme të familjeve (duke përfshirë rrëmbimin e fëmijëve), arrestim sistematik, kërcënim (presion) dhe mbikëqyrje të qytetarëve të vet. Mjaft prej kësaj veprimtarie ka qenë rrjedhim i proceseve politike formale (Watts, 2008, f. 214).

Për pasojë, një pjesë e madhe e kësaj ve-

primtarie është e padukshme, për faktin se nuk është emërtuar asnjëherë si “krim”. Kjo është një pasojë e problemeve politike dhe konceptuale që shoqërojnë çdo përpjekje për të folur rreth krimeve shtetërore (Watts, 2008, f. 209). Në këtë mënyrë Watts na jep një kuptim të rëndësishëm mbi krimet shtetërore. Çdo politikë synon të fitojë leg-

“ Kushtet e pasigurisë, vetmisë dhe frikës për të ardhmen, që karakterizojnë qytetarin global, nuk gjejnë zgjidhje në institucione. Kështu, shoqëria nuk mbrohet më nga shteti: ajo është e ekspozuar ndaj grabitqarisë së forcave që nuk i kontrollojnë.

“ Pika kyçe rreth krimeve shtetërore në demokracitë liberale është se ai nuk është devijues apo jonormal dhe nuk ka kufij të qartë, por e zbeh padukshmërinë në rutinën e veprimeve “ligjore” të shtetit. **Krimet rutinë të shtetit janë të shfajësuar nga mbrojtjet standarde të krimit, të tilla si “përdorimi i arsyeshem i forcës në parandalimin e krimit”, të cilat mund të mos pranohen si të vlefshme (ose jo) nga sistemi ligjor apo opinionimi shoqëror.**

jitimitet përpara se sa të vihet në zbatim. Koncepti i legjitimitetit siguron lidhjen ndërmjet shtetit dhe të drejtave të njeriut. Sikurse edhe Habermas (1976) argumenton, të drejtat e njeriut dhe sovraniteti popullor, ose varietete në këtyre temave, kanë qenë qendrore në legjitimitetin e shteteve moderne shekullore. Në çdo situatë, pohimi i ligjshmërisë së shtetit ka nevojë për një shkallë të caktuar pëlqimi (Green dhe Ward, 2000, f. 108).

Kështu, pika kyçe rreth krimeve shtetërore në demokracitë liberale është se ai nuk është devijues apo jonormal dhe nuk ka kufij të qartë, por e zbeh padukshmërinë në rutinën e veprimeve “ligjore” të shtetit. Krimet rutinë të shtetit janë të shfajësuar nga mbrojtjet standarde të krimit, të tilla si “përdorimi i arsyeshem i forcës në parandalimin e krimit”, të cilat mund të mos pranohen si të vlefshme (ose jo) nga sistemi ligjor apo opinionimi shoqëror (Green dhe Ward, 2000, f. 104).

Ndërkohë, Green dhe Ward e përkufizojnë krimin shtetëror si një mbivendosje midis dy dukurive të dallueshme: (1) shkëlqen e të drejtave të njeriut; dhe (2) organizimin shtetëror të devijancës që do të jetë subjekt i një censure të gjerë në rast se bëhet e njohur (Kramer dhe Michalowski, 2005, f. 446-448).

Për më tepër, ne duhet të bëjmë dalimin ndërmjet devijancës së organizuar shtetërore dhe jolegjitimitetit (Becker, 1963, on “rule-breaking behaviour and de-

viance”). Një praktikë shtetërore është joligjore nëse ajo nisat nga vetë rregullat e shtetit ose është e pajustificueshme në termat e vlerave që synon të zbatojë. Në dallim, një veprim është devijant nëse disa grupe shoqërore i perceptojnë si shkelje të rregullave të praktikueshme ose i vlerëson dhe reagon në përputhje me, ose nëse ai aktor beson ose frikësohet se disa grupe shoqërore do të reagojnë në një mënyrë të tillë nëse ata informohen rreth aktit (Green dhe Ward, 2000, f. 109). Përfshirja e shtetit në devijancën e organizuar apo në aktivitete joligjore kërkon edhe bashkëpunimin me aktorë të tjerë, vendas dhe të huaj. Këta aktorë mund të përfshijnë korporatat, grupet kriminale apo shtete të tjera. Ky bashkëpunim ka pësuar një rritje domethënëse me globalizimin e shoqërisë. Në këtë mënyrë, aktorët e ndryshëm synojnë që të fitojnë sa më shumë terren në fushën e monopolit shtetëror të dhunës fizike dhe simbolike. Bourdieu zgjeroi konceptin e mirënjohur të Weber, i cili mendonte se shteti zotëron monopolin legjitim të dhunës fizike. Sipas Bourdieu, shteti zotëron monopolin e dhunës simbolike dhe asaj fizike, ku e para është një parakusht për ekzistencë/ushtrimin e të dytës. Gjithashtu, Bourdieu vuri në pikëpyetje ekzistencën e shtetit duke theksuar se është e vështirë që të arrihet në një përkufizim të qartë se çfarë është shteti. Sipas tij, shumë sociologë, në përpjekjet e tyre për të përkufizuar shtetin, bëjnë gabimin se fokusohen në funksionet e shtetit, por jo në atë se çfarë është shte-

ti, mekanizmi që e vë atë në lëvizje. Për Bourdieu, shteti është një fushë ku aktorë të ndryshëm përpiqen që të fitojnë sa më shumë terren.

Për Bauman, ndarja e politikës dhe pushtetit, e sjellë nga globalizimi, është një ndër problemet kyçe. Ne nuk mund të bëjmë më revolucione, pasi nuk ka më simbole të pushtetit për t'u rrëzuar. Fuqia është zvogëluar dhe ka rrëshqitur nga niveli i mëparshëm, duke u larguar nga përgjegjësia e kontrollit prej qytetarëve. Ky është edhe thelbi i krizës së demokracisë: referimi i detyrimit shtrihet në debatin midis demokracisë dhe përfaqësimit. Ne votojmë për qeveritë dhe politikanët që nuk kanë më pushtet për të vepruar, apo për të marrë vendimet e duhura, pasi pushteti është diku tjetër, mbi ligjet e shteteve të veçanta. Në një botë të udhëhequr nga globalizimi negativ, të gjitha problemet e nënvizuara... janë globale dhe të qenit globale nuk pranon zgjidhje lokale (Liquid Times, 2006).

Problemi me demokracinë e sotme është rënia e besimit: besimi se liderët tanë nuk janë thjesht të korruptuar dhe budallenj, por edhe të paaftë. Veprimi kërkon fuqi / pushtet, për të qenë të aftë për të arritur qëllimet dhe ne kemi nevojë për politikë, që është aftësia për të vendosur se çfarë është e nevojshme të bëhet. Por martesë ndërmjet pushtetit dhe politikës në duart e shteteve kombe ka marrë fund. Fuqia / pushteti është globalizuar, por politika është po aq lokale sa edhe më parë. Politika i ka duart e prera. Njerëzit nuk besojnë më në sistemin demokratik sepse ai nuk i mban premtimet. Institucionet tona demokratike nuk janë projektuar për t'u përballur me situatat e ndërvertësisë. Kriza aktuale e demokracisë është një krizë e institucioneve demokratike. Problemi është se lëvizjeve nuk u mungon lideri që mbijeton, por saktësisht sepse atyre u mungon lideri që nuk i kthen qëllimet e tyre në veprim. Zëvendësimi i një

partie me një tjetër nuk do ta zgjidhë problemin. Problemi nuk ka të bëjë me faktin se partitë janë gabim, por sepse ato nuk i kontrollojnë dot situatat.

Ne jemi dëshmitarë të zhdukjes së diçkaje që siguronte se individët mund të zgjidhnin problemet e ndryshme të kohës sonë me një mënyrë të njëtrajtshme. Kjo krizë çoi në rënien e ideologjive dhe për pasojë të partive politike dhe thirrjes së përgjithshme për vlerat e përbashkëta që u lejonte individëve të ndiheshin pjesë e diçkaje që kuptonte nevojat e tyre.

Partitë politike janë bërë si taksitë e mara nga votëkontrolluesit liderë të bandave apo bosë të Mafias. Politikanët mund të ndërrojnë aleancat partiake pa krijuar ndonjë skandal. Nuk janë vetëm njerëzit: shoqëria, në vetvete, është duke jetuar në

SHTETI

Aktorët e ndryshëm synojnë që të fitojnë sa më shumë terren në fushën e monopolit shtetëror të dhunës fizike dhe simbolike. Bourdieu zgjeroi konceptin e mirënjohur të Weber, i cili mendonte se shteti zotëron monopolin legjitim të dhunës fizike. Sipas Bourdieut, shteti zotëron monopolin e dhunës simbolike dhe asaj fizike, ku e para është një parakusht për ekzistencë/ushtrimin e të dytës. Gjithashtu, Bourdieu vuri në pikëpyetje ekzistencën e shtetit duke theksuar se është e vështirë që të arrihet në një përkufizim të qartë se çfarë është shteti. Sipas tij, shumë sociologë, në përpjekjet e tyre për të përkufizuar shtetin, bëjnë gabimin se fokusohen në funksionet e shtetit, por jo në atë se çfarë është shteti, mekanizmi që e vë atë në lëvizje.



Duke iu referuar lëvizjes masive të refugjatëve nga zonat e luftës drejt vendeve të zhvilluara, Bauman thekson se ata (refugjatët) mbartin frikërat tona të të humburit të gjithçkaje. Dje

ata ishin shumë të fuqishëm në vendin e tyre, sikurse jemi ne sot në Evropë.

Refugjatët largohen nga lufta në kërkim të ndërtimit të një jete të re në Evropë.



kushte pasigurie (Eco, 2017, f. 2).

ANKTHI LIKUID

Duke iu referuar lëvizjes masive të refugjatëve nga zonat e luftës drejt vendeve të zhvilluara, Bauman thekson se ata (refugjatët) mbartin frikërat tona të të humburit të gjithçkaje. Dje ata ishin shumë të fuqishëm në vendin e tyre, sikurse jemi ne sot në Evropë. Refugjatët largohen nga lufta në kërkim të ndërtimit të një jete të re në Evropë. Ai thekson se ka një shpjegim psikologjik për atë që duket një reagim nervoz i Evropës ndaj refugjatëve të ardhur në BE. Këta refugjatë që po vijnë tash-tani janë refugjatë jo prej urisë, pa bukë dhe ujë. Ata janë njerëz që dje ishin krenarë për shtëpinë e tyre, ishin krenarë për pozitën e tyre në shoqëri, shpesh të mirë

arsimuar, e kështu me radhë. Por tashmë ata janë refugjatë (Al Jazeera).

Nga ana tjetër, edhe koncepti i komunitetit ka humbur aftësinë për të ofruar siguri për anëtarët e vet. Komuniteti i referohet, kryesisht, një vendi/ambienti familjar, mikpritës dhe të sigurt në të cilin ne mund të gjejmë prehje, ku njerëzit na njohin dhe bëjnë që të ndihemi si në shtëpi. Në komunitet nuk jemi të frikësuar, nuk ndihemi të vetmuar, por, nga ana tjetër, ai mund të na çojë drejt një gjendjeje tendosje (ngridje), që na shtyn të largohemi nga kontrolli shtypës, për të shkëputur lidhjet e forta, të cilat, edhe pse të frymëzuara nga dashuria dhe dëshira për mbrojtje, pengojnë zhvillimin.

Kriza në konceptin e komunitetit nxit zhvillimin e indivi-

dualizimit të shfrenuar: njerëzit nuk janë më bashkëqytetarë, por rivalë ndaj të cilëve duhet të kesh kujdes. Ky “subjektivizëm” ka kërcënuar themelet e modernitetit, e ka bërë atë të brishtë, duke prodhuar një rrethanë pa pika reference, ku gjithçka shpërbëhet në një lloj lëngshmërie. Siguria e ligjit ka humbur, gjyqësori shihet si armik dhe e vetmja zgjidhje për individët të cilët nuk kanë pika reference është që ta bëjnë veten e tyre dyshues me çdo kusht, ta trajtojnë dyshimin si një vlerë dhe të ndjekin konsumerizmin. Gjithsesi, ky nuk është një konsumerizëm që synon zotërimin e objekteve të dëshirueshme që prodhojnë kënaqësi, por një që, në mënyrë të menjëhershme, i bën këto objekte të vjetruara / të papërdorshme (Eco, 2017, f. 2).

AKTIVIZMI NË KOLLTUK

Në vitin 1996, Pierre Barlow themeluesi i Electronic Frontier Foundation deklaroi se: “ne jemi duke krijuar një botë ku çdokush, kudo, mund të shprehë bindjet / besimet e veta, pavarësisht se sa i vetmuar mund të jetë, pa frikën se do të detyrohet të heshtë apo të bjerë në konformizëm.” Ai deklaroi me krenari se teknologjia e rrjetëzuar do ta bashkonte botën në një hapësirë të vetme “të lirë”. Fjalët e tij flasin për parime optimiste dhe aspiruese që e imagjinojnë internetin si të pavarur nga kontrolli, vëzhgimi (surveljanca) dhe manipulimi. Kjo reflekton një ideologji



Koncepti i komunitetit ka humbur aftësinë për të ofruar siguri për anëtarët e vet. Komuniteti i referohet, kryesisht, një vendi/ambienti familjar, mikpritës dhe të sigurt në të cilin ne mund të gjejmë prehje, ku njerëzit na njohin dhe bëjnë që të ndihemi si në shtëpi.

që vendos si parësore lirinë individuale përpara praktikave shtetërore apo të shoqërisë (Srinivasan & Fish, 2017, f. 1).

Në librin e tyre “After the Internet” (Pas internetit) autorët Srinivashan dhe Fish ngrenë shqetësimin mbi mënyrën se si vizionet politike, ekonomike dhe ideologjike të internetit janë të kontrolluara nga gjigandët e korporatave Perëndimore të tilla si Google, Facebook dhe Microsoft. Këto kompani jo vetëm që në mënyrë rritëse dominojnë software-t, hardware-t dhe praktikatat tona online, por ato, gjithashtu, kontrollojnë edhe “back end”, nëpërmjet të cilave përdorimi i të dhënave nga përdoruesit ruhet ose komunikohet.

Ditët e sotme studiuesit janë të ndarë në dy grupe kryesore në lidhje me efektet e zhvillimit të internetit. Në grupin e parë bëjnë pjesë studiuesit të cilët theksojnë rritjen e aftësisë së shtetit për të kontrolluar më në thellësi jetën e njerëzve, duke shkelur në këtë mënyrë privatësinë e tyre. Një gjë e tillë ka bërë që shumë shtete, në emër të luftës kundër

terrorizmit, të hartojnë ligje të cilat u lejojnë dhe mundësojnë atyre që të shkelin në hapësirën digjitale të njerëzve. Woody Evans (2016), duke sfiduar pohimin e Barlow, thekson prezencën e institucioneve shtetërore të internetit, të tilla si International Corporation for Assigned Names and Numbers (ICANN) dhe Worldwide Web Consortium (W3C). Në këtë mënyrë Evans refuzon thelbin e cyberspace të mbështetur nga Barlow (Srinivasan & Fish, 2017, f. 1).

Një ndër shqetësimet më të mëdha të shoqëruara me përdorimin e internetit në ditët e sotme është ai lidhur ngushtë me mbikëqyrjen. Kjo ka rritur frikërat se ne kemi hyrë në një botë “post-privacy” pa miratimin tonë. Zbulimet e shoqëruara me projektin PRISM të National Security Agency (NSA), të bëra publike nga bilbifryrësi Edward Snowden e rritën edhe më shumë këtë shqetësim (Srinivasan & Fish, 2017, f. 5).

Grupi i dytë beson se pohimi i Barlow

qëndron dhe ka dhënë efekte konkrete. Jessica Beyer dhe McKelvey (2015) ofrojnë një sërë shembujsh të cilat tregojnë se cyberspace ofron përparësi të veçanta për të rezistuar dhe luftuar legjislacionin dhe ndërhyrjet e qeverisë. Kështu, Napster, BitTorrent dhe MojoNation paraqiten nga autorët si simbole të organizimit johierarkik dhe rezistencës ndaj pushtetit shtetëror. Në këtë mënyrë, edhe pse institucionet qeverisëse përpiqen të kontrollojnë internetin, aktivistët, hakerat dhe publiku mund ta dobësojnë një gjë tillë nëpërmjet praktikave të tyre shkatërruese (Srinivasan & Fish, 2017, f. 3).

Sot, përdorimi masiv i internetit dhe teknologjisë ka ndryshuar dukshëm konceptin e identitetit. Gjithnjë e më tepër njerëzit kanë prirjen që të lidhen on-line nëpërmjet rrjeteve të ndryshme shoqërore. Megjithatë, dallimi midis një komuniteti dhe një rrjeti është se në komunitet ne i përkasim atij, ndërkohë një rrjet na përket ne. Ne kemi kontroll. Ne mund të shtojmë miq nëse dëshirojmë, ose mund t'i fshijmë ata. Ne kemi kontroll mbi njerëzit të cilët janë lidhur me ne. Për pasojë, njerëzit ndihen më mirë, sepse vetmia, braktisja është frika më e madhe në kohën tonë të individualizmit. Por, edhe pse është shumë e lehtë që të shtosh apo heqësh shokët në internet, në realitetin social ne na duhen aftësitë shoqërore për të ndërvepruar në mënyrë të shëndetshme me të tjerët. Në këtë pikë, Bauman ngre shqetësimin se mediat sociale nuk na mësojnë dialogun, pasi në komunikimin virtual është shumë e lehtë që të shmangësh kundërshtitë. Shumë njerëz e përdorin medien sociale jo për t'u bashkuar, as për të hapur horizontet e tyre, por, përkundrazi, për ta vendosur veten në një zonë rehatie, ku të vetmit zëra që ata mund të dëgjojnë janë jehonat e zërit të tyre, ku e vetmja fytyrë që ata



shohin është pasqyrimi i fytyrës së tyre. Mediat sociale janë shumë të vlefshme, ato sigurojnë kënaqësi, por ato janë një kurth (Elpais). Në këtë kontekst Bauman e sheh si të pashpresë ndryshimin politik në shoqërinë bashkëkohore.

Fetishizimi i teknologjisë sjell rrezikun e injorimit të shumë studimeve të cilat shpjegojnë arsyet se përse njerëzit protestojnë. Ajo dështon të shqyrtojë rëndësinë e klimës ekzistuese politike dhe mediatike (McAdam, 1982), si edhe rolin e kapaciteteve simbolike, materiale, organizacionale, politike dhe kulturore në formësimin e protestave (Meyer & Minkoff, 20004) si edhe pushtetin e emocioneve, agjencive dhe aktivizimit politik në formësimin e revolucioneve (Goodwin & Jasper, 1999). Këta faktorë mund të fshihen nga të kuptuarit dhe të vlerësuarit e lëvizjeve politike nëse ne mendojmë rreth internetit në izolim naiv (Srinivasan & Fish, 2017, f. 76).

Sipas Srinivasan dhe Fish (2017) pikëpamja “internet-centric” e një revolucioni në veprim, që e sheh teknologjinë si shkaktarin e ngjarjeve shoqërore dhe politike. Pavarësisht bindjes së përhapur gjerësisht që e sheh Pranverën Arabe si produkt të internetit dhe teknologjisë, ata e shohin atë si të shkëputur prej tij (internetit). Ata ngrenë pyetjen se si ky shpjegim është i mundur duke patur parasysh se teknologjitë e mediave sociale ishin të aksesueshme vetëm nga 5 për qind e shtëpive në Egjipt në fillim të vitit 2011? A nuk duket absurde të pranosh se mjete të tilla shkaktuan revolucion në një vend të populluar nga 85 milionë njerëz (Srinivasan & Fish, 2017, f. 75).

A KA NDOJË MËNYRË PËR T’U PËRBALLUR ME TERMIN E LËNGSHMËRINË?

Ka, dhe kjo përfshin ndërgjegjësimin

se ne jetojmë në një shoqëri të lëngshme që, për t’u kuptuar dhe tejkaluar, kërkon instrumente të reja. Por problemi është se përfaqësuesit politikë dhe një pjesë e madhe e klasës intelektuale nuk e kanë kuptuar ende ndërlikimin (përfshirjen) e kësaj dukurie (Eco, 2017, f. 3).

Për Bauman, roli i shkencëtarit, mendimtarit, filozofit apo kritikut social është, saktësisht, të qenit zbulues i realitetit, edhe të asaj pjese që ende nuk është e dukshme apo që është fshehur qëllimshëm.

Shpresa e vetme shtrihet te ndërgjegjia individuale, në respektin për veten dhe të tjerët. Të barabartë dhe të ndryshëm, në një shoqëri të ndërlikuar, që nuk konsiston më në masat e standardizuara, as në individë të izoluar, por e përbërë nga një komunitet njerëzish që janë në gjendje të flasin dhe të zhvillohen me njëri-tjetrin. Ne duhet ta humanizojmë aktivizimin dhe kreativitetin në vend që, në mënyrë naive, të hyjnizojmë teknologjinë (Srinivasan & Fish, 2017, f. 77). Shpërndarja e statuseve në Facebook apo media të tjera sociale, si edhe nënshkrimi i peticioneve online nuk e bëjnë domosdoshmërisht më efektiv angazhimin qytetar në kauza të caktuara. Diçka zhvillohet nëpërmjet veprimit, praktikës dhe lëvizjes. Është përdorimi kreativ i teknologjisë ai që sjell suksesin dhe jo teknologjia në vetvete. ■

BIBLIOGRAFIA

- Bauman, Z. (2006). *Liquid Times: Living in an Age of Uncertainty*. Polity Press
https://elpais.com/elpais/2016/01/19/inenglish/1453208692_424660.html
 Srinivashan, R. & Fish, A. (2017). *After the internet*. UK. Polity.
<http://www.unesco.org/new/en/social-and-human-sciences/themes/urban-development/migrants-inclusion-in-cities/good-practices/inclusion-through-access-to-public-space/>



NË KURTHIN
VRASTAR
TË FRANKENSHTAJNIT

Kjo ideologji e kontrollit të realitetit dhe e mundësisë që njerëzit, me anë të teknologjisë, do të kenë mundësi të zgjidhin çdo problem - jo vetëm varfërinë apo sëmundjet, jo vetëm shmangien e stresit dhe të depresionit, por edhe shmangien fare të vdekjes - është ajo që ka shkaktuar që tani probleme të cilat vazhdimisht thellohen. **Aldous Huxley, një mendimtar i rëndësishëm kritik për zhvillimet e teknologjisë, thotë se progresi teknologjik do të na japë më shumë mjete që të shkojmë pas.**



FITIM ZEKTHI

TEKNOLOGJIA ËSHTË PARË GJITHNJË SI NJË MJET që ndihmon njeriun të rrisë fuqinë e tij, të rrisë kapacitetin e tij për të prodhuar, për të vepruar, për të kontrolluar etj. Kështu, si pasojë e teknologjisë, njeriu vazhdimisht ka rritur fuqinë e tij për të prodhuar më shumë mallra, që nga ushqimet e deri te veshmbathjet apo pajisjet e ndryshme. Si pasojë e teknologjisë, njeriu ka rritur fuqinë e tij për të lëvizur, për të ndërtuar ura, godina, për të parë larg. Si pasojë e teknologjisë, njeriu ka rritur fuqinë e tij për të kontrolluar më shumë territor, më shumë njerëz të tjerë, më shumë struktura. Teknologjia është parë kështu si një mënyrë për të përmirësuar jetën e njerëzve dhe shoqërinë.

Ideologjia që mbështet këtë qëndrim mbi teknologjinë beson se teknologjia mund të kontrollojë realitetin, mund të zgjidhë problemet me anë të përdorimit të mjeteve apo metodave shkencore-teknologjike. Sipas kësaj ideologjie, në qoftë se mund të flasim për një ideologji të te-

knologjisë, qeniet njerëzore do të mundën një ditë të zgjidhin çdo problem, madje do të mundën të kontrollojnë të ardhmen duke përdorur teknologjinë. Autorë të ndryshëm shprehen se këto ide do të bëjnë të mundur heqjen dorë nga feja dhe zgjedhjen e një autoriteti tjetër moral “më të lartë”.

Problemi i vërtetë me teknologjinë është pikërisht kjo ideologji. Kjo ideologji e kontrollit të realitetit dhe e mundësisë që njerëzit, me anë të teknologjisë, do të kenë mundësi të zgjidhin çdo problem - jo vetëm varfërinë apo sëmundjet, jo vetëm shmangien e stresit dhe të depresionit, por edhe shmangien fare të vdekjes - është ajo që ka shkaktuar që tani probleme të cilat vazhdimisht thellohen. Aldous Huxley, një mendimtar i rëndësishëm kritik për zhvillimet e teknologjisë, thotë se progresi teknologjik do të na japë më shumë mjete që të shkojmë pas.

Për nga natyra e saj, teknologjia është e pavarur, ajo funksionon si një sistem më vete.

SISTEMI

“Operacionet e brendshme” të teknologjisë janë të pavarura. Ne mund të heqim ose të shtojmë element në një teknologji, por, pasi e kemi bërë këtë, operacionet e brendshme të saj nuk ndikohen nga veprimi ynë. Sa më i fuqishëm të jetë sistemi, sa më të përcaktuara dhe më të ndërlikuara t’i këtë ai operacionet e brendshme, aq më i vështirë bëhet ai për t’u mbajtur në kontroll.

Kjo nuk do të thotë se ajo ndikohet nga veprimi i jashtëm, nuk do të thotë se teknologjia nuk ndërvepron me sisteme të tjera, si njeriu, truri i njeriut, shteti, shoqëria etj. Niklas Luhman një sociolog mjaft i njohur thotë se është në natyrën e një sistemi që ai të jetë i pavarur. Për shembull, njeriu prek me dorë flakën e një qiri dhe ndjen nxehtësi në gisht. Qiri është një sistem me vete, i pavarur. Mënyra e funksionimit të tij, operacionet e tij të brendshme nuk ndryshohen nga jashtë, nuk ndryshohen nga dora jonë. E njëjta gjë edhe me njeriun apo trurin njerëzor. Kur ne prekim me dorë flakën e qiriut, ne prekim me dorë një masë ajri. Ajo na krijon ne idenë e nxehtësisë apo të djegies, pasi ajo ngacmon gishtin tonë. Nervi në gisht dërgon sinjale të në tru të cilat krijojnë për ne idenë e nxehtësisë. Flaka, në këtë mënyrë, ndonëse ndërvepron me gishtin, nuk prek operacionet e brendshme të trurit apo të nje-

riut. E njëjta gjë edhe për flakën e qiriut. Operacioni i brendshëm nuk ndryshon pavarësisht se ne e prekim me dorë flakën. Ndërveprimi mund të shpejtojë, mund të ngadalësojë një funksion, mund të bëjë që sistemi tjetër të punojë më ngadalë ose më keq, por nuk mund të prekë operacionet e brendshme.

E njëjta edhe me teknologjinë. “Operacionet e brendshme” të teknologjisë janë të pavarura. Ne mund të heqim ose të shtojmë element në një teknologji, por, pasi e kemi bërë këtë, operacionet e brendshme të saj nuk ndikohen nga veprimi ynë. Sa më i fuqishëm të jetë sistemi, sa më të përcaktuara dhe më të ndërlikuara t’i këtë ai operacionet e brendshme, aq më i vështirë bëhet ai për t’u mbajtur në kontroll.

Në fillim të shekullit të 19-të shkrimtarja Mary Shelley shkroi një roman të famshëm të quajtur “Frankenshtajni” (Frankenstein) ose Prometeu Modern. Romani flet për një personazh të quajtur Viktori Frankenshtajni, i cili krijon në laborator me anë të përdorimit të kimisë dhe të alkimisë një krijesë që ngjan si përbindësh, të shëmtuar dhe të frikshëm që ka ndjeshmëri. Përbindëshi nuk mund të përshatet në shoqëri, atë të gjithë e urrejnë, ai ikën nga sytë këmbët. Në një fshat të thellë ai gjen një lloj qetësie. Familjarizohet me jetën atje dhe nis të flasë. Miqësohet me një burrë të verbër dhe kujdeset për të. Kur vijnë familjarët e të verbrit, tmerro-



hen. Përbindëshi është i zemëruar pafundësisht me gjendjen e vet. Vendos të hakmerret me atë që e krijoi, pasi e mëson. Vret vëllanë e krijuesit të tij. Më pas i kërkon krijuesit të bëjë një tjetër përbindësh si ai, por femër. Frankenshtajni pranon të krijojë një femër, por pastaj e shkatërron eksperimentin sepse ka frikë se kështu do të krijohet një racë përbindëshash. Përbindëshi vret shokun e ngushtë të Frankenshtajnit. Natën e martesës ai vret edhe nusen e Frankenshtajnit. Babai i Frankenshtajnit vdes nga dëshpërimi. Tashmë Frankenshtajni i dedikon jetën shkatërrimit të përbindëshit. E ndjek atë në oqeanin Arktik. Atje bie në akull. Një anije e gjen Frankenshtajknin të vdekur. Pak më vonë përbindëshi hipën në anije, por kur sheh Frankenshtajnin të vdekur, atëherë vendos të vetëshkatërrohet dhe ikën.

Pra, krijesa, përbindëshi, që u bë në laborator, ekzistonte si një sistem i pavarur. Operacionet e brendshme, që bëjnë të mundur funksionimin e tij, ishin krejtësisht të pavarura dhe nuk ndikoheshin nga ndërveprimi

“

Një nga fushat më të dukshme, por edhe më domethënëse në të cilën teknologjia mbretëron plotësisht, është ajo e komunikimit. **Si pasojë e teknologjisë, si një mjet me të cilin arrihet komunikimi, njerëzit janë thujtë të gjithë frankenshtajnjë fatkeqë.** Sigurisht Frankenshtajni nuk u krijua nga njerëzit e thjeshtë, pra teknologjia e komunikimit nuk është krijuar nga njerëzit që janë sot viktima të saj.



me jashtë. Për më tepër, Frankenshtajni kishte fuqi shkatërruese mbi vetë krijuesin e tij dhe mbi njeriun. Frankenshatjini ka hyrë në gjuhën e zakonshme si metafora e instrumentit, e mjetit, e krijesës që del kundër dhe, madje, shkatërron vetë atë që e ka bërë.

Matt Richtel, një studiues amerikan, thotë se sot shoqëria vuan nga obsesioni për teknologjinë. Ai thotë se në Silicon Valley, zona në të cilën gjenden industritë më të mëdha të teknologjisë së informacionit, si Google, Microsoft, Apple, Face-

book etj., tufa e bagëtive po ecën me shpejtësi shumë të madhe vetëm në një drejtim dhe po ngre re të dendura pluhuri. Kjo gjë po bën të mundur krijimin e një teknologjie aq të fuqishme sa mund të thuhet se për trurin apo atë që është njeriu, është thuajse mbinatyrore. Richtel thotë se ky inovacion teknologjik po ecën me shpejtësinë e dritës, në një kohë që aftësitë e njeriut apo kapaciteti i njeriut ecën me shpejtësinë e kërmillit. Pra, jemi në këtë përballje të frikshme. Teknologjia ecën me shpejtësinë e dritës dhe ne njerëzit me shpe-

jtësinë e kërmillit. Praktakisht ne kemi krijuar një përbindësh si ai i Frankenshtajnit.

Në fakt, teknologjia ka nisur të ketë një rol shumë të madh dhe të kthehet gradualisht në një përbindësh si ai i Frankenshtajnit qysh me nisjen e revolucionit industrial. Është pikërisht kjo koha e saktë kur shpejtësia me të cilën nisi të ecë teknologjia u rrit në krahasim me atë me të cilën ecën njeriu apo shoqëria. Teknologjia, veç faktit që mund të kthehet në një përbindësh, rrit mjaft edhe pritshëmritë për jetën, ka prirjen t'i bëjë jetët të papërmbushme, t'i kthejë njerëzit në subjekte të sajat dhe të çojë deri në destabilizim të shoqërisë. Dhe, në fakt, numri i njerëzve që janë të paqetë, që kanë pritshmëri të larta, që vazhdimisht dëshirojnë gjëra që ua "imponon" teknologjia, ka ardhur pa ndalim duke u rritur.

Një nga fushat më të dukshme, por edhe më domethënëse në të cilën teknologjia mbretëron plotësisht, është ajo e komunikimit. Si pasojë e teknologjisë, si një mjet me të cilin arrihet komunikimi, njerëzit janë thaujse të gjithë frankenshtajnë fatkeqë. Sigurisht Frankenshtajni nuk u krijua nga njerëzit e thjeshtë, pra teknologjia e komunikimit nuk është krijuar nga njerëzit që janë sot viktima të saj.

Filozofi francez Rene Girard thotë se njerëzit lindin të gjithë pa dëshira. Çdo dëshirë që kanë njerëzit gjatë jetës e kanë fituar atë me anë të imitacionit. Edhe Arsitoteli ka folur për

mimetizmin, i cili shërben për të krijuar dëshira te njerëzit. Njerëzit, si pasojë e mimetizmit, i fitojnë dëshirat nëpërmjet dy llojeve të ndërmjetësimit, atij të jashtëm dhe atij të brendshëm. "Shembulli më elokuent, ndosh-ta, - thotë Girard, - i ndërmjetësimit të brendshëm është Don Kishoti. Ai lexonte libra mbi heroizmin e kalorësve dhe luftërat e tyre legjendare dhe i lindi dëshira të bëhet edhe vetë një luftëtar i tillë. Don Kishoti, dihet, u nis të luftojë si kalorës. Shembulli më elokuent i ndërmjetësimit të jashtëm gjendet po te Don Kishoti. Ai i thotë Sanço Pançës se në qoftë se ai i bashkohet atij në "luftë", atëherë ai do t'i japë atij një vend për ta qeverisur dhe do ta bëjë guvernator. Pra, Don Kishoti e fitoi dëshirën nga romani që lexoi, ndërsa Sanço Pança nga ajo që i

PËRBINDËSHI

Në fakt, teknologjia ka nisur të ketë një rol shumë të madh dhe të kthehet gradualisht në një përbindësh si ai i Frankenshtajnit qysh me nisjen e revolucionit industrial. Është pikërisht kjo koha e saktë kur shpejtësia me të cilën nisi të ecë teknologjia u rrit në krahasim me atë me të cilën ecën njeriu apo shoqëria. Teknologjia, veç faktit që mund të kthehet në një përbindësh, rrit mjaft edhe pritshëmritë për jetën, ka prirjen t'i bëjë jetët të papërmbushme, t'i kthejë njerëzit në subjekte të sajat dhe të çojë deri në destabilizim të shoqërisë. Dhe, në fakt, numri i njerëzve që janë të paqetë, që kanë pritshmëri të larta, që vazhdimisht dëshirojnë gjëra që ua "imponon" teknologjia, ka ardhur pa ndalim duke u rritur.

tha Don Kishoti. Vetëm nëpërmjet këtyre dy formave të ndërmjetësimit njerëzit fitojnë dëshira.”

Ai që i rriti në mënyrë të ndjeshme dhe që tronditi mënyrën tradicionale të fitimit të dëshirave te njerëzit ishte televizioni. Televizioni (nëpërmjet aparatit të televizorit) shërben si një ndërmjetës i përsosur. Nëpërmjet televizionit njerëzit nisën të kenë dëshira për fustanin që panë te një aktore, për shtëpinë që panë në një fshat, për makinën që panë në një telenovelë, për plazhin, për lugët, për gotat, për perdet etj. Televizioni, nëpërmjet ndërmjetësimit të fuqishëm që bëri dhe që bën ende, u krijoi edhe u krijon dëshira të vazhdueshme duke i homogjenizuar ata, duke i bërë ata të duan thuajse të njëjtat gjëra, t'i duan në të njëjtën mënyrë dhe ç'është më e keqja të duan gjëra që nuk u nevojiten. Filzofi Herbert Marcuse thotë se njerëzit në epokën e sotme kthehen në qenie që kanë nevoja artificiale. Njerëzit sot përjetojnë si nevoja ato që janë vetëm dëshira dhe këtë gjë e bën komunikimi nëpërmjet teknologjisë. Në këtë rast duhet thënë se teknologjia është shumë e fuqishme, asaj nuk i reziston dot askush. Kur doli televizioni, edhe shtëpitë filluan të arredohen në funksion të aparatit të televizorit. Kolltukët, divanët, tryeza etj. vendoseshin përreth televizorit. Njerëzit që dikur rrinin në darkë bashkë, bisedonin apo luanin, tani shohin televizor. Televizori është, në fakt, jo vetëm mjeti i argëtimit, por edhe ndërmjetësi i madh, pra skllavëruesi i madh, prodhuesi më i madh i dëshirave.

Nëpërmjet dëshirave që krijon televizori, ai rrit pritshmëritë për jetën, shton



shqetësimet dhe është burim i dëshpërimit apo edhe i depresionit, sepse shumë nga dëshirat e fituara nuk realizohen. Televizioni në këtë rast krijon idenë e papërbushmërisë. Vetë televizori, si teknologji, është një sistem krejt i pavarur sa u takon operacioneve të tij të brendshme. Ti mund ta fikësh atë, mund të ndryshosh stacion, por mënyrën se si funksionon, programet që ai ka, dëshirat që ai ndërmjetëson ti nuk i prek dot. Ai të prek ty. Truri njerëzor, ndonëse një sistem më vete dhe i pavarur sa u takon



“ Pas televizionit, epoka e telefonave smart i ka shumëfishuar të gjitha ato që bënte televizioni. Në qoftë se televizioni ishte një teknologji që kishte shpejtësi kozmike krahasuar me atë të njeriut, tashmë në epokën e smartfonëve teknologjia ka shpejtësi drite dhe njeriu shpejtësi kërmilli. Çdokush ka një smartfon, pra çdokush ka një kompjuter i cili është lidhur me një rrjet global ku gjenden thuajse të gjithë.

operacioneve të brendshme, ka vetinë e neuroplastikës. Në qoftë se një zonë e caktuar e trurit vihet më shumë në punë, krahasuar me zonat e tjera, atëherë rrjeti neural i kësaj zone bëhet më u fuqishëm në dëm të zonave të tjera. Për shembull, shoferët e taksive të Londrës, për shkak se u duhet të parkojnë me vështirësi, e kanë shumë të zhvilluar zonën e trurit që hulumton dhe mat hapësirat. Ka studime që thonë se rritja e kësaj zone ka dëmtuar zona të tjera. E njëjta gjë edhe me ata që përqendrohen më shumë në një fus-

MANIPULIMI

Një aspekt tjetër i tmerrshëm i komunikimit është manipulimi politik. Televizori, duke qenë mjet i përdorimit masiv, i shkon të gjithëve në shtëpi dhe i detyron njerëzit të mendojnë pak a shumë në termat me të cilët ai iu flet. Televizioni është mjeti më i dashur për regjimit politike. Regjimit e korruptuara, autoritare apo totalitare i kanë përdorur masivisht televizionet për të manipuluar njerëzit. Prania e shumë televizioneve dhe sidomos prania e smartfonëve në duart e kujtdo u ka dhënë mundësinë të gjitha qeverive të manipulojnë gjerësisht njerëzit. Sot në media ndodh implozioni i kuptimit të gjërave..

hë të caktuar. Televizioni, duke nxitur dëshira dhe duke i bërë njerëzit që të mendojnë për to, duke i detyruar t'i ndjekin ato, apo duke i bërë njerëzit shikues të një gjëje më shumë se të një tjetre, ua ndryshon atyre dhe rrjetet neurale ose konfigurimin. Ky ndryshim i konfigurimit bën që ajo që është dëshirë të kthehet në nevojë. Ajo është thjesht një nevojë artificiale, por truri, tashmë, duke qenë i kompozuar në mënyrë të tillë që e përjeton atë si nevojë, nuk ka mundësi t'i tregojë njeriut që ajo është vetëm një dëshirë. Dëshira të tilla janë: vajtja në plazh ose energjia elektrike, ose frigoriferi, ose ...

Pas televizionit, epoka e telefonave smart i ka shumëfishuar të gjitha ato që bënte televizioni. Në qoftë se televizioni ishte një teknologji që kishte shpejtësi kozmike krahasuar me atë të njeriut, tashmë në epokën e smartfonëve teknologjia ka shpejtësi drite dhe njeriu shpejtësi kërmilli. Çdokush ka një smartfon, pra çdokush ka një komp-

juter i cili është lidhur me një rrjet global ku gjenden thuajse të gjithë. Shqipëria është një vend shumë më i ekspozuar se të tjerët ndaj këtij transformimi që i bën komunikimi apo teknologjia. Duke qenë një shoqëri e dalë nga komunizmi, një shoqëri e cila për 50 vite vuajti nga uria dhe mungesa e kushteve minimale materiale, ajo është shumë më e prekshme dhe e dëmtueshme nga ky komunikim. Gjithashtu, edhe mungesa e një kulture të qëndrueshme, si pasojë e shkatërrimit të kulturës tradicionale nga komunizmi, e bën këtë rrezik shumë më të madh. Për këtë shkak, shkalla e seksualizmit në veshje në shoqërinë tonë është e frikshme. Shumica e të rinjve vishen në xhiro, në kafene, por edhe në auditorë universiteti me tuta sporti, shumë të tjerë vishen në kafene apo auditorë me veshje që janë krejtësisht erotike, në mos pornografike. Shumica e të rinjve, por edhe e të moshuarve, duan vetëm vila, pushime luksi,




makina, veshje ekstravagante etj.

Një aspekt tjetër i tmerrshëm i komunikimit është manipulimi politik. Televizori, duke qenë mjet i përdorimit masiv, i shkon të gjithëve në shtëpi dhe i detyron njerëzit të mendojnë pak a shumë në termat me të cilët ai iu flet. Televizioni është mjeti më i dashur për regjimit politike. Regjimit e korruptuara, autoritare apo totalitare i kanë përdorur masivisht televizionet për të manipuluar njerëzit. Prania e shumë televizioneve dhe sidomos prania e smartfonëve në duart e kujtdo u ka dhënë mundësinë të gjitha qeverive të manipulojnë gjërësisht njerëzit.

Sot në media ndodh implozioni i kuptimit të gjërave. Filozofi Jean Baudrillard thotë se ky implozion ndodh në tri mënyra. E para ka të bëjë me prodhimin e një informacioni në sasi të jashtëzakonshme. Për një çështje, për shembull reforma në drejtësi në Shqipëri, prodhohet informacion nga deputetët e PS-së, nga kryeministri, nga ministra, nga kryetari i bashkisë Tiranë, nga analistë apo gazetarë të qeverisë. Që të gjithë flasin vazhdimisht gjatë ditës për këtë gjë. Gjithëçka ata thonë përcillet te njerëzit nëpërmjet televizionit dhe portaleve apo internetit. Informacion mbi reformën në drejtësi prod-

“Gati tërë popullata është pandalur pre e dëshirave që u imponohen nga televizioni apo interneti dhe kjo i bën ata thjesht frankenshtatjné të dëshpëruar, të kapur rob nga zemërimi i “përbindëshit”. Ndërsa **aspekti tjetër, ai i manipulimit të mendjes së njerëzve për qëllime politike është edhe më i rrezikshëm, pasi njerëzit do të humbin çdo mundësi të ndryshonin sadopak diçka me vullnetin e tyre.**



hon edhe opozita, kryetari i saj, deputetët, ish-ministrit, gazetarë apo analistë pranë saj. Edhe ky informacion u shkon njerëzve. Për reformën në drejtësi mund të flasin edhe disa ekspertë të cilët mund të jenë të njëanshëm, por edhe të tjerë të paanshëm. Ky oqean fjalësh, informacioni, akuzash mbi re-

formën në drejtësi e bën të pamundur për njerëzit e thjeshtë para aparatit të smartfonit apo të televizorit për të kuptuar se ç’po ndodh, ç’është reforma, a është e mirë, apo merret në kontroll politik etj.

Mënyra e dytë është e folura nëpër media me gjuhë teknike. Kjo bën që njerëzit të mos mund të

kuptojnë se cila është e vërteta në thelb. Pra, le të marrim përsëri rastin e reformës në drejtësi. Deputetë, qeveritarë, këshilltarë të vetë qeverisë, analistë flasin për krijimin e KLGJ-së dhe mënyrën se si do të zgjidhet ajo, flasin për mënyrën se si e ka bërë ky vend apo ai vend, flasin për rezultatet që



kanë dhënë në këtë vend, flasin për komisionin “A” që do të verifikojë çështjen “B”, flasin për nenin që e rregullon këtë gjë dhe për pikën e ligjit apo germën e Kushtetutës ku mbështetet etj. Këtë gjë e bëjnë edhe përfaqësuesit e opozitës, të cilët, po ashtu, zhyten nëpër gjëra teknike dhe përballë njerëzve ndodh

një implosion i kuptimit.

Mënyra e tretë e implosionit të kuptimit bëhet nëpërmjet spektaklit. Kryeministri vishet sipas modës japoneze dhe gjithçka ai thotë nuk merr vëmendje. Kryeministri vishet me atlete dhe sërish nuk merr vëmendje ajo që ka rëndësi. Gjatë diskutimit mbi ligjin “A”, kur disa

studentë protestuan duke gjuajtur me vezë Kryeministrin, pyetja që mori kohë të konsiderueshme ishte ku i blenë studentët vezët dhe si i fshehën. Gjatë debatit për zgjedhjet në SHBA dikush flet për rastin e Monika Levinskit, gjatë një debati mbi islamofobinë dikush për mjekrën si objekt domethënës, dikush tregon një rast të një myslimani që pinte raki etj. etj. Të gjitha këta këto detaje spektakli çojnë në implosion të kuptimit të gjërave.

Shqipëria nuk është një përjashtim nga bota, por si pasojë e 50 viteve komunizëm pushteti i teknologjisë është shumë i madh. Gati tërë popullata është pandalur pre e dëshirave që i imponohen nga televizioni apo interneti dhe kjo i bën ata thjesht frankenshtajnë të dëshpëruar, të kapur rob nga zemërimi i “përbindëshit”. Ndërsa aspekti tjetër, ai i manipulimit të mendjes së njerëzve për qëllime politike është edhe më i rrezikshëm, pasi njerëzit do të humbin çdo mundësi të ndryshonin sadopak diçka me vullnetin e tyre. Qeveria shqiptare po e shfrytëzon me mjeshteri pasojën e komunizmit të shoqëria dhe duke i shtuar kësaj edhe teknologjinë, gjendja është shumë e rëndë. ■



ERGYS MËRTIRI

Teknokultura që **KOLONIZON** shoqërinë shqiptare

Efektet sociale të modernitetit dhe teknologjizimit të jetës shoqërore kanë qenë, shpesh, më të mëdha se kërcënimet armëve të shkatërrimit në masë... **Në një kuptim të caktuar, arritjet dhe transformimet e mëdha të zhvillimit teknik e teknologjik jo vetëm që nuk na e kanë përmirësuar cilësinë e jetës, por, në mjaft aspekte, na e kanë përkeqësuar atë...**

MARRËDHËNIA E NJE-RIUT ME NATYRËN ka qenë prej kohësh një objekt i rëndësishëm i mendimit filozofik, prej nga janë zhvilluar qasje të shumta që lidhen me mënyrën sesi shohim dhe përfytyrojmë botën ku jetojmë. Për shumë kohë natyra është parë si një mekanizëm rregullues që mbron dhe organizon jetën, gjë që ka çuar në idenë se, në të njëjtën mënyrë, edhe natyra është mekanizmi i duhur rregullues për njeriun nëse nuk dëmtohet apo shtrembërohet nga ndërhyrjet e njerëzve.

Nga një pikëpamje e caktuar, natyra kujdeset për gjithçka. Ajo prodhon vetvetiu rendin e duhur të gjërave dhe ekuilibrin e duhur për mbrojtjen e jetës. Që nga logosi i Heraklitit, jemi mësuar të konceptojmë një parim rregullues që prodhon dhe organizon jetën, ndaj dhe pikëpamje të shumta sugjerojnë që njerëzit t'i kthehen asaj për të kërkuar rregullimin e problemeve të tyre. Ne jemi pjesë e këtij ekosistemi, ndaj dhe ajo çfarë duhet bërë është të mbrojmë ekuilibrin natyror që rregullon mjedisin tonë.

Mirëpo, jo gjithmonë mendimi ka ecur në këtë linjë. Sidomos në epokën moderne, e cila ka përmbysur thujtë gjithçka nga rendi tradicional, pikëpamje të tilla shihen shpesh me skepticizëm. Të paktën që prej iluminizmit, mendimi filloi të ecë në rrugë të tjera duke e parë natyrën njerëzore si diçka që mund të ndryshohet e përmirësohet, madje edhe të çrrënjohet.

Debate të shumta ekzistojnë lidhur me çfarë ne konsiderojmë natyrë njerëzore, çfarë është pjesë e saj e çfarë jo, apo edhe nëse kjo natyrë njerëzore ekziston vërtet, apo është një konstruktion i mendjeve tona. Në fakt, të qenët konstruktion nuk hedh dot poshtë ekzistencën e diçkaje të pavarur nga dija jonë për të. Shumë autorë shprehin se gjithçka që prodhon mendimi njerëzor është konstruktion dhe vetë natyra e dijes sonë, sidomos asaj moderne, është e tillë që të ndërtohet mbi konstrukcione. Madje edhe ligjet e natyrës që studiohen në shkencat natyrore janë gjithashtu konstrukcione njerëzore, të cilat nuk i përgjigjen ekzaktesisht mënyrës sesi funksionon natyra në vetvete, por që ne i përdorim si instrumente për të kuptuar dhe shpjeguar fenomenet në të.

Megjithatë, përfytyrime të ndryshme ideologjike e filozofike, të paktën që prej iluminizmit, kanë prodhuar një qasje dialektike në raport me natyrën. Teori të ndryshme shohin te “gjendja natyrore” barbarinë dhe kërcënimin e një shoqërie të egër e kaotike, e cila duhet lënë pas. Arsyeja është parimi i ri rregullues, i cili na emancipon nga natyra jonë dhe gjendja e

barbarisë nga e cila vijmë.

Pra, shqetësimi këtu nuk është sesi të mbrohet natyra, por sesi të tejkalohet ajo, apo edhe si ta sundojmë atë. Arsyeja nuk shihet më si pjesë e natyrës njerëzore, por si diçka e kundërt me të dhe, mbi të gjitha, si një instrument çlirues dhe emancipues prej saj. Arsyeja është ajo që merr përsipër të rikrijë botën nëpërmjet një aktiviteti ngushtësisht racional, shpesh në luftë me natyrën njerëzore apo me çdo entitet ekzistues të shoqërisë tradicionale që i reziston formave të reja të organizimit shoqëror.

Teknologjia është natyrisht njëri prej elementeve më domethënës të një narrative racionaliste, duke u parë si një faktor i madh transformues. E konsideruar vazhdimisht si një mjet i fuqishëm për ndryshimin dhe përmirësimin e kushteve të jetës njerëzore, ajo është parë gjithashtu si një instrument që na ndihmon të pavarësohemi nga natyra apo ta sundojmë atë. Nëpërmjet saj, njeriu ka arritur të ndryshojë rëndësisht mënyrën e jetesës, organizimin social e, rrjedhimisht, edhe kuadrin vleror e normativ duke ngazëllyer shpresat për një të ardhme të ndritur, si ajo që ëndërron iluminizmi.

Por, siç dihet, ka qenë pikërisht teknologjia ajo që ka prodhuar edhe kërcënimet më të mëdha. Fuqia shkatërrimtare e shekullit XX, përtej totalitarizmit, burokratizimit dhe racionalizimit të kimit politik, buron në një masë të madhe edhe nga rritja e tmerrshme e potencialit vrasës të ardhur prej teknologjisë. Në të vërtetë, armët bërthamore janë vetëm kërcënimet më të dukshme që ilustrojnë përballjen e shoqërive





moderne me teknologjinë. Efektet sociale të modernitetit dhe teknologjizimit të jetës shoqërore kanë qenë, shpesh, më të mëdha se kërcënimet armëve të shkatërrimit në masë.

Në një kuptim të caktuar, arritjet dhe transformimet e mëdha të zhvillimit teknik e teknologjik jo vetëm që nuk na e kanë përmirësuar cilësinë e jetës, por, në mjaft aspekte, na e kanë përkeqësuar atë. Arsyet janë të shumta dhe janë objekt studimesh e debatesh në shkencat shoqërore, por këtu do të mjaftohemi duke hedhur vetëm një vështrim mbi llojin e kulturës dhe shoqërisë që ka prodhuar raportin ynë me to.

IMPERIALIZMI I NJERIUT MBI NATYRËN

Antropologët tregojnë lidhje të shumta të çdo kulture me mjedisin natyror ku njerëzit jetojnë dhe shumë prej teorive të tyre e shohin vetë kulturën dhe sistemin vleror e normativ si produkt të marrëdhënieve të

njeriut me natyrën. Ka madje teori antropologjike që theksojnë se nevoja për ushqim e proteina është gjeneratori kryesor që prodhon kulturën në tërësi, si dhe çdo sjellje njerëzore.

Në fakt, lidhja e konceptit të kulturës me natyrën është e hershme sa vetë fjala “kulturë”. Etimologjikisht fjala kulturë, vjen nga latinishtja, colere, që do të thotë “mbjell” apo “lëroj tokën”. Hannah Arendt thotë se kjo fjalë lidhet, në radhë

MENDIMI

Shumë autorë shprehin se gjithçka që prodhon mendimi njerëzor është konstruksion dhe vetë natyra e dijes sonë, sidomos asaj moderne, është e tillë që të ndërtohet mbi konstruksione. Madje edhe ligjet e natyrës që studiohen në shkencat natyrore janë gjithashtu konstruksione njerëzore, të cilat nuk i përgjigjen ekzaktësisht mënyrës sesi funksionon natyra në vetvete, por që ne i përdorim si instrumente për të kuptuar dhe shpjeguar fenomenet në të.

ETIMOLOGJIA

Etimologjikisht fjala kulturë, vjen nga latinishtja, colere, që do të thotë “mbjell” apo “lëroj tokën”. Hannah Arendt thotë se kjo fjalë lidhet, në radhë të parë, me marrëdhënien e njeriut me natyrën, kultivimin dhe përkujdesjen derisa ajo të bëhet e përshtatshme për të jetuar. Por, ajo lidhet gjithashtu edhe me “kultin” e perëndive, përkujdesjen ndaj asaj çfarë i takon atyre. Sipas Arendt, i pari që e ka përdorur këtë term, pak a shumë në kuptimin e zakonshëm që e përdorim edhe sot, ka qenë Ciceroni, i cili me fjalën “colere” emëronte çështje të shpirtit dhe të mendjes.



të parë, me marrëdhënien e njeriut me natyrën, kultivimin dhe përkujdesjen derisa ajo të bëhet e përshtatshme për të jetuar. Por, ajo lidhet gjithashtu edhe me “kultin” e perëndive, përkujdesjen ndaj asaj çfarë i takon atyre. Sipas Arendt, i pari që e ka përdorur këtë term, pak a shumë në kuptimin e zakonshëm që e përdorim edhe sot ka qenë Ciceroni, i cili me fjalën “colere” emëronte çështje të shpirtit dhe të mendjes.

Arendt thotë se kultura si term lindi për herë të parë

në një popull bujqësor si romakët dhe se në Greqi nuk kemi një ekuivalent të këtij koncepti mbi kulturën, për shkak të mbizotërimit të zjtarisë të grekët. Si një popull bujqësor, romakët e shihnin çdo veprimtari njerëzore, që nga punimi i tokës deri tek arti, si kultivim të natyrës, ndërsa grekët, e konsideronin gjithçka si veprimtari prodhuese, një produkt të njeriut që i kundërvihet natyrës. Te grekët, madje, edhe vetë bujqësia shihej si një aktivitet ku njeriu ia grabit frytet natyrës, njëfarë

përdhunimi i tokës në mitrën e së cilës perënditë fshehin të mirat që ne konsumojmë.

Pra tek grekët kemi një pikëpamje që e shikon natyrën si diçka që duhet sunduar dhe nënshtruar, ndërsa te romakët si diçka për të cilën duhet ruajtur dhe mbrojtur. Mbi këtë vetëdije ngrihet edhe koncepti i tyre mbi kulturën, i cili përfshinin ruajtjen, mbrojtjen dhe trashëgiminë e asaj çfarë kultura arrin të krijojë, gjë që sjell edhe një kujdes ndaj së kaluarës. Është e kuptueshme që vetë kultivi-

mi i diçkaje presupozon akumulimin e një përvoje apo praktike, e cila kërkon kohë dhe bëhet e mundur vetëm nëpërmjet konservimit.

Ky vizion u ruajt kudo prej shekujsh, deri në fillimet e mendimit modern, ku njeriu fillon të priret drejt një antagonizmi me natyrën. Max Horkheimer dhe Theodor Adorno, duke folur për iluminizmin, tregojnë sesi ai i kundërvihet dijeve tradicionale, për të sjellë një dije të re që përmbledhet te racionaliteti, nëpërmjet së cilës pretendon të çmagjepsë botën nga mitet, besimet, zakonet e çdo praktikë, të konsideruar prej tij iracionale. Kjo çmagjepsje e botës është, sipas Horkheimer dhe Adorno-s, një mënyrë për të arritur një dije që, më shumë se njohje, është një pushtet mbi të. Ajo çfarë iluministët kërkojnë të mësojnë prej natyrës është mënyra sesi ta përdorin dhe ta zotërojnë atë. Duke zotëruar natyrën, ata do të mund ta zotërojnë njëkohësisht edhe vetë njeriun.

Në këtë mënyrë, qytetërimi modern, bashkë me çrrënjosjen e kulturës tradicionale, ka bërë të mundur denatyrimin e njeriut si në planin e brendshëm, ashtu dhe në atë të jashtëm. Zhvillimi i mjeteve në përdorim, krijimi i mjediseve urbane nën pushtetin e betonit, smokut, ndriçimit, trafikut, orëve të gjata në hapësira të mbyl-

lura, racionalizimi i mjeteve të prodhimit dhe ndarja e punës e, njëkohësisht, paaftësia e thellë për të mbajtur në funksionim institucione themelore të shoqërisë, si familja, lidhjet e gjakut apo besnikëritë tradicionale, janë tregues të distancës së thellë të krijuar midis njeriut dhe funksioneve të tij natyrore.

Historia e çrrënjosjes së natyrës nga njeriu ka ecur paralelisht me zhvillimin e mjeteve teknike në dispozicion të tij. Autorë të shumtë kanë treguar sesi veglat e punës dhe mjetet në përdorim arrijnë të ndryshojnë jo vetëm natyrën dhe organizimin e punës, por edhe vetë natyrën e njeriut që i përdor. Vetë jeta dhe sjellja e njeriut organizohet duke u nisur nga kushtet në të cilat e vendosin mjetet e punës që ai përdor për të siguruar jetesën. Zhvillimi i këtyre mjeteve ka sjellë transformime radikale

në mënyrën e organizimit të shoqërisë, mënyrën e jetesës, sjelljes njerëzore etj. Tëhuajsimi, siç parashtrohet fillimisht te Marks, ndarja e punës, e zhvilluar tek Dyrkhaim e sociologë të tjerë, apo kafazi i hekurt i racionalitetit i përpunuar nga Weber, janë disa nga sfidat e mëdha të një sistemi që punon kundër njeriut, i pikasur që herët në linjat kryesore të mendimit sociologjik.

Prej këtej, zhvillimi teknik ka sjellë një situatë ku njeriu i nënshtrohet krijesës së vet. Mjetet që njeriu ka shpikur për të realizuar shumë nga funksionet e tij jo vetëm kanë krijuar pavarësi prej tij, por e kanë vënë atë vetë në shërbim ndaj tyre. Teknologjia është tashmë ajo që prodhon, drejton, orienton, organizon jetën tonë duke u bërë parimi kryesor rregullues mes njerëzve. “Sa



Historia e çrrënjosjes së natyrës nga njeriu ka ecur paralelisht me zhvillimin e mjeteve teknike në dispozicion të tij.

Autorë të shumtë kanë treguar sesi veglat e punës dhe mjetet në përdorim arrijnë të ndryshojnë jo vetëm natyrën dhe organizimin e punës, por edhe vetë natyrën e njeriut që i përdor.

më shumë shpikim aparate për sundimin e natyrës,- thotë Horkheimer, -aq më shumë detyrohemi t'u shërbejmë atyre.” Sipas tij, nga njëra anë kemi unin njerëzor të zbrazur nga çdo substancë, nga ana tjetër kemi një natyrë të zbrazët që duhet zotëruar, pa pasur asnjë qëllim tjetër përveç zotërimit në vetvete: “Sundimi ‘përvetësohet’ për hir të sundimit”.

“Natyra, - thotë ai, - perceptohet sot, më shumë se kurrë, si një vegël e njeriut. Ajo është objekt i një shfrytëzimi total i cili, duke mos njohur asnjë objektiv të arsyes, nuk njeh asnjë cak. Imperializmi i pakufi i njeriut nuk ngopet kurrë. Meqë vënia nën zgjedhje e natyrës kryhet pa një motiv kuptimplotë, atëherë natyra nuk transhedentohet, por thjesht shtypet.”

MISIONI I PAMUNDUR I TEKNOLOGJISË

Ndërsa mendimi modern kishte zënë fill prej kohësh në kulturën e shkruar europiane, ajo që bëri të mundur avancimin e modernitetit në realitetin social, ishte pikërisht zhvillimi i mjeteve të prodhimit, i cili mori një hov të madh me revolucionin industrial. Shpikja e motorit me avull ishte një moment i rëndësishëm që i dha shtysë një zinxhiri të gjatë hallkash që transformuan rrënjësisht shoqërinë njerëzore, të tilla si industrializimi, urbanizimi, informatizimi e burokratizimi, të cilat sollën me vete edhe zhvillime të mëdha politike, si lindja e demokracisë, qytetarisë, nacionalizmit etj. deri te shoqëria e konsumit dhe ajo postindustriale.

Një zhvillim i rëndësishëm në këtë proces është rritja dhe intensifikimi i komunikimit dhe i informacionit, gjë që solli fillimisht homogjenizimin kulturor të shoqërive moderne, deri në shoqëritë e sotme të komunikimit digjital, të karakterizuara nga ajo që studiues të ndryshëm e konsiderojnë si implozion të informacionit. Ndryshe nga ç'kanë parashikuar autorë të rëndësishëm si Habermas-i, shoqëritë moderne nuk po shkojnë drejt përmirë-

simit të informacionit, por drejt shkatërrimit të tij nga vetë mjetet e komunikimit. E njëjta gjë mund të thuhet se vlen edhe për dijen, arsimimin, e natyrisht edhe për kulturën.

Informacioni bëhet i rëndësishëm për shoqëritë moderne. Vetë natyra e sofistikimit të punës, prodhimit, tregtisë etj., kërkon një nivel të caktuar njohurish, informimi dhe aftësimi teknik dhe kjo bën që tregu i punës të rrisë nevojën për punë të kualifikuar e profilizuar. Por, megjithatë njeriu modern nuk është bërë më i ditur. Profilizimi ka sjellë teknikalizimin e njohurive dhe aftësimi në profesion krijon individë që kualifikohen në një fushë të caktuar, por mbeten të paaftë për të patur dije koherente në një rrafsh kulturor të përgjithshëm.

Zhvillimi i mjeteve të prodhimit ka zëvendësuar tashmë në mënyrë të paimagjinueshme krahun njerëzor të punës. Natyra e punës në shoqëritë e industrializuara nuk lidhet më drejtpërdrejt me produktin, por me aftësinë në përdorimin e makinerive, apo mbulimi i hallkave të ndryshme në zinxhirin e prodhimit. Në shoqëritë pas-industriale, kjo situatë ka ndryshuar edhe më shumë. Duke ndryshuar natyra e punës, kjo sjell patjetër ndryshime thelbësore në shoqëri, duke filluar nga shtresëzimi social, formimi kulturor, mënyra e jetesës e deri tek zhvillimet politike.

Megjithatë, zhvillimi teknologjik, sado që u ka lehtësuar shumë gjëra njerëzve, nuk ka sjellë ndonjë përmirësim të madh cilësor në jetesën e tyre. Njerëzit nuk janë bërë më të lumtur sesa kur nuk kishin në dispozicion mjetet që kanë sot. Madje, përkundrazi, psikologët dhe sociologët flasin për rritje të ndjeshme të ankthit, stresit, depresionit dhe një sërë shqetësimesh që kanë të bëjnë me pa-sigurinë, vetminë sociale, etj.

Pajisjet elektroshtëpiake, p.sh., mund të kenë sjellë shumë lehtësira në punët e shtëpisë, gjë që ka krijuar kushte më të favorshme për punësimin e grave dhe një ndryshim të madh të rolit social të tyre, por nevoja



Qytetërimi modern, bashkë me çrrënjosjen e kulturës tradicionale, ka bërë të mundur denatyrimin e njeriut si në planin e brendshëm, ashtu dhe në atë të jashtëm. Zhvillimi i mjeteve në përdorim, krijimi i mjediseve urbane nën pushtetin e betonit, smokut, ndriçimit, trafikut, orëve të gjata në hapësira të mbyllura, racionalizimi i mjeteve të prodhimit dhe ndarja e punës, njëkohësisht, paaftësia e thellë për të mbajtur në funksionim institucione themelore të shoqërisë, si familja, lidhjet e gjakut apo besnikëritë tradicionale, janë tregues të distancës së thellë të krijuar midis njeriut dhe funksioneve të tij natyrore.

për këto pajisje ka sjellë gjithashtu rritje të kostove të jetesës për blerjen, mirëmbajtjen dhe përdorimin e tyre, duke përfshirë këtu edhe një sërë shpenzimesh, të tilla si ato për energji, transport, shërbime, të cilat kërkojnë më shumë të ardhura, e për pasojë, më shumë punë. Edhe ajo kohë e lirë e fituar nëpërmjet pajisjeve që zëvendësojnë punën njerëzore, përthithet gjithashtu nga mjetet teknologjike që kemi në përdorim, kjo për shkak edhe efekteve sociale që ka sjellë moderniteti, si atomizimi, humbja e lidhjeve shoqërore të dikurshme dhe dobësimi i jetës komunitare. Në këtë mënyrë, teknologjia, ashtu siç na e krijon kohën e lirë, ashtu edhe na e merr, duke prodhuar nevoja artificiale, të cilat i përmbush po ajo. Në raport me punën, në vitet 30 ekonomisti më i rëndësishëm i kohës John Maynard Keynes parashikonte një të ardhme të lumtur për shoqëritë moderne. Ai besonte se shumë shpejt, falë zhvillimeve të mëdha teknologjike, njerëzit do të fitonin kohë, duke punuar vetëm 3 orë në ditë, dhe të gjithë pjesën tjetër do të mund t'ia kushtonin vetes së tyre duke “shijuar jetën” e duke u marrë me art, kulturë dhe fe.

Por këto parashikime dolën të gabuara. Zëvendësimi i punës njerëzore nga makinat nuk ka sjellë ndonjë ulje radikale të orëve të punës. Përkundrazi, ai ka sjellë rritje të papunësisë, duke vështirësuar pozitat e punonjësve në tregun e punës. Presioni i

punëdhënësve është rritur, duke i detyruar punëtorët të pranojnë kushte më të vështira pune, me orare të zgjatura. Studimet tregojnë kudo një nivel të lartë të rritjes së stresit në punë, gjë që tregon për një tablo tjetër nga parashikimi i Keynes-it.

Ka gjithmonë një gur peshe nga ana tjetër e kandarit që balancon çdo përparim teknologjik të shoqërive moderne, i cili madje, në më të shumtën e rasteve, rëndon më shumë se këto përparime. Sot edhe vetë shoqëritë e zhvilluara vuajnë presionin e krizave dhe pamundësisë për të kënaqur qytetarët, për të mos folur për vendet e varfra e ato në zhvillim. Kjo vjen, në një masë të konsiderueshme, për shkak se teknologjia nuk është zhvilluar në funksion të njeriut, e kontrolluar nga vlera dhe standarde etiko-kulturore humanizuese, por e kundërta, ajo është kthyer në qëllim në vetvete, teksa shoqëritë moderne kanë humbur çdo lloj qëllimësie e sistemi vlerash. Fusha që përcakton natyrën e zhvillimit nuk është natyra njerëzore, por natyra e mjeteve të prodhimit dhe e ambicies për maksimalizim të performancës prodhuese.

KOLONIZIMI I KULTURËS

Kultura e konsumit është rrjedhojë e pashmangshme e një procesi të gjatë të emancipimit të shoqërive moderne prej natyrës njerëzore, që mund të themi se fillon me mitin e arsyes

“**Shoqëritë moderne jo vetëm që nuk arritën të bëhen më të arsyeshme, por rrëshqitën gradualisht drejt formave të reja të iracionalitetit, i cili, ndryshe nga iracionaliteti i shoqërive paramoderne, nuk ofron dot më as legjitimitet e as kohezion social.**”

dhe vazhdon me një sërë zhvillimesh, politike, ekonomike e kulturore, ku teknologjia zë një vend të rëndësishëm. Besimi tek arsyeja solli një proces radikal zëvendësimi të strukturave dhe vlerave tradicionale, për të ofruar një model të ri shoqërie të ngritur jo më mbi traditat apo kodet zakonore të trashëguara, por mbi racion, si i vetmi burim legjitimiteti për vlerat dhe institucionet shoqërore. Për rrjedhojë shoqëritë moderne karakterizohen nga një rritje progresive e rolit të shtetit dhe një dominim të planifikimit në hartimin e politikave shoqërore, të cilat, gjithnjë e më shumë, defunksionalizojnë instancat e pavarura komunitare të dikurshme.

Mirëpo kjo bart një sërë problemesh. E para, njeriu, si një qenie komplekse, nuk mund të kyçet tek arsyeja. E dyta ai e ka të pamundur të riprodhojë shoqërinë në të gjitha elementet e saj thjesht dhe vetëm nëpërmjet arsyes. Zinxhiri i operacioneve racionale që kërkon sanksionimi i një sistemi vlerash të legjitimuar nga arsyeja, bëhet aq i gjatë sa nuk mund ta shterojë logjikën, e gjithashtu as informacionin e nevojshëm.

Si rrjedhim, miti i arsyes nuk solli një sistem legjitim vlerash, e as një përmirësim të

aftësive konjitive të njeriut në shoqëritë moderne, por çoi në mënyrë të pashmangshme në prodhimin e ideologjive që, ashtu si edhe mitet e botës së vjetër, formulojnë skema të thjeshtuara interpretimi mbi botën, në funksion të projektit të tyre politik e kulturor. Totalitarizmi është një prej pasojave logjike të këtij procesi. Tjetri është nihilizmi cinik i një bote të paaftë për të ndërtuar një rend të përbashkët vlerash. Kultura e konsumit është rrjedhojë e pashmangshme e këtij procesi, në të cilin, ironikisht, arsyeja bëhet edhe më e zbehtë se në shoqëritë tradicionale.

Në këtë mënyrë, shoqëritë moderne jo vetëm që nuk arritën të bëhen më të arsyeshme, por rrëshqitën gradualisht drejt formave të reja të iracionalitetit, i cili, ndryshe nga iracionaliteti i shoqërive paramoderne, nuk ofron dot më as legjitimitet e as kohezion social. Kultura e konsumit bëhet rrjedhojë e pashmangshme e ekspansionit të arsyes, i cili prodhoi një shoqëri ku iracionaliteti nuk na çon më te bashkësia, kohezioni, solidariteti apo holizmi i shoqërive paramoderne, por tek individualizmi atomizues, konfuzioni, vaniteti, etj. Në këto kushte të vetmet vlera që arrijnë të marrin kuptim përtej nihilizmit racional, janë ato që kanë të bëjnë me logjikën e tregut, të cilat lidhen kryesisht me suksesin apo efikasitetin sipas raportit input-output. Kjo lloj shoqërie shndërron gjithçka në mall, duke këmbyer gjithçka në një vlerë tregu.

Një ndër konceptet e rëndësishme që shënjon shoqëritë industriale është ai i “shoqërisë së masave”, i cili, sipas Hannah Arendt, tregon për një model të shkatërruar shoqërie që përmbledh të gjitha tiparet e psikologjisë së turmave: mungesën e standardeve, të qenit vetëm, paaftësinë për të menduar, aftësinë për konsum e mbi të gjitha egocentrizmin dhe tjetërsimin. Ajo e shikon këtë fenomen si pasojë të trupëzimit në shoqëri të masave të gjera të popullsisë. Duke u rritur numri i njerëzve që fitojnë pasuri, e për pasojë edhe kohë të lirë, fillon të rritet numri i individëve

që fiton akses tek kultura dhe arti. Kultura nuk është më monopol i aristokracisë. Ajo zbrit në masa, duke zhbërë vetveten për t'u transformuar gradualisht në atë që njihet si "kulturë e masave".

Fillimisht, ky proces shfaqet tek filistinizmi, ku arti dhe kultura humbasin vlerat e tyre universale duke u shndërruar në mjete të shtresave të reja të pasuruara të popullsisë, në funksion të nevojës së tyre për të fituar një rang shoqëror më të lartë. Arti dhe kultura nuk përfaqësojnë më përsosmërinë dhe përjetësinë, por një fushë përdorimi funksional për një kategori të caktuar individësh që sa vjen e zgjerohet. Për këtë arsye, veprat e pavdekshme të artit fillojnë të vlerësohen në bazë të dobisë së tyre shoqërore. Ideja moderne kërkon tashmë që arti të jetë funksional, gjë që, në thelb, është pa lidhje me artin në vetvete. Sipas Arendt-it, kjo e bën kulturën të shihet si një mall i këmblyshëm në vlerë. Ajo bëhet një monedhë me të cilën filistini blen statusin e tij të ri. Kjo çon në zvetënimin kulturor dhe një "ankand të vlerave", ku kultura zbrit nga pavdekësia.

Megjithatë, Arendt thotë se sado që shoqëria e periudhës së filistinizmit, e etur për kulturë, i zhvlerësoi, përdori dhe keqtrajtoi objektet kulturore për qëllimet e veta egoiste, ajo sidoqoftë nuk i "konsumoi" ato. Këto objekte u kthyen në një grumbull plehrash, por nuk u zhdukën. Ndërsa, ajo që bën shoqëria e masave është krijimi i një standardi tjetër, ku shoqëria nuk interesohet më për kulturë në vetvete, por vetëm për argëtim. Industria e kulturës e përdor kulturën si mall konsumi në funksion të argëtimit. Argëtimi është ai që mbush kohën bosh të njeriut dhe kultura bëhet materiali që tregtohet për këtë qëllim.

Ndryshe nga natyra e artit dhe e kulturës, objektet e të cilave vlerësohen nëpërmjet jetëgjatësisë, produktet e industrisë së kulturës konsumohen shpejt dhe serviren të freskëta. Kultura që prodhon kjo lloj industrie nuk kërkon aspak t'i rezistojë kohës,

por, përkundrazi, të konsumohet shpejt në mënyrë që të prodhohen produkte të reja, e kjo në mënyrë të vazhdueshme, duke përmbushur pa pushim nevojën e pangopur të tregut për konsum. Pra, argëtimi e plaçkit kulturën. Veprat e klasikëve p.sh. ofrohen sipas versioneve të reja, të shkurtuara, të rishkruara e vulgarizuara për t'u konsumuar lehtë, në një film apo një produkt tjetër të destinuar për masat. Ky proces, thotë Arendt, nuk e përhap kulturën te masat, por përkundrazi e shkatërron atë me synim për të nxjerrë prej saj argëtim. Për këtë arsye, kjo shoqëri nuk mund të bëhet kurrë e kulturuar.

Kjo temë është rimarrë nga shumë autorë të shkencave shoqërore. Daglas Kellner dhe Herbert Markuze kanë zhvilluar një kritikë të shoqërive duke evidentuar rolin e teknologjisë. Markuze e shikon teknologjinë në përgjithësi, e sidomos televizionin, sportet dhe seksin si mjete të prodhimit kulturor. Ai gjykon se ato përdoren si mjete kontrolli për ndrydhur individualitetin dhe për të zbutur reagimin shoqëror, duke i bërë individët të humbasin aftësinë për të menduar në mënyrë kritike rreth shoqërisë. Pra ku-





Kultura nuk prodhohet më në mënyrë të vetvetishme nga shoqëritë, por nëpërmjet mjeteve të tilla, të kontrollit, të cilat kanë sjellë shndërrimin e njeriut në një “qenie njëdimensionale”.

ltura nuk prodhohet më në mënyrë të vetvetishme nga shoqëritë, por nëpërmjet mjeteve të tilla, të kontrollit, të cilat kanë sjellë shndërrimin e njeriut në një “qenie njëdimensionale”. Sipas tij, teknologjia moderne është një nxitëse drejt totalitarizmit, si një mjet efikas skllavërimi, për të dominuar njerëzit duke kufizuar dhe pushtuar lirinë e brendshme të aktorëve sociale.

Megjithëse në të njëjtën linjë mendimi, ndryshe nga Markuze, Kellner nuk e sheh realitetin si produkt të një kontrolli të organizuar. Ai nuk pranon ta shohë këtë proces si një instrument të ideologjisë kapitaliste. Ai thotë se televizioni nuk është monolitik, dhe nuk është i kontrolluar nga forca koherente, por është një media konfliktuale, ku ndërthuren forca ekonomike, politike, sociale e kulturore në përplasje me njëra-tjetrën.

Kellner, sidoqoftë, nuk e kursen kritikën ndaj shoqërisë së masave dhe kulturës së prodhuar në kushtet e ndikimit të madh të teknologjisë dhe komunikimit në shoqëritë moderne. Ai përpunon konceptin e teknokulturës, me të cilin ai shënjon kulturën e konsumit, ku mallrat e konsumueshme, si dhe ato të argëtimit, përfshi këtu edhe informacionin e kompjuterizuar, dominojnë kulturën në shoqëritë moderne. Teknokultura krijohet nëpërmjet produkteve të reja kulturore që po “kolonizojnë” jetën e përditshme, si “spektakli, imazhi, estetika e komoditeteve” etj. Kellner e vendos theksin te televizioni si pjesë e rëndësishme e kësaj industrie, duke e parë atë si një kërcënim jo vetëm për kulturën, por edhe për

demokracinë, individualitetin dhe lirinë.

HAPAT E PARË TË NJË SHQIPËRIE INDUSTRIALE

Elementet e para të modernizimit në shoqërinë shqiptare mund të thuhet se fillojnë që në shek. XIX me krijimin e disa formave fillestare të kapitalizmit. Siç kanë vënë në dukje autorë të ndryshëm, gjatë kësaj periudhe shfaqen shenjat e para të borgjezisë, të ardhura si pasojë e rritjes së marrëdhënieve tregtare, krijimit të fabrikave të para, si dhe, natyrisht, dobësimit sistemit të esnafëve. Këto ndryshime fillestare u shoqëruan gjithashtu me ndikime të rëndësishme ideologjike tek intelektualët e kohës, ku mendimi modern kishte depërtuar tashmë të shumë patriotë shqiptarë. Ndonëse shumica e tyre kishin njëfarë prirjeje për të mbajtur qëndrime konservatore, duke mbrojtur trashëgiminë kulturore, vlerat, zakonet, traditën, madje edhe hierarkinë sociale, ata ishin të ndikuar ndjeshëm nga idetë iluministe, në variantin e tyre më revolucionar, siç e gjejmë tek Rusoi e Volteri.

Megjithatë, rruga e modernizimit të vendit fillon të marrë hov në vitet 20-30. Gjatë kësaj periudhe u bënë shumë ndryshime si në rrafshin politik, ashtu dhe atë ekonomik e kulturor. Paralelisht me avancimin ideologjik, u hodhën themelet e zhvillimit të një ekonomie tregu, dhe një rendi politik modern. Gjatë kësaj periudhe hidhen hapat e parë seriozë për krijimin e një industrie në zhvillim, ku përfshihen hapja e disa fabrikave, investimet në industrinë minera-

re, hapja e Bankës së Shqipërisë, ndërtimi i infrastrukturës bazë në rrjetin rrugor apo atë të telekomunikacionit, rritje të ndërtimtarisë në thuajse të gjitha qendrat urbane, reforma në bujqësi, si dhe zhvillimi i arsimit bazë. Kjo u shoqërua me implementimin e një sistemi politik të ngjashëm me atë perëndimor, pavarësisht paqëndrueshmërisë dhe mungesës së institucioneve funksionale, si edhe krijimin e një legjislacioni modern të huazuar nga vendet europiane.

Të gjitha këto u krijuan në një frymë oksidentalizimi, i kuptuar në shumicën e rasteve si një transformim thellësisht iluminist, me të cilin identifikohesh shumica e intelektualëve dhe aktorëve politikë. Në perceptimin e tyre, një vend i zhvilluar do të thotë një vend i modernizuar jo vetëm në politikë dhe ekonomi, por sidomos në mënyrën e jetesës së shoqërisë. Pra zhvillimi industrial kërkonte edhe krijimin e një kulture të re, që i përgjigjet shoqërive industriale, gjë që do të thoshte prodhimin e një shoqërie të re, të ndryshme, madje edhe të kundërt, me atë të deriatëhershme.

Në këtë mënyrë, intelektualët shqiptarë të kësaj periudhe, në mjaft raste e shikonin kulturën tradicionale si një mbeturinë mesjetare, apo refleks të sundimit turk, prej të cilave vendi duhet të çlirohet sa më parë, për t'u radhitur në popujt e përparuar. Shumë prej tyre e konsideronin shoqërinë tradicionale si diçka të panatyrshme për shqiptarët, të imponuar prej pushtimit, e cila i ka penguar shqiptarët të ecin me hapin e kohës. Në një masë të konsiderueshme, ata i janë qasur

traditës në mënyrë antagoniste, dialektike, të ndikuar nga mitet orientaliste, iluministe e moderniste.

INDUSTRIA NJERËZORE NË SHQIPËRI

Gjatë regjimit komunist, vendi hyri në një proces radikal industrializimi, por pa realizuar dot një zhvillim industrial të vërtetë. Shqipëria mbeti një vend bujqësor, me një ekonomi të planifikuar, të paaftë për të konkurruar me asnjë vend në rajon, duke u zhytur në varfëri të thellë, si kurrë më parë. Ideja e industrializimit mbeti më shumë një propagandë e pushtetit sesa një realitet. Sidoqoftë, konsolidimi i vërtetë i miteve moderniste në Shqipëri realizohet më shumë gjatë kësaj periudhe, ku puna dhe zhvillimi industrial zënë një vend qendror. Mitet moderniste u përdorën prej kësaj ideologjie për të instaluar përfytyrimin e saj mbi botën dhe shoqërinë.

Vetë komunizmi është një pikëpamje që punën e ka në qendër të vëmendjes. Komunizmi është një ideologji e lindur në një përballje klasore mbi punën dhe mjetet e prodhimit. Natyrisht, puna do të ishte themeli mbi të cilën edhe komunizmi shqiptar do të ndërtonte ideologjinë dhe propagandën e vet. Jo më kot, Partia Komuniste ndryshoi emrin pasi erdhi në pushtet, duke u quajtur Parti e Punës. Ajo do të prodhonte një ligjërim të pasur mbi punën, ndërtimin e vendit dhe zhvillimin teknologjik e industrial të tij. Miti i industrializimit ishte një nga kolonat kryesore të retorikës enveriste dhe një nga krenaritë më



Gjatë regjimit komunist, vendi hyri në një proces radikal industrializimi, por pa realizuar dot një zhvillim industrial të vërtetë.

Shqipëria mbeti një vend bujqësor, me një ekonomi të planifikuar, të paaftë për të konkurruar me asnjë vend në rajon, duke u zhytur në varfëri të thellë, si kurrë më parë.

të mëdha të propaganduar asokohe, së bashku me atë të mbrojtjes së atdheut të materializuar tek “ushtria popullore”. Vetë simbolet e regjimit, të promovuara sipas parullës “në njerën dorë kazmën, në tjetrën pushkën”, tregojnë paralelet ku vendosen shinat e marshimit të revolucionit enverist drejt destinacionit historik të projektuar për kombin shqiptar.

Regjimi ka punuar fort për të përfutur imazhin e një vendi që po zhvillohet e industrializohet me ritme revolucionare. Edicionet informative dhe faqet e gazetave ishin të mbushura me lajme që trumbetonin arritjet e vendit që nga ndërtimi i veprave industriale, hapja e tokave të reja, risitë teknologjike të prodhimit, e deri tek realizimi i planit në çdo fabrikë, ndërmarrje apo kooperativë bujqësore. Një sërë veprash të mëdha industriale, si uzina, fabrika, kombinat, ndërtoheshin pranë qyteteve kryesore dhe rrugëve nacionale, në mënyrë që ato të ishin të dukshme për kalimtarët dhe mund të shërbenin si ekspozitë të madhështisë së pushtetit që i kish krijuar. P.sh. Kombinati Metalurgjik i Elbasanit shpalohej madhështor përgjatë rrugës malore Tiranë-Elbasan, duke u shfaqur si një qytet më vete, nga veranda e qafës së Kërrabës. Njësoj si kishat gotike në mesjetë, veprat e mëdha industriale, si fabrika, uzina, kombinat, janë monumentet e madhështisë së pushtetit që lartësohet në sytë e individëve, për t'i bindur ata në fuqinë e tij.

Jo vetëm lajmet dhe mjetet e përditshme të propagandës, por edhe letërsia, artet figurative dhe kinematografia e kohës, u angazhuan të instalonin atë përfytyrim mbi publikun e kohës. Industrializimi zuri një pjesë mjaft të madhe të subjekteve të filmave, dramave, romaneve, poezive e këngëve të kohës, ku glorifikohej roli i Partisë në zhvillimin e vendit dhe promovoheshin ndërgjegjësimi popullor për t'u angazhuar në projektet e mëdha të saj. Madje ky përfytyrim ngulitej deri në kopshtet e fëmijëve, nëpërmjet vjershave e këngëve që

i kushtoheshin babait minator, metalurgëve apo kombinatëve, puna e të cilëve ua bënte jetën më të bukur.

Piktura sociorealiste shqiptare është e mbushur me kompozime fabrikash e kantieresh ku heronjtë e rinj të socializmit pozojnë në mënyrë patetike plot vrull e krenari për triumfet e përditshme të një vendi që po shpërthen drejt zhvillimit. Imazhe të tilla instalohen deri te prerjet e kartëmonedhave ku përftohen vizualizime të arave plot grurë që dallgëzojnë me madhështi prej reformave agrare të ndërmarra nga partia, montatorëve të palodhur që projektojnë të ardhmen e lulëzuar të vendit mes vinçave që mbajnë peshën e transformimeve të mëdha, punonjëseve të tekstitil që i jepen gëzueshëm ritmit të makinerive apo digave të hidrocentraleve të mbushura me “dritën e partisë” e cila shpërndahet në çdo shtëpi, bashkë me gëzimin për arritjet e mëdha të atdheut socialist.

Në të njëjtën mënyrë kinematografia e kohës i përkushtoheshin fuqishëm tematikave me heronj që çajnë bllokadat në krijimin e veprave të mëdha industriale, duke i thurur himne zhvillimit të vendit, paralelisht me të, edhe djersës së njerëzve të thjeshtë e të përkushtuar, që punojnë me vetëmohim, deri në vetëflijim për ndërtimin dhe mbrojtjen e tyre. Filma me një tematikë të tillë, që flasin për diga hidrocentralesh, ndërtime hekurudhash, tharje kënetash, ndërtime fabrikash, shpime pusesh për naftë, probleme minierash, rritje të prodhimit në ara, prodhime e montime makinerish etj. janë të shumtë në repertorin e kinemasë shqiptare, dhe kanë qenë një ndër objektet themelore ku mbështetej propaganda e regjimit, bashkë me atë të luftës antifashiste. Kjo lloj tematike mbushte edhe festivalet e këngës, me ritme revolucionare fabrikash e uzinash, ku lulëzon jo vetëm jeta e vendit, por ku nisin edhe dashuritë e të rinjve, për t'u bërë nesër prindër të mirë dhe punëtorë të zellshëm në ndërtimin e atdheut.

Vetë propaganda e kohës predikonte

ndërtimin e vendit, si një vazhdim të revolucionit komunist të nisur nëpërmjet pushkës së partizanëve në luftën kundër okupatorit gjatë pushtimit nazi-fashist. Industrializimi i vendit konsiderohej një vazhdim i kësaj lufte, i cili kërkonte të njëjtën vetëdije revolucionare e vetëmohuese sa ajo e përballjes me pushtuesit.

Në perceptimin e propagandës komuniste, ky zhvillim i madh i vendit paraqitej si një lloj triumfi jo vetëm mbi forcat e errëta reaksionare, klasën e përmbysur, zakonet prapanike dhe mbeturinat mikroborgjeze, por edhe mbi vetë natyrën, të cilën regjimi kish marrë përsipër ta ndryshojë rrënjësisht. Pavarësisht se flitej rëndom mbi Shqipërinë si një vend i bukur e i begatë, retorika e tij pohonte se kjo është bërë e mundur falë punës së palodhur të partisë, e cila ia kish ndërruar faqen vendit. Aq e thellë ka qenë kjo propagandë sa barsoletat e kohës talleshin me një prej anëtarëve të atëhershëm të Byrosë Politike, të cilin e citonin të ish duke kundruar peizazhin e një pylli të bukur: “Eh mor pyll, sa i bukur je, dhe sa të gjelbër të ka bërë Partia!”

Udhëheqja politike e kohës ndërmori një mori aksionesh për transformime rrënjësore të vetë natyrës, shumë prej të cilave sollën edhe dëmtim të resurseve: tharje kënetash, aksione pyllëzimi, ndërtimin e digave që krijonin liqene mbi lumenj, krijimi i brezareve etj. Një parullë e kohës për ndërtimin e taracave mbi kodra predikonte moton e partisë “T’u qepemi maleve dhe kodrave, për t’i bërë ato më pjellore se fushat!”. Në aksione të tilla janë prerë pyje pa fund për të ndërtuar brezare, me qëllim që edhe zonat kodrinore të shndërroheshin në tokë bujqësore. Dhe kjo bëhej në një kohë kur predikohej se pyjet po shtoheshin në saj të aksioneve popullore të organizuara për mbjelljen e fidanëvetë rinj.

Elektrifikimi i vendit predikohej si një arritje e madhe në luftë me errësirën e natës. Këngë me tematikë sociorealiste glorifikonin



KOMUNIZMI

Vetë komunizmi është një pikëpamje që punën e ka në qendër të vëmendjes. Komunizmi është një ideologji e lindur në një përballje klasore mbi punën dhe mjetet e prodhimit. Natyrisht, puna do të ishte themeli mbi të cilën edhe komunizmi shqiptar do të ndërtonte ideologjinë dhe propagandën e vet. Jo më kot, Partia Komuniste ndryshoi emrin pasi erdhi në pushtet, duke u quajtur Parti e Punës. Ajo do të prodhonte një ligjërim të pasur mbi punën, ndërtimin e vendit dhe zhvillimin teknologjik e industrial të tij. Miti i industrializimit ishte një nga kolonat kryesore të retorikës enveriste dhe një nga krenaritë më të mëdha të propaganduar asokohe, së bashku me atë të mbrojtjes së atdheut të materializuar tek “ushtria popullore”. Vetë simbolet e regjimit, të promovuara sipas parullës “në njërën dorë kazmën, në tjetrën pushkën”, tregojnë paralelet ku vendosen shinat e marshimit të revolucionit enverist drejt destinacionit historik të projektuar për kombin shqiptar.

mbërritjen e dritës elektrike në fshat, si një sfidë ndaj paaftësisë së natyrës për të na e bërë natën të ndriçuar. Teksti i një kënge të tillë metaforizon lënien pa punë të hënës në qiell, nga elektrifikimi i vendit:

**“Doli hëna prapa malit,
t’i ndriçojë rrugën djalit.
Foli hëna: - ç’duhem unë,
fshati paska drita shumë!”**

Lufta me natyrën u përshkallëzua domos edhe në raport me natyrën njerëzore. Në predikimet e kohës, por edhe në veprat artistike komunisti paraqitet si një qenie e mbinatyrshme, pa vese, pa dobësi, i papërkulshëm përballë çdo lloj vështirësie, i patundueshëm nga asnjë lakmi njerëzore, tek i cili nuk depërtonte kurrë as frika, as dyshimi, as hezitimi. Komunisti ishte njëfarë mbinjeriu jo i natyrës niçeanë që i adresohet vullnetit për pushtet, por i një natyre moraliste, të karakterizuar nga një altruizëm i thellë: “I pari në sakrificë, i fundit në pretendime”.

Paralelisht me zhvillimin ekonomik, inxhinieria sociale ideologjike e regjimit kish projektuar një industri njerëzore për fabrikimin e një lloji të ri të shqiptarësh, që ajo e quante “njeriu i ri”. Kjo ishte një qenie kuazi-njerëzore, e shkëputur nga trualli kulturor i trashëguar, dhe rivendosur në kushte të tjera jetese, të fabrikuar nga laboratorët e një industrie kulturore që kërkonte riprodhimin e shoqërisë nga fillimi. Në këtë mënyrë, ashtu si dhe në Rusi e vende të tjera, komunizmi shqiptar projektoi dhe vuri në zbatim zhvillime kulturore që synonin transformime rrënjësore. Edukimi në shkolla, teatrot, kinemaja, qendrat dhe vatrat e kulturës, deri te grupet artistike në çdo ndërmarrje e kooperativë, u angazhuan të masivizonin kulturën e fabrikuar nga pushteti, në funksion të krijimit të njeriut të ri.

Në thelb, i gjithë ky angazhim përbënte model tjetër të “kulturës së masave”, të trajtuar nga Hannah Arendt, që përmendëm më lart. Vetëm se, në këtë rast, nuk kemi të

bëjmë me shoqëri konsumi, por me një shoqëri të centralizuar në funksion të një projekti ideologjik. Këtu nuk është industria komerciale e kulturës që prodhon objektet kulturore në funksion të argëtimit, por është një industri e planifikuar shtetërore, që produktet i krijon në funksion të indoktrinimit. Kultura nuk shkatërrohet për të prodhuar argëtim, por manipulimin e masave në funksion të një projekti politik.

TEKNOKULTURA SHQIPTARE

Pas rënies së regjimit komunist, shqiptarët u orientuan në një drejtim të ri për zhvillimin e vendit. Europa u rikthye si objekt orientimi, duke u bërë aspiratë kryesore në vend. Por, siç edhe është e kuptueshme të ndodhë në një vend të dalë nga 50 vjet komunizëm, të indoktrinuar në mënyrë agresive me ideologji totalitare, europianizimi u shndërrua më shumë në një mit, sesa në një projekt politik të qartë.

Më shumë se një model politik, ekonomik e shoqëror, Europa u bë projektion i dëshirës së papërmbajtshme për konsum, pa menduar mbi sistemin e vlerave që i mban shoqëritë europiane. Europa u bë për shqiptarët projektioni i nevojës për të patur të gjitha ato të mira materiale të munguara në 50 vjet varfëri ekstreme, në kushtet e jetesës me tallon, ku nuk garantoreshin dot as nevojat minimale ushqimore. Europa u bë lakmi e të uriturve. Për këtë arsye shqiptarët iu turrën anijeve për t’u zhdukur një orë e më parë nga ky vend, pa prituri e menduar për zhvillimin dhe të ardhmen e tij. Zhvillimi kërkonte natyrisht kohë dhe mund, gjëra këto për të cilat shumica e shqiptarëve nuk kishte më durim.

Në retorikën e përgjithshme të këtyre tri dekadave, integrimi europian perceptohet më shumë si një proces modernizimi, i cili në fakt prodhon më shumë imitim të modeleve që vijnë nga perëndimi nëpërmjet mjeteve të komunikimit. Të jesh europian do të thotë

të jesh modern dhe të jesh modern do të thotë të shkëputesh nga e vjetra, nga tradita, trashëgimia kulturore që vjen nga e kaluara. Ashu si gjithçka, çdo aspiratë e shoqërisë shqiptare vjen në mënyrë dialektike, si një mekanizëm për të çrrënjosur diçka ekzistuese. Shqiptarët po kalojnë aktualisht në një tranzicion kulturor, ku vëmendësia kulturore është këputur. Aq e vërtetë është kjo sa edhe emrat që shqiptarët zgjedhin për fëmijët janë emra krejtësisht të huaj, gjë që nuk ndodh, të paktën në këtë përmasë, me asnjë popull tjetër.

Europa e shqiptarëve nuk është në fakt Europa e kombeve ku çdo vend ruan dhe zhvillon trashëgiminë e vet. Europa e shqiptarëve është një perceptim abstrakt që nuk i përgjigjet asnjë vendi konkret, i cili ka të bëjë më shumë me shoqërinë e konsumit, sesa me kulturën reale të shoqërive europiane. Shqiptarët priren ta barazojnë kulturën europiane me kulturën globale në përgjithësi, kulturën e masave, siç na vjen ajo nëpërmjet konsumizmit. Për këtë arsye, modernizimi i vendit është bërë tashmë një proces i thellë akulturimi, i cili implementon pikërisht ato tipare të kulturës së konsumit, të kritikuar nga thujtë të gjithë studiuesit dhe intelektualët seriozë në perëndim.



Në thelb, kultura shqiptare është reduktuar në një teknokulturë konsumiste, të implementuar në mënyrë reflektive si pasojë e fuqisë asimiluese të mjeteve të reja të komunikimit si dhe një stili jetese tërësisht materialist e hedonist, të interesuar vetëm për konsum. E ardhur nga një regjim 50-vjeçar, që shkatërroi trashëgiminë kulturore, si dhe çdo vlerë apo objekt jomaterial për të përmbushur aspiratat e njerëzve, ishte praktikisht e pamundur që shoqëria shqiptare të mos përfundonte këtu. Vendet e varfra në përgjithësi, e aq më tepër ato që kanë kaluar një gjenocid të brendshëm kulturor si Shqipëria, janë në përgjithësi vendet me ndikueshmërinë më të madhe nga televizioni dhe me rezistencën më të ulët ndaj kulturës së konsumit.

Kjo natyrisht që ka prodhuar një seri problemesh të mëdha të natyrës sociale,

kulturore, politike, si dhe ekonomike. Shqiptarët janë relativisht një popull lehtësisht i manipulueshëm, i paafhtë të vlerësojë në mënyrë kritike dhe të filtrojë mallrat, parimet apo pikëpamjet që i serviren nga agjenci të ndryshme të përpunimit masiv të shoqërisë. Rrjedhimisht, ata janë lehtësisht të viktimizueshëm nga politika abuzive dhe, rrjedhimisht, vështirësisht të aftë për të vendosur barriera ndaj tyre, apo për t'u organizuar në mbrojtje të vlerave dhe jetëve të tyre. Duke iu rikthyer Kellner-it, teknokultura shqiptare ka prodhuar një model shoqërie ku kultura e konsumit, mallrat e konsumueshme, si dhe ato të argëtimit dominojnë në mënyrë të pakonkurueshme. Kjo kulturë e re po kolonizon jetën shoqërore në Shqipëri, nëpërmjet spektaklit, imazhit manipulativ, estetikës dhe produkteve komerciale. ■

Aeroplanë të drunjte mbi Bosfor

Prova për një fjalor të fluturimit shqip: shkronja D, d.



ERVIN HATIBI

Kafeja duhet të pihet ekskluzivisht në filxhan adekuat të porcelanit (...) Vrojtimi i fatit nuk bëhet në asnjë mënyrë përmes filxhanëve të plastikës ose të ndonjë materiali tjetër, ndonëse edhe ato kanë cipë të bardhë vizëlluese.



KAFE ICARO (ITALI)

DA VINÇI SHQIPTAR

“Tri rrotulla peliçesh kunadheje e shqarthe, njëqind e dymbëdhjetë barrë me lesh, nëntë topa sateni bergamask, po aq kadife fiorentine e praruar, pesë fuçi nitrat, dy arka me pasqyra dhe një peshtaf i vogël bizhuterish: kjo është çka zbarkoi pas Michelangelo Buonarroti-t në portin e Kostandinopojës, të enjten, më 13 maj 1506. Ende fregata pa ankoruar mirë, kur skulptori kërcëu në tokë. I merren pak këmbët, pas atyre gjashtë ditësh lundrimi të lodhshëm. Nuk ia dimë emrin dragomanit grek që po e pret, por le ta quajmë Manuel; nga ana tjetër, dimë atë të tregtarit që e shoqëron, Giovanni di Francesco Maringhi,



Me komunikimin dykrahësh ura është dhe komunitet, një shumë e panumërt e hapave anonimë disiplinuar brenda një hedhjeje të vetme inxhinierike hapi mbi hon; kurse triumfi i individit vjen me aeroplanin, lart e më lart, rreth e qark, kurorë vetes në vetmi e monolog. Ura është horizontalitet, tejçon ndër kalimtarë hark pas harku përkuken ndaj një pushteti (qoftë ky dhe vetëm determinizmi gjeologjik), ndërsa avioni bëhet vetë pushteti, duke e marrë peng.

fiorentin i ngulitur mirë në Stamboll prej pesë vjetësh tashmë. Mallrat i përkasin atij. Ai është njeri i dashur, i lumtur që takon skulptorin e Davidit, këtij heroi të Republikës së Firences.”²

Michelangelo ka ardhur në qytetin e Turkut për të projektuar një urë mbi det, të cilën nuk do ta ndërtojë dot: një natë, shoqëruesi i tij në kryeqytet, poeti i njohur Mesihi i Prishtinës, i tërbuar nga xhelozia, vret me thikë një vajzë që është përvjedhur në dhomën e maestro-s. Bashkimi trupor midis italianit dhe vajzës myslimane nuk ndodh, prandaj mesa duket ura nuk mund të ndërtohet, në të kundërt të sa dimë për sakrificat: gjaku i vajzës nuk bën që ura të mbajë. “Folu për beteja, mbretër e elefantë”, kështu titullohet romani i Mathias Énard-it, në të cilin Michelangelo ka mundur, përkundër asaj që dimë, të vërë këmbë në Stamboll.

Ngushtica ndërkontinentale e Bosforit, parë nga sipër në hartë, sidomos në ndonjë hartë lirike të kohës, duket si ata dy gishtat që zgjaten drejt njëri-tjetrit pa u prekur kurrë, 500 vjet rresht mbi kokat e papëve, kardinalëve dhe vizitorëve të tjerë të Kapelës Sikstine, në afreskun më të njohur të Michelangelo-s: historia me mosndodhitë e pamundësitë e veta madhore duhet të ishte patjetër kjo që është, rëndom mbështjellë thjesht si dorashkë në dorë të gjeografisë.

Gati po në atë kohë kur mjeshtri pikturontesi më sipër “Krijimin e Adamit”, një bashkatdhetar i tij, mbetur anonim, rreshtonte në një afresk epik prej 8 000 vargësh një poemë në dialektin veneto-emilian për të kremtuar fitoret luftarake të sulltan Selimit I, duke profetizuar, po aty, se i biri, princi Sulejman, do të ishte perandori i ardhshëm mesianik i botës, ai që do të “rikthejë epokën e artë” (farà tornar la età de l’oro³) – kohë spekulimesh të forta apokaliptike kur



Arkitekti i gjithëdijshëm, fshehur përtej historisë në themele tempullore të urës, zëvendësohet nga unë dhe ti, nga piloti i buzëqeshur, që fsheh thjesht sytë pas syzesh dielli, në spirale valsi mes resh. Ura është kali, deveja, katërrotakët - po avioni është shpendi, pjesë e së njëjtës gjenealogjie lartësish me njeriun, “dykëmbëshin pa pupla” të Platonit, që tashmë mbërrin ta plotësojë qenien qiejve, pajisur me flatra metalike, mat tashmë fizikisht horizontet, kërkon t’i njësojë me dijen dhe dijen me fatin e vet, në fluturim e sipër. Njeriu pushon së qeni rënie, zbritje e frymës përthyer në baltë dhe bëhet gjysëmdrejtëz ngjitëse gazi e hareje.

sundimtarët osmanë me evokime të Aleksandrit të Madh, Romës a Dariusit, ashtu si ata europianë, mëtonin kurorën e Monarkut Universal, ardhja e të cilit do të sillte dhe ditët e fundit.⁴

Po në këto kohë Michelangelo-s i vinte dhe ftesa e dytë për në oborrin osman, shkruar nga një bankier e tregtar florentin, vendosur në Stamboll, ku i kërkohej të sillte shembujt më të mirë të pikturës së vet, a të ndonjë tjetri si vetja. Ftesa e parë kishte ardhur nga vetë sulltan Bajaziti II, me ndërmjetësinë e disa fretërve françeskanëve, me të cilën mjeshtrit i propozojë të projektonte urën mbi det, pavarësisht se bëhet fjalë vetëm për një që do lidhte thjesht dy brigje po europiane, në të quajturin Bri i Artë. Në një botë që përherë i ka pasur pritshmëritë e larta të përbashkohet (omnia sunt communia?), qoftë në perandori të arta finale universale, qoftë nëpër rima e vargje, ftesa bëhet se thërret për një urë përnjëmend ndërkontinentale, ku më në fund gishtat puqen mbi Bosfor.

Ngushtica e Bosforit, një funksion

sintaksor i domosdoshëm utopie e metafore në këtë anë të botës, funksion që, bazuar në palëvizshmërinë e brigjeve, do të mund të emërtohej lehtësisht, po të mos ndërlikohej shënjimi nën ujëra, me akumulimin e ëndërrimeve e dështimeve shekullore.

Duke vazhduar ndoshta traditën e atit, Mehmet Fatihut, me ftesat në oborr për artistë e artizanë italianë, thuhet se Bajaziti II nuk i ishte drejtuar vetëm Michelangelo-s për projektin e Birit të Artë. Nga këto orvatje cinquecentesche mbijeton një letër e viteve 1502 a 1503 drejtuar sulltanit, me gjasë nga Leonardo da Vinci, gjetur në Arkivat Shtetërore të Stambollit, dhe botuar po nga Franz Babinger më 1952:

“Unë, shërbëtori juaj, kam dëgjuar mbi qëllimin tuaj për të ndërtuar një urë nga Stambolli në Gallata, të cilën nuk e keni bërë dot pse nuk mund të gjendet askush i aftë ta projektojë. Unë, shërbëtori juaj, di sesi. Unë do ta ngreh atë në lartësinë e një ndërtese, në mënyrë që, për shkak të lartësisë së saj, askush të mos mundet

ta përshkojë dot. Por kam menduar t'i bëj një pengojcë, në mënyrë që ta bëj të mundshme nguljen e shtyllave mbajtëse, pasi të kem zhvendosur ujët. Do bëj që një anije të mund t'i kalojë përposh, me velat të hapura.”⁵

Një projektskicë elegante ure gati futuriste mbështetur mbi dy këmbë bishtdallëndyshe, përnën të cilës do të mund të kalonin anijet, ruajtur në fondin e Leonardos pranë Institutit të Francës, Paris, mendohet se i përgjigjet pikërisht përshkrimeve përkthyer turqisht në

rindërtimin e planit të saj si përkthim nga teksti në tekst, nga italishtja e supozuar e origjinalit të gjenit në osmanishten e kohës, pastaj me radhë në gjuhët e sotme, deri në këto rreshta. Sikur të mos homologohej me skicën e ruajtur në Paris, ura e fjalëzuar në Stamboll në më shumë se një rast duket absurde. Gjithë përkthimet përplasen e shkumojnë nëpër përjetime shtyllash, qeresteje e vidash, me kapacitetin inxhinierik që u jep kultura e humori i përkthyesit, tendosin fjalët e shpërthejnë a rrumbullakosin



Në këto kohë Michelangelo-s i vinte dhe ftesa e dytë për në oborrin osman, shkruar nga një bankier e tregtar fiorentin, vendosur në Stamboll, ku i kërkohej të sillte shembujt më të mirë të pikturës së vet, a të ndonjë tjetri si vetja. Ftesa e parë kishte ardhur nga vetë sulltan Bajaziti II, me ndërmjetësinë e disa fretërve françeskanëve, me të cilën mjeshtrit i propozojnë të projektonte urën mbi det, pavarësisht se bëhet fjalë vetëm për një që do lidhte thjesht dy brigje po europiane, në të quajturin Bri i Artë. **Në një botë që përherë i ka pasur pritshmëritë e larta të përbashkohet (omnia sunt communia?), qoftë në perandori të arta finale universale, qoftë nëpër rima e vargje, ftesa bëhet se thërret për një urë përnjëmend ndërkontinentale, ku më në fund gishtat puqen mbi Bosfor.**

letrën drejtuar sulltanit.⁶

Letra vazhdon dhe me një degëzim të papritur të projektit:

“Do të ndërtoj një urë lëvizëse, që të shpjerë, kur është nevoja, për në bregun e Anadollit”

Problemi madhor me projektin e mirëqenë të urës – në rastin ideal vështirë e realizueshme për kohën – është ngjashmëria e ndërtimit të saj me

fjalitë, përherë në më shumë se një gjuhë, në një lojë telefoni të prishur që fillon me një ekphrasis të frymëzuar të nuk ka rëndësi shumë se kujt, kalon si përmes shamanësh nëpër rutinë e tronditje dragomanësh diplomatikë, paleografësh, fjalorësh cinikë në ngushtim e zgjerim të pandalshëm, hapje e mbyllje gjer në shumëfishime e lëbyrje për të identifikuar kërcimin në horizonte minaresh të një ure,



“DEDALI, OSE MEKANIKA”, ANDREA PISANO, FIRENCE: 1348-1350

që ndër të tjera do të zbriste me çikrik nga bregu evropian, jo thjesht i Stambollit, deri në atë aziatik të Anadollit.

Ajo mundi të zbrisë në tokë vetëm në vitin 2001, Më e shkurtër, më e vonë dhe 1 500 milje më larg se sa parashikohej - shkruante "The Guardian" - "Mona Liza e Urave"⁷, përshtatur nga Administrata e Rugëve Publike të Norvegjisë si mbikalim për këmbësorë e biçikleta përmbi autostradën E-18, rreth 20 km në jugperëndim të Oslos.

Një spektakël ende më madhor me kapërcimin e detit i ofroi sulltanit të radhës dekada më pas edhe Hezarfen Ahmet Çelebiu, njeriu - siç tregon dhe llagapi - i 1000 (hezar) diturive (fen), i cili thuhet se ia arriti të ndërtojë një mekanizëm përforcuar me krahë shqiponjash, me të cilin fluturoi prej Kullës gjenoveze të Gallatës, deri përtej detit në Azi, pak kilometra më tutje, në shekullin e XVII.

Sipas Evlija Çelebiut (asnjë lidhje farefisnie e verifikuar), i cili është dhe i vetmi rrëfimtari mbi veprën e fluturuesit, sulltan Muradi IV e paska shpërblyer direkt Hezarfen Ahmetin me një qese flori, vetëm për të urdhëruar pastaj dhe internimin e tij, meqë, sipas tij, një njeri i tillë i frikshëm, që i vjen ndore ç'i vjen ndërmend, do mbajtur larg. Shpikësi e përfundoi jetën 31 vjeç syrgjyn në Algjeri⁸. Nëse i besojmë rrëfimit, ky qe fati i Hezarfen Ahmetit (për t'u mos ngatërruar me Hezarpare Ahmetin, kryevezirin e pak viteve më vonë, që llagapin e mori pasi e bënë 1000 copash rebelët, disa ditë para se të vrisnin dhe sulltan Ibrahimin); përballë Njëmijëdjëshit, sulltani pararendës i Ibrahimit fatkeq u mjaftua vetëm me një të vetme: me atë se dija është pushtet. Për ta mbyllur me një ton orientalist, ose ndoshta oksidentalit, kahja e fluturimit pionier Europë - Azi,

ekzekutuar në të kundërtën e akrepave të orës, si të thuash, duke i dalë kundër narrativës gjeopolitike të progresit jo vetëm teknologjik, anakronikisht, ia kishte përcaktuar dhe fatin Hezarfenit.

Po të duam t'u besojmë burimeve, disa shekuj më vonë, në vitin 1905, ishte radha e një shpikësi shqiptar për t'i prezantuar talentin sulltanit të radhës në Stamboll. Bëhet fjalë për një personazh që në shkrimet e kushtuara njihet edhe si "shqiptari që shpiku avionin e parë"⁹ apo "Leonardo da Vinçi shqiptar" (K. Sylejmani: 1975), Mulla Hasan Islam Masuricën, klerik nga Kosova.

Të dhënat e mëposhtme mbi takimin e Masuricës me sulltanin dhe çfarë e pasoi atë takim, janë nxjerrë nga artikulli i dr. Stavri Trakos, Si iu morën shpikësit shqiptar skicat e kallashit nga ambasadori i Rusisë në Bullgari.

Mulla Hasan Masurica, qysh prej vitit 1901 e deri në vitin 1905, konstruktioi pushkët me një, pesë dhe njëzet e pesë fishekë" dhe demonstroi funksionimin e tyre para sulltan Abdyl Hamidit në Stamboll. Kjo ngjarje ka pasur dëshmitarë okularë, të cilët ishin bashkëvendasit e Hasan Masuricës, Azem Saliu, Sherif Osmani dhe Osman Zahiri nga Sedllari, sot Komuna e Kamenicës, të cilët atë kohë ishin truproje personale të Sulltan Abdyl Hamidit. Ata, sipas dëshmimeve të bashkëkohësve, kanë treguar se si sulltani u impresionua nga kjo shpikje dhe planifikonte fillimin e konstruktimit të pushkëve në fabrika, por Masurica nisi të dyshojë se ndoshta armët shumëfishekëshe të tij pushteti do t'i përdorte më pas kundër shqiptarëve, prandaj vendosi ta fshehtë:

"Thuhet se ai i hodhi në Bosfor armët, por jo edhe skicat."¹⁰

Mbi urat e perealizuara të Leonardos, pendët e shqiponjave të Hezarfenit,

thellësive të Bosforit bien të penduar, ngadalë, kallashnikovët e ardhshëm shqiptarë. I maskuar si dervish, Masurica arratiset nga Stambolli për në Sofje të Bullgarisë”, ku dhe u burgos, e me atë rast, iu kapën skicat që kishte me vete.

“Ka shumë supozime se ku kanë përfunduar ato skica, kush i mori, psepërmendet Ambasadori i Rusisë në Bullgari e disa detale të tjera. Mbesim me shpresë që hulumtuesit shqiptarë do të mund të vërtetojnë në arkivat e Bullgarisë dhe të Turqisë ndonjëherë deri në imtësi për hulumtimet e inovatorit Hasan Masurica. Mund të supozohet që idetë për pushkët automatike ruse, kallshnikovët, mund ta kenë prejardhjen pikërisht nga pushka automatike me njëzet e pesë fishekë që Hasan Masurica e pat projektuar, shpikur dhe demonstruar para Sulltan Hamidit në Stamboll dhe ambasadorit rus në Sofje.”¹¹

Gjasat janë që gjithçka shkruhet për Masuricën, përfshirë dhe cilësimin si Da Vinçi shqiptar, të jetë bazuar vetëm në librin e gazetarit Kadrush Sylejmani, “Hasan Masurica, hoxhë e inovator”, Rilindja, Prishtinë, 1994. Në pamundësi të sigurimit të këtij libri, ngjarjen më kulmore të tij e gjejmë ta përcjellin në të njëjtën formë riprodhimet e shumta nëpër artikuj përkujtimorë mbi Masuricën.

“Në aeroplanin e ndërtuar me dërrasa plepi në kodrën e Zarbicës së pari e hipi djalin

e tij Muharremin dhe vet(ë) e kapi litarin me të cilin e kishte lidhur aeroplanin, dhe kur një erë e lehtë e mori atë, fluturakja nisi të lëvizë dhe vazhdimisht e rriste shpejtësinë. Pas pak ai filloi të ngritej bashkë me të dhe, edhe këmbët e Mulla Hasanit herë pas here nuk e preknin tokën. Mirëpo, në një moment ai padashtas e lëshon litarin dhe fluturakja bashkë me Muharremin fluturoi diku rreth 50 deri në 70 metra lartësi, duke përshkuar tërë fshatin e Zarbicës, duke kaluar një distancë prej rreth 4 apo 4 kilometra e gjysmë. Aeroplani u përplas në majat e lisave të ahut, në kodrat përtej fshatit Zarbicë, tek vendi i quajtur “Mulla



Gjasat janë që gjithçka shkruhet për Masuricën, përfshirë dhe cilësimin si Da Vinçi shqiptar, të jetë bazuar vetëm në librin e gazetarit Kadrush Sylejmani, “Hasan Masurica, hoxhë e inovator”, Rilindja, Prishtinë, 1994. Në pamundësi të sigurimit të këtij libri, ngjarjen më kulmore të tij e gjejmë ta përcjellin në të njëjtën formë riprodhimet e shumta nëpër artikuj përkujtimorë mbi Masuricën.

Rekë”, sipër fshatit Muhoc, dhe lëshoi një zhurmë të madhe. Për këtë tregon djali i Mulla Hasanit, Hamidi (i vetmi fëmijë që jeton nga të ll-të sa kishte Mulla Hasani), përndryshe veteran i arsimit. Tërë këtë ngjarje e përcollën shumë barinj, fshatarë zarbicas, të cilët ruanin bagëtinë apo ishin duke punuar në arat e tyre. Djali i tij Muharremi kishte thyer këmbën, por, sidoqoftë, duket të ishte piloti i parë në botë, ngase, sipas shënimeve, ky duhej të ishte fluturimi i parë në histori. Ky fluturim i aeroplanit të konstruktuar dhe ndërtuar nga Mulla Hasan Masurica ishte katër vjet para vëllezërve amerikanë Wilbur dhe Orvill Wright, të cilët kishin konstruktuar dhe me sukses kishin fluturuar me aeroplan më 17 dhjetor të vitit 1903.”

(Skena dhe gjithë pasazhi janë nxjerrë të plota nga artikulli i Islam Osmanit “Hasan Masurica, imami novator”, botuar në faqen 54 të numrit 301 të revistës “Hëna e Re” [tetor 2016, Dhul Hixhe 1437-Muharrem 1438, viti i XXIX i botimit], botim i Rijasetit të Bashkësisë Fetare Islame në Republikën e Maqedonisë.)

Mes kriterëve e kategorive për vlerësimin e klasifikimin e ngjarjeve e teksteve më sipër nuk është nevoja për asgjë më shumë sesa për kolektivitetin e pretenduar të dëshmimeve me emra të qartë e të njëpasnjëshëm dëshmitarësh okularë, bashkë me toponimet e vendbanimeve të tyre, apo për shumësinë e përcjelljeve të këtyre ngjarjeve e teksteve nëpër botime, për të mos folur për autoritetin e shtuar që bartin, duan-s’duan, ndonjëherë disa prej enteve botuese. Të gjithë e të gjitha insistojnë bashkërisht të ripronësojnë emra e terma, si hoxhë, imam e mulla, hasan e hysen, duke ua shkukur për dore, nga poshtë, elitave që i kanë shqiptuar dekada me rradhë në nota të tëhuajsisë dhe errësirës, sundimit të huaj dhe padijes, perandorakes provinciale, okupatorit osman ose obskurantizmit oriental. Një mulla, mulla shpikës i aeroplanit, ç’ka më përtej kësaj? Fjalët fërkohen! Një hoxhë çarmatos sulltanin, refuzon privilegjet prej tij e kthehet i maskuar në atdhe, njëlloj si kush? Fjalori në flakë!

Provat e patriotizmit e, aq më shumë, të shpikjeve të Masuricës nuk kanë mbetur askund tjetër përveçse projektuar në



Në këtë personazh gjejmë akoma më të forta gjithë karakteristikat e Masuricës. Sipas gazetarit Engjëll Seriani “atdhetari dhe shpikësi Dino Sako Çiço ishte fëmija i dytë ndër 5 fëmijët e Sakos. Ai lindi në 26 gusht të vitit 1863 dhe u nda nga jeta në moshën 77-vjeçare në 31 mars të vitit 1939, duke përjetuar dhe marrë pjesë drejtpërsëdrejti në disa prej ngjarjeve më të shënuara të historisë kombëtare, si: Lidhja Shqiptare e Prizrenit, kryengritjet antio-smane, pavarësia e Shqipërisë” nga Perandoria Osmane, Lufta e Parë Botërore, Lufta e Vlorës, ngritja e shtetit dhe monarkisë shqiptare, etj.”

emra dëshmitarë fshatarësh e fshatrash anonimë edhe, përtej individualitetit të tyre, në një regjistër të ulët kakofonie “turqisht e serbisht”; me Masuricën e bashkëfshatarët e tij ata përfshihen në konspiracionin nacionalist të mbytyjes së pushkëve në Bosforin e largët; mrekullinë fetare të kalimit befas në modernitetin, zbritur me të huajin nga qyteti, fshatarët e zhveshin nga traumat dhe inferioriteti përmes ngjitjes në qiell të fluturakes autoktone, aeroplanit prej druri plepi të hoxhë Masuricës, njërit prej nesh, në vendin e quajtur Mulla Rekë.

Po ky nuk është as i fundit aeroplan, as dhe i fundmi syresh prej druri, me të cilin shqiptarët do ta rivalizojnë modernitetin.

Prova e aeroplanit të Dino Çiços

Nën titullin e mësipërm gazetari Thanas Dino ka botuar një dëshmi mbi një ngjarje të fillimeve të shekullit të XX, vjelë në shkurt të vitit 2008 nga Asaf Selfo, një bashkëqytetar gjirokastrit rreth të tetëdhjetave:

“Prova e aeroplanit të tij u bë te hani i Çiços, kthesa e Viroit, te Hauri i Çiçajve; aeroplani fluturoi 10-15 metra në ajër e ra; motori është në muze.”¹²

Në këtë personazh gjejmë akoma më të forta gjithë karakteristikat e Masuricës. Sipas gazetarit Engjëll Seriani “atdhetari dhe shpikësi Dino Sako Çiço ishte fëmija i dytë ndër 5 fëmijët e Sakos. Ai lindi në 26 gusht të vitit 1863 dhe u nda nga jeta në moshën 77-vjeçare në 31 mars të vitit 1939, duke përfjetuar dhe marrë pjesë drejtpërsëdrejti në disa prej ngjarjeve më të shënuara të historisë kombëtare, si: Lidhja Shqiptare e Prizrenit, kryengritjet antiosmane, pavarësia e Shqipërisë nga Perandoria Osmane, Lufta e Parë Botërore, Lufta e Vlorës, ngritja e shtetit dhe monarkisë shqiptare, etj.”¹³

DEVRI DAIM

Nëse moderniteti është themeluar mbi thyerjen përfundimtare të autoritetit të të parëve (paraardhës a parí) thyerjen do të mund ta kishim grumbulluar tek ajo e figurës papale (pontifex) të urës si trupëzim bashkues i “andej” me “këtu”, “atëherë” me “tani” dhe zëvendësimit të kësaj qendërsie mitoteknologjike me avionin.

Ashtu si me urën, edhe me avionin kapërcejmë ajër, vetëm se shumë më lart, shumë më shpejt, shumë më larg, me kah e cak të pakushtëzuar, si të hipur mbi ide. Dallimi cilësor mes dy veglave tenton të bëhet gati si ai mes vendit e kohës, zakonet e frymëzimit, shkronjës e shpirtit, ligjit e lirisë, deri dhe mes gjësë e asgjësë: ura është vend përmbi kohë, avioni e kundërta, shfronësim i plotë i vendit, një “tanikëtu” në mbarim e sipër, pa kujtesën dhe autoritetin që ngurtëson ura vazhdimisht mbi ajër.

Me komunikimin dykrahësh ura është dhe komunitet, një shumë e panumërt e hapave anonimë disiplinuar brenda një hedhjeje të vetme inxhinierike hapi mbi hon; kurse triumfi i individit vjen me aeroplanin, lart e më lart, rreth e qark, kurorë vetes në vetmi e monolog. Ura është horizontalitet, tejçon ndër kalimtarë hark pas harku përkuljen ndaj një pushteti (qoftë ky dhe vetëm determinizmi gjeologjik), ndërsa avioni bëhet vetë pushteti, duke e marrë peng. Arkitekti i gjithëdijshëm, fshehur përtej historisë në themele tempullore të urës, zëvendësohet nga unë dhe ti, nga piloti i buzëqeshur, që fsheh thjesht sytë pas syzesh dielli, në spirale valsi mes resh. Ura është kali, deveja, katërrotakët - po avioni është shpendi, pjesë e së njëjtës gjenealogjie lartësish me njeriun,

FLUTURIM

“dykëmbëshin pa pupla” të Platonit, që tashmë mbërrin ta plotësojë qenien qiejve, pajisur me flatra metalike, mat tashmë fizikisht horizontet, kërkon t’i njësojë me dijen dhe dijen me fatin e vet, në fluturim e sipër. Njeriu pushon së qeni rënie, zbritje e frymës përthyer në baltë dhe bëhet gjysëmdrejtëz ngjitëse gazi e hareje.

Por, megjithë atë premtimin e çlirimit nga kondita kalbëzuese përdhese, edhe aeroplani bart vdekje në bark, sado të ngjitet lart, aq më fort tërhiqet poshtë në vendin e krimit nga karburanti ose nga mungesa e tij, nga vetë kjo lëndë molepsëse e jashtëqitur prej errësie që ia instalon aeroplanit në bark nëntokën, aty ku dhemb më shumë, në kupë të qiellit, mu aty avioni zhvendos me kremator varre kolektive të gjësë së gjallë, alga, pyje e mamuthë që digjen që nga mijëvjeçarët e shkuar – krahaso pak me kurbanin unikal, kremtuar klinikisht vetëm një herë e mirë në këmbë të urës.

* * *

Rubrika gjuhësore. Zotërinjtë shkatërrimtarë të gjuhës po e tepërojnë guximin e tyre! (P) o përdorin fjalën e huaj “avion” në vend të fjalës së bukur shqipe “ajror”. Lista e të vrarëve nga bombardimet e fundit: L. Tashi, L. Kadareja, M. Xhiku, K. Dhrami, E.¹⁴

Aeroplani i vërtetë është jo vetëm ai që përthithet direkt me gjuhën e nënës, por dhe është i puthitur me idealin e

vet të lehtësisë e shpejtësisë e kudondodhjes – zbratur nga lënda dhe shkrirë tejdukshëm në cilësinë e ajrit. Ajrori është ai aeroplan të cilit i hipet thjesht duke mbyllur sytë përballë një puhize, ajrori nuk punon me djegie të brendshme. Imazhi metonimik ka mbijetuar vetëm negativisht përmes emërtimeve “bateri kundërajrore”, “strehim kundërajror”, fjalë kanibale që janë krijuar pasi kanë vrarë e ngrënë ajrorin.

Copëza më lart është shkëputur nga romani “Kronikë në gur” i Ismail Kadaresë; më specifikisht rubrika gjuhësore, me zinë për ajrorin vendas, ndjekur pa tranzicion nga lista e viktimave të aeroplanit të huaj është pjesë “Nga kronika” atribuar personazhit Xivo Gavo, “faqet e grisura” të së cilës, me fjalë e fjali të këputura si në décollage afishesh e komunikatash ngjitur nëpër dyer, shërbejnë për hapjen e kapitujve. Teksti ritmohet me këto faqe dëshmish nga përditshmëria e bëmave dhe të thënave të qytetit regjistruar nga një kronikan i dorës së vjetër (gavo në të folmen girokastrite u thonë me shpoti syve), që i rri kështu qytetit si një lloj vështrimi nga lart, klasifikues, historizues e zyrtarizues i ngjarjeve poshtë, ku i bën kontrast me optikën kaleidoskopike rrëfimtari-fëmijë.

Avion në vend të ajror: rubrika gjuhësore “Nga kronika” pasqyron besnikërisht shqetësimet e përhershme të



Avion në vend të ajror: rubrika gjuhësore “Nga kronika” pasqyron besnikërisht shqetësimet e përhershme të shqipërimin përherë të mangut në kulturën tonë, me shkëputjen militante nga orientalizmat, gjithë duke përbulluar dyndjen e objekteve, makinave, sjelljeve, institucioneve e koncepteve hyrë ortek me modernizmin, emigrimet e pushtimet e reja: një luftë e pabarabartë në dy fronte, për të fshehur në bodrume fjalët vjetëruese, objektet e konceptet kryeneçe dalë mode a funksioni, për t’u hapur kështu vend të rejave triumfuese, shpesh për t’u fshehur pas tyre, gjithë duke u përpjekur me të huajën e të pakuptueshmen tek e reja; me përkthimin e poetikën që prekin dhe vetë objektet e sidomos konceptet e sapoardhura për t’i përshtatur e përvetësuar.

shqipërimin përherë të mangut në kulturën tonë, me shkëputjen militante nga orientalizmat, gjithë duke përbulluar dyndjen e objekteve, makinave, sjelljeve, institucioneve e koncepteve hyrë ortek me modernizmin, emigrimet e pushtimet e reja: një luftë e pabarabartë në dy fronte, për të fshehur në bodrume fjalët vjetëruese, objektet e konceptet kryeneçe dalë mode a funksioni, për t’u hapur kështu vend të rejave triumfuese, shpesh për t’u fshehur pas tyre, gjithë duke u përpjekur me të huajën e të pakuptueshmen tek e reja; me përkthimin e poetikën që prekin dhe vetë objektet e sidomos konceptet e sapoardhura për t’i përshtatur e përvetësuar. (Si ndonjë parodi të gjithë tensionit të papërkthyesëm me të huajën, kronika e Gavos regjistron lajmin për vizitën në qytetin e pushtuar

të sekretarit të partisë fashiste Ettore Muti, dhe pak faqe më tej, në kapitullin e tretë të romanit, personazhet që shqetësohen nga lajmet se burra e gra do t’i detyrojnë “të dalin udhëve me flamurë e muzikë duke thirrur ‘rroftë muti!’”¹⁵

Ajror në vend të avion: në një cep të qytetit një njeri punon gjithë natën mbi skica e makete:

“Mësuesi Qani Kekezi kishte thënë disa herë se nga therja e një maceje përfitonte më shumë se nga leximi i krejt librave të anatomisë. Dino Çiçua nuk merrej me gjëra të tilla. Kur në këmbët e qytetit filloi ndërtimi i aeroportit, ai braktisi përkohësisht punën e tij dhe u dha pas një shpikjeje të re. Ai filloi përpjekjet për të ndërtuar një aeroplan. Ky do të ishte një aeroplan i jashtëzakonshëm. Ai nuk do të punonte me benzinë,

por me “perpetuum mobile”. Emrin e kësaj të fundit çdo njeri e shqiptonte ndryshe nga tjetri dhe disa herë çështja e shqiptimit të saj ishte bërë shkak ngrindjesh, madje edhe goditjesh në turinj dhe thyerjesh të ndonjë dhëmbi, pas së cilës shqiptimi ndryshonte edhe më fort. Me fillimin e bombardimeve bisedat për shpikjen e re të Dino Çiços, shpikje që jo vetëm do ta mbronte, por edhe do ta nderonte emrin e qytetit, po bëheshin gjithmonë” e më të shpeshta, sidomos midis plakave dhe fëmijëve.”¹⁶

Aeroplani i mirë, i zbutur në formatin “plakave dhe fëmijëve”, që Dino Çiço ndërton nën bombardime, nuk do të punojë me benzinë, por me gjuhë! Perpetuum mobile (vini re vrullin e dy “u”-ve) është vetëm një tjetër fjalë e huaj magjike! Abrakadabra! Forma që avioni gatit për qiejt ndryshon, shqiptim pas shqiptimi, nëpër popull, dhëmb pas dhëmbi të thyer. Rrëfimtari-fëmijë përpiqet të përfytyrojë, për shembull, “ç’rrëmujë do të ndodhte në qiell atëherë kur të ngrihej për herë të parë aeroplani me ‘perpetuum mobile’ i Dino Çiços. I zi e i frikshëm me një formë të jashtëzakonshme (...). Atëherë gjithë aeroplanët e tjerë që në atë kohë mund të ndodheshin rastësisht në qiell do t’ia mbathnin nga sytë këmbët. (...) Fluturoni dhe ca, aeroplanë të mjerë me benzinë”.

Dhe vetëm pas pak, gjithë format e papritura të aeroplanit zbresin nga qielli, sapo rrëfimtari-fëmijë shkon për një vizitë ceremoniale në shtëpinë e shpikësit me gjyshen.

“Kur hymë në dhomën e madhe, në fillim nuk vura re asgjë, sepse u fsheha pas rrobës së gjyshes. Pastaj nxora njërin sy dhe pashë disa plaka, të veshura me të zeza si gjyshja, që rrinin nëpër shiltetë e shtruara mbi mindere. Aeroplani ishte në mes të dhomës. I madh sa një njeri,

me krahë të hapur dhe krejt i bardhë. I bardhë. Krahët, bishtin dhe gjithë pjesët i kishte prej druri”¹⁷.

Femëror e i dorëzuar krahëhapur përballë hekurishteve armike që derdhin zjarr mbi qytet, aeroplani i drunjtë, shtëpiak, dy herë i bardhë, në mes të dhomës si xhenaze a lehonë, qarkuar ritualisht me plaka veshur me të zeza. “Gjyshe Selfixhe, Xhexho, hallë Xhemo, nënëmadhe, Kako Pino... Ato s’janë më” – thotë rrëfimtari në faqen e fundit, si t’ua kushtonte atyre romanin. Ato janë Gjirokastra e vjetër, bota që nuk është më. Fëmija, si në një shumicë skenash të romanit, edhe në “qokën e aeroplanit” është i rrethuar nga personazhi kolektiv i një si kori femëror, kryesisht të moshuar, ku veç të përmendurave me emër janë dhe katënxhikat apo plakat e jetës, mbiqindvjeçare; të gjitha gra të vjetra, banore të qytetit të brendshëm shekullor, që me fjalë, pasthirrma e grimasa shërbejnë si nënvizues konstant i habitës e tronditjes përballë modernitetit mashkullor, makinerik e marcial, ku nuk bën pjesë ende mirë fëmija-rrëfimtari.

DINO ÇIÇO:

Për sa interesant është detaji, dhoma në fjalë ka qenë dhe teatër ngjarjesh të tjera simbolike në historinë e Shqipërisë drejt progresit.

“Në dhomën ku (Dino Çiço shën. im.) jepte e merrte me avionin e tij perpetuum mobile, më 1990 ose ndoshta janar 1991 u formua dega e Partisë Demokratike për Gjirokastrën. Energi që jep e merr, por edhe mblidhet e kontrollohet në këto çati të mëdha sa një arë e mbuluar me rrasa¹⁸. Mbetjet nga motori i këtij aeroplani, me përcjellësat e dhëmbëzuar prej druri ku do të prodhohej lëvizja e pafundme, perpetuum mobile, mund të vizitohen, përplasur pa dhimbje përdhe, pa asnjë mbrojtje nga pluhuri ose prekjia, në mes

të një korridorit të muzeut të kalasë së Gjirokastrës, siç mund të vërtetohet lirisht prej arkivave filmike në internet. Pavarësisht se për këtë shëmti nuk ka ndonjë justifikim, nuk dihet nëse braktisja e parë përdhe e aeroplanit ka ndodhur ose jo prej vetë autorit të tij, pasi, sipas dëshmvive: “(m)eqë aeroplani ishte shpikur, Dino Çiçua i Vjetër (...) nisi një drejtim tjetër, të krijonte lëvizjen e përhershme; më 1876-ën Akademia Fraceze kishte zyrtarizuar se nga asgjëja nuk lind gjë, po ai donte të provonte se asgjëja krijohet diçka e ndoshta gjithçka; duke u eliminuar fërkimi, lëvizja bëhet e përhershme, gjykonte e llogariste. Kishte mbaruar Akademinë Ushtarake për artileri në Edrene dhe dinte nga aerodinamika. Dino Çiçua qe dënuar tri herë me vdekje nga Sulltani dhe tri herë qe falur.¹⁹

Problemet e fërkimit gati-politik mes përkthimeve vertikale, zbritëse nga gjuha në gjuhë të termave të modernitetit, posaçërisht tekniko-shkencor që shihen në vazhdë të këtij teksti, nga avion në ajror apo fluturake, në fillimet e përbaljes së aviacionit me gjuhën shqipe kanë përfshirë dhe formën “osmanishte” tajare²⁰ (fjalë për fjalë: fluturuese) (e mbijetuar edhe sot si eufemizëm për prapanicën, nga një kalim kinse-metonimik prej shprehjes tallëse “është ftohur në tajare” – një lloj statusi ose ftohme e ironizuar që kapte pasagjerët e privilegjuar të aeroplanëve të hapur të kohës). I njëjti problem haset edhe termin perpetuum mobile në çështjen e Dino Çiços. Me një term po “osmanisht” e njeh perpetuum mobile-n e Dinot në kujtimet e tij edhe gazetari e veprimtari politik Zoi Xoxe, edhe ai vizitor i dhomës së përfolur, e cila ishte kthyer si duket në një lloj pike turistike për Gjirokastrën e kohës.

“Më shpunë të vizitoj qytetin: kalanë, disa shtëpira të vjetra karakteristike të Gjirokastrës. Më shpunë në Mashkulloren e Çerçizit dhe nuk munguan të më shpinin edhe në shtëpinë e Dino Çiços, që e quante veten shpikës të devri dajmit ose të lëvizjes së përhershme (perpetuum mobile). Në një dhomë ai kishte shpërndarë dhe përhapur disa rrota, disa boshte, disa çikrikë dhe dha e mori që të ma mbushte mendjen që kështu e ashtu do të kishim devri dajmin. Kur dolëm, u thashë shokëve se nuk kisha kuptuar asgjë nga shpjegimet e Dino Çiços, vetëm se po orvatej të përmbyste ligjin e Lavuazierit; por Vangjel Koça m’u përgjegj me ironi, se gjenitë nuk është lehtë të kuptohen”²¹.

Dino Çiço me perpetuum mobile-n apo devri dajmi-n e tij nuk mund të mos kishte gjetur vend edhe në librat me kujtime të Enver Hoxhës, të cilat shihet se janë në një dialog ndoshta rivaliteti me “Kronikë në gur”. (“Kam edhe unë nja njëqind e ca faqe shënime për Gjirokastrën. Ta dija që po bëje një roman, mund të t’i jepja t’i shfrytëzoje”²², – dëshmon Kadareja t’i ketë thënë në një takim diktatori, ish-fqinj i tij i Sokakut të të Marrëve. Sipas shkrimtares Helena Kadare, e pranishme në këtë takim të vitit 1971, Enveri (f)liste



Aeroplani ishte në mes të dhomës. I madh sa një njeri, me krahë të hapur dhe krejt i bardhë. I bardhë. Krahët, bishtin dhe gjithë pjesët i kishte prej druri.”

bukur, me një figuracion të pasur e të saktë, karakteristikë kjo e gjirokastritëve, që e kisha njohur nga hallat e mia fjalëshuma, e sidomos nga fisi i Kadarenjve më pas. E. Hoxha kishte po atë kolorit të pasur kur tregonte kujtime nga Gjirokastra, si për shembull, futjen për herë të parë të llambave me vajguri për ndriçimin e shtëpive etj.²³)

Duke përshkruar daljen nga Gjirokastra, rrugës për në Korçë, ku do të fillojë studimet në liceun francez, Enveri sikur kërkon të tregojë se një kapërcim i madh po ndodh në jetën e tij, teksa pret t'i afrohet Parisit të Vogël:

“(M)ulliri i Dino Çiços. Ky mulli ishte kufiri deri ku ne, të rinjtë, ecnim me këmbë; Dino Çiçoja ishte ‘fundi i dynjasë’.

Ai ishte për ne një njeri misterioz, i marrë apo i ditur, pse flitej që mbyllej në odë dhe diçka bënte. Ky njeri pa shkollë mundahej të shpikte një makinë, që «do të lëvizte pa u ndalur kurrë». Këtë makinë ai dhe njerëzit e tij e quanin «Devri daim». (Nga turqishtja, ekuivalente e

shprehjes latine *perpetuum mobile*. Në rastin konkret me kuptimin: makinë në lëvizje të përhershme, që ecën në tokë, fluturon në ajër, lundron në det, etj.) Kjo ‘e famshme’ makinë, të cilën e bënte vetëm me dru që e gdhendte vetë me një biçak prej çobani, që ‘të punonte, të fluturonte, apo të notonte’, sipas tij, nuk kishte nevojë as për ajër, as për benzinë, as për naftë! Dinoja rrinte në lagjen Hazmurat, atë e shihnim rrallë të dilte, vishej me poture të zeza, me qylaf të bardhë dhe me shark të bardhë.

- Mirëmëngjesi, xha Dino, - i thoshim ne, nxënësit, kur e takonim në rrugë, - kur do ta nxjerrësh ‘Devri daimin’?

Ai na përgjigjej:

- Durim, mor djem, pa do ta shihni.

Po ‘Devri daimin’ ne s’e pamë kurrë, megjithëse edhe në Vjenë e shpunë Dino Çiçon. Ai shkoi vetë atje i shoqëruar me ‘të famshmin’ Xhevat Kallajxhinë (Hundashin), po u kthyen andej pa zhurmë, pse ‘shpikja’ e tij nuk ishte veçse një mekanizëm i thjeshtë sahati prej

- 1 Adnan Abrashi, Fati përmes filxhanit të kafesë, Shoqata për krijimin e njeriut të ri “Vegimi mistik”, Prizren, 2003, f. 9
- 2 Mathias Énard, Parle-leur de batailles, de rois et d’éléphants, Actes Sud, 2010, f. 11
- 3 Gülru Necipoğlu, Visual Cosmopolitanism and Creative Translation: Artistic Conversations with Renaissance Italy in Mehmed II’s Constantinople, në Muqarnas, An Annual on the Visual Cultures of the Islamic World, vol. 29, Brill, 2012, f. 49
- 4 Walter G. Andrews, Suppressed Renaissance: Q: When Is a Renaissance Not a Renaissance? A: When It Is the Ottoman Renaissance! në Other Renaissances: A New Approach to World Literature (red. Brenda Deen Schildgen, Gang Zhou, Sander L. Gilman), Palgrave, 2006, f. 27-28
- 5 Leonardo, Carlo Pedretti, The Literary Works of Leonardo Da Vinci, Vol. II University of California Press, 1977, f. 213
- 6 Bulent Atalay, Leonardo’s bridge: Part 2. “A Bridge for the Sultan”, 22. 01. 2013 <https://blog.nationalgeographic.org/2013/01/22/leonardos-bridge-part-2-a-bridge-for-the-sultan/>
- 7 Doug Mellgren, Da Vinci comes to life 500 years on, 01. 11. 2001 <https://www.theguardian.com/world/2001/nov/01/engineering.internationaleducationnews>
- 8 TDV Islâm Ansiklopedisi, vol. 17, Stamboll, 1998, f. 297
- 9 Merita McCormack (Bajraktari), Shqiptari që shpiku avionin e parë, Tirana Observer, 23.02.2006, f. 43,
- 10 Dr. Stavri Trako, Si iu morën shpikësit shqiptar skicat e kallashit nga ambasadori i Rusisë në Bullgari, Gazeta Nacional, 27.04.2014, f. 9

druri.”²⁴

Shihet se megjithë përmendjet e shumta në shtypin e kujtimet e kohës, vizitat në kryeqytetet e akademitë e Europës, letrat e fisnikërimit Dino Çiços ia ka dhënë Kadare në Kronikën e tij, duke e futur pa kthim në histori. Te Kronika, vepra ëndërrore e Dinos ka mundur dhe po mundet ta zhvillojë lëvizjen e pafundme, veprën e imitimit të përjetësisë, çlëndëzimit, ngritjes e rikthimit drejt Fjalës së Krijimit, duke vazhduar të zhvillohet e përsoset e korrigjohet, nga devri daimi në perpetuum mobile. Për ta mbyllur duke modifikuar shqip një fjali të famshme rusisht në historinë e letërsisë: ne të gjithë kemi dalë nga aeroplani i Dinos – po aeroplani vetë ka dalë po aq nga pardsesja e Kadaresë sa dhe nga fustanella e Dinos.

Sepse Dino qe burrë me fustanellë.

Për aq sa rëndësi ka për historikun e fillimeve të fluturimit shqip, na duhet të përmendim dhe një detaj piktoresk nga njëra prej burgosjeve të atdhetarit-

shpikës.

“Nëna e Dinos mundi të futë brenda burgut bashkë me ushqimet edhe disa sende për të lehtësuar arratisjen nga burgu, një litar dhe një sharrë për të prerë hekurat e dritares së qelisë”. Sipas rrëfimitarit kënga popullore e përjetëson kështu dënimin pa faj të Dino Çiços: ‘Dino Çiço more djalë/S’ta bënë mirë davanë/Duhet hedhur Rakip Çanë/Jakup Bimbash budallanë/... Dinos i shkoi litari/Në këmbë ra kapedani’.

Dy vargjet e fundit të këngës kanë lidhje me incidentin që u ndodhi katër të burgosurve në momentin e arratisjes. “I pari zbriti me litar Kanan Hirua, i dyti Bejo Kërma, i treti Ali Delua, një mik i vjetër i Dinos nga Kallarati i Vlorës dhe i fundit u lëshua vetë Dinoja. Litari u këput dhe Dino u rrëzua në tokë përfund mureve të kalasë.

Vetëm hapja si parashutë në ajër e fustanellës me ‘100 kute’ e shpëtoi atë nga vdekja.”²⁵

Stamboll-Firenze, prill 2018 ■

11 Idem

12 Thanas Dino, Brumi, f.208

13 Engjëll Serjani, Dino Çiço i gjallë, rrëfen Dino Çiçon e Parë, Gazeta Shqip, 13.10.2014, f.20<http://gazeta-shqip.com/lajme/2014/10/13/dino-cico-gjalle-rrefen-dino-cicon-e-pare/>

14 Ismail Kadare, Kronikë në gur, Tiranë: 1971, f.102

15 Kronikë, f.30

16 Kronikë, f.93

17 Kronikë, f. 96

18 Thanas Dino, Brumi prej guri, (Argjiro: 2009), f. 95-96

19 Brumi, f. 95-96

20 Tahir N. Dizdari, Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam (AIITC), 2005, f. 895

21 Dr. Zoi Xoxa, Kujtimet e një gazetari, Gazeta 55, nr. 91 (4156), 05. 03. 2010, f. 23-24

22 Ismail Kadare: Biseda me Enverin për “Dimrin e Madh”, 23. 09.2012

<http://www.balkanweb.com/kryesore/1/ismail-kadare-biseda-me-enverin-per-dimrin-e-madh-103596.html>

23 Helena Kadare, Kohë e pamjaftueshme, Onufri, 2011, f.286.

24 Enver Hoxha, Vite të rinisë: kujtime, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, 1988, f.24

25 Engjëll Serjani, Dino Çiço i gjallë, rrëfen Dino Çiçon e Parë, Gazeta Shqip, 13.10.2014, f.20<http://gazeta-shqip.com/lajme/2014/10/13/dino-cico-gjalle-rrefen-dino-cicon-e-pare/>

ARTI



DHE

TEKNOLOGJIA

HISTORIA E NJË
BASHKUDHËTIMI JO AQ PAQËSOR

Në përditshmërinë që sa vjen edhe bëhet më e varur prej teknologjisë, arti përpriqet t'i kujtojë njeriut se, në dallim nga roboti dhe sendi teknologjik, njeriu është një krijesë hyjnore që mendon, ndjen, trishtohet apo gëzohet. **Në vend të vetmisë digjitale, arti e grish njeriun drejt vetmisë së meditimit mbi vepra dhe fenomene artistike.**



ARMAND BORA

EDI QË KA NJË SHPREHJE E CILA THOTË SE “TË GABOSH ËSHTË NJERËZORE”, por një gabim njerëzor nuk është asgjë përpara asaj se çfarë do të ndodhte pas gabimit të një kompjuteri.”, shkruan shkrimtarja angleze Agatha Christie në një rën prej novelave të saj. Pavarësisht lehtësimit dhe cilësisë më të lartë në disa shërbime që zhvillimi teknologjik i ka sjellë njerëzimit, nuk janë të pakta zërat, madje edhe personalitete nga fusha e shkencës, të cilët i tremben prirjes për të përdorur teknologjinë gati në çdo sferë të veprimtarisë njerëzore.

Në librin “Fuqia e kompjuterit dhe arsyeja njerëzore: nga gjykimi të kalkulimi”, programuesi amerikan Joseph Weizenbaum ka shfaqur gjithë kritikën e tij ndaj mënyrës se si shoqëria po e përdor fuqinë e teknologjisë apo të asaj që është quajtur “inteligjenca artificiale”. Edhe ndaj idesë që robotët të përdoren për të ofruar shërbimeve shëndetësore për njerëzit në nevojë, Weizenbaum ka mbajtur një qëndrim kritik. “Nëse makinat do të zënë vendin e njeriut, ne do ta gjejmë veten të tjetërsuar, të zhvleftësuar dhe të frustruar. Inteligjenca artificiale, nëse përdoret në këtë mënyrë, paraqet një kërcënim për dinjitetin njerëzor”. Weizenbaum shpjegon se fakti që po mendojmë mundësinë e përdorimit të makinave dhe robotëve në disa shërbime, tregon se shoqëria është duke përjetuar një “atrofi të shpirtit njerëzor, e cila vjen nga të konsideruarit e vetes si kompjuter”.

Megjithëse nuk kanë munguar zërat e shqetësuar për rolin që teknika po zë në jetën e njeriut, shoqëria njerëzore vazhdon t'i dorëzojë teknologjisë, veçanërisht dekadave të fundit, një numër jo të vogël të aktiviteteve të saj. Një pjesë e rëndësishme e infrastrukturës së shërbimeve dhe prodhimit, duke filluar nga nevojat bazë e deri te kërkesat dhe shërbimet e luksit, po kalojnë nga dora njerëzore te dora robotike. “Jemi duke ndër-tuar një qytetërim në të cilin elementet më thelbësore të tij varen shumë nga shkenca dhe teknologjia”, shkruan Carl Sagan,

NDIKIMI

Tradicionalisht, arti dhe shkenca janë parë dhe trajtuar si dy disiplina të ndara nga njëra-tjetra, por, kur ka ndodhur që janë studiuar së bashku, është parë qartazi ndikimi që ato kanë te njëra-tjetra. Prodhuesi amerikan i filmave të animuar, John Laseter, dy herë fitues i Academy Word, ka bërë një përcaktim interesant për marrëdhënien midis teknologjisë dhe artit. “Arti, - thotë ai - e sfidon teknologjinë, ndërsa teknologjia e frymëzon artin.” Në këtë kuptim, të përpiqesh të ndash teknologjinë nga arti, apo t’i shpallësh ato të kundërta nuk është rruga e duhur për të kuptuar dhe zgjidhur problemet që ka sjellë sot teprimi në përdorimin e teknologjisë.

një astronom amerikan, kozmologjist, astrofizikant, astrobiologjist, kërkues i rëndësishëm në fushën e shkencës.

Mendimet e kundërta mbi atë nëse teknologjia e përmirëson gjendjen njerëzore, apo e përkeqëson atë e kanë drejtuar debatin edhe në fushën e filozofisë. Teori dhe lëvizje pro dhe kundër janë zhvilluar duke prodhuar mendim filozofik. Neoludizmi, anarho-primitivizmi dhe lëvizje të ngjashme kritikojnë përhapjen e teknologjisë, duke argumentuar se kjo dëmton mjedisin dhe i largon njerëzit; nga ana tjetër, përkrahësit e ideologjive, të tilla si transhumanizmi dhe techno-progresivizmi, e shohin përparimin e vazhdueshëm teknologjik si të dobishëm për shoqërinë dhe gjendjen njerëzore.

Ndërkohë që Jean-Michel Jarre, kompozitori francez që njihet si krijuesi i muzikës elektronike, mendon se “Teknologjia është neutrale dhe gjithçka varet nga mënyra se si e përdor atë.” Në mungesë të marrëveshjes e cila do të rregullonte masën e përdorimit të teknologjisë, ka ndodhur ajo që sot të kemi vetëm një rritje të prevalencës së saj.

Në klimën e krijuar prej bumit teknologjik dhe prirjes për të shkuar drejt një jete me shërbime dhe aktivitete të bazuara

mbi shpikjet e shkencës, e vetmja hapësirë ndryshe, e cila përpiqet t’i përballet robotizimit të jetës njerëzore, duket se ka mbetur hapësira e krijuar nga aktiviteti në fushën e artit.

Në përditshmërinë që sa vjen edhe bëhet më e varur prej teknologjisë, arti përpiqet t’i kujtojë njeriut se, në dallim nga roboti dhe sendi teknologjik, njeriu është një krijesë hyjnore që mendon, ndjen, trishtohet apo gëzohet. Në vend të vetmisë digjitale, arti e grish njeriun drejt vetmisë së meditimit mbi vepra dhe fenomene artistike. Në vend të gjuhës së thatë në një komunikimi i cili sa vjen edhe bëhet i ngjashëm me gjuhën algometrisë kompjuterike, arti të kujton gjuhën e figurshme të poezisë, të tingujve apo të ngjyrave. Edhe pse duken të vendosura në pozicione të kundërta, me synime dhe qëllime të ndryshme sa i përket asaj çfarë i ofrojnë shoqërisë, problemi nuk është i krijuar midis artit dhe teknologjisë. Përkundrazi, edhe pse duket sikur asgjë nuk i bashkon, arti dhe teknologjia kanë një histori të përbashkët dhe të hershembashkëjetese, e cila kuptohet dhe bëhet e qartë prej momentit që nis të bësh shpjegimin etimologjik të termave.

Në Greqinë e vjetër, në kohën kur arti ekzistonte si fenomen dhe akoma jo si kon-



cept, termi “teknologji” përdorej për të shpjeguar “njohuritë mbi zejet”, prandaj edhe skulptura, piktura apo mjeshhtëri të tjera, të cilat sot konsiderohen nga të gjithë si pjesë të artit, në atë kohë njiheshin vetëm si zeje. Edhe nga vetë shpjegimi literal i termit, ku **τέχνη, tekhnē** ka kuptimin e artit, aftësive, mjeshhtërisë, kurse **λογία, logia** ka kuptimin e tërësisë së dijes mbi teknikat, aftësitë, metodat dhe të gjithë procesin që ndiqet gjatë prodhimit të të mirave apo shërbimeve, dallohet akoma edhe më qartë lidhja e hershme midis artit dhe teknologjisë. Madje edhe në greqishten moderne, “Art” shprehet me fjalën “techne”, prej së cilës rrjedhin edhe dy termat e tjerë: “technique” dhe “technology”.

Gjithsesi, në këto krahasime etimologjike dhe kuptimore midis dy termave duhet pasur parasysh se nocioni i “artit”,

në kuptimin që ai mbart sot, është një nocion i formuar vonë, në vitin 1750, nga filozofi gjerman Alexander Gottlieb Baumgarten në shkrimet e tij mbi estetikën. Ndërsa koncepti i teknologjisë është kaq i gjerë sa na vjen edhe si pjesë e një dimensionit hyjnor. Vetë krijimi i botës, qiejve, njeriut dhe gjithësisë, sipas librave hyjnorë, tregojnë se ka një teknikë apo një metodë brenda këtij akti, të shprehur përmes urdhrit “Bëhu!”, e cila kuptohet nga vetë fakti se ka patur një radhë dhe kohë në të cilën është shtrirë i gjithë akti i krijimit. Edhe kjo e vërtetë na bën të kuptojmë se teknika, duke nënkuptuar këtu edhe teknologjinë, janë në themel të ekzistencës së gjithësisë si mjet dhe metodë dhe asnjëherë si mundësi për të konkurruar apo zëvendësuar Krijuesin. Si të tilla, ato nuk kanë se si të mos jenë edhe pjesë e realitetit artistik.

Tradicionalisht, arti dhe shkenca janë parë dhe trajtuar si dy disiplina të ndara nga njëra-tjetra, por, kur ka ndodhur që janë studiuar së bashku, është parë qartazi ndikimi që ato kanë te njëra-tjetra. Prodhuesi amerikan i filmave të animuar, John Laseter, dy herë fitues i Academy Word, ka bërë një përcaktim interesant për marrëdhënien midis teknologjisë dhe artit. “Arti, - thotë ai - e sfidon teknologjinë, ndërsa teknologjia e frymëzon artin.” Në këtë kuptim të përpqesh të ndash teknologjinë nga arti, apo t'i shpallësh ato të kundërta nuk është rruga e duhur për të kuptuar dhe zgjidhur problemet që ka sjellë sot teprimi në përdorimin e teknologjisë.

Shembujt se si teknologjia ndikon tek arti janë të shumta. Në fushën e arteve pamore e gjithë vepra e Leonardo da Vinçit është një nga rastet dhe shembujt më të njohur të këtij ndikimi. Në kërkim të një imazhi sa më të vërtetë dhe bindës të qenies njerëzore, Leonardoja ka vëzhguar dhe studiuar në detaje psikologjinë dhe anatominë e njeriut duke u bërë, kështu, jo vetëm një nga piktorët më të shquar të periudhës së Rilindjes, por edhe një nga artistët më të interesuar për zbulimet shkencore dhe shkencat që merren me studimin e qenies njerëzore e më gjerë.

Në formë dhe në kohë të ndryshme, ndikimet e shkencës dhe të teknologjisë dallohen qartazi edhe në veprën e shumë piktorëve të tjerë. Përgjatë fundit të shekullit të 19 dhe fillimin e 20-tës vëmendja e piktorëve impresionistë dhe postimpresionistë, si Edgar Degas, Vincent van Gogh, Auguste Renoir, Gauguin apo Monet ka qenë e përqendruar tek efektet psikologjike dhe fiziologjike të dritës dhe ngjyrës. Claude Monet, i pranuar dhe i njohur si një nga piktorët më të mëdhenj të peizazhit, e vëzhgonte natyrën duke studiuar ndryshimet e vazhdueshme të perceptimit të saj nën efektet e ndryshimit të dritës dhe ngjy-



Natyrisht që teknologjinë dhe artin pamor i ka bashkuar në vazhdimësi edhe teknologjia e prodhimit dhe e përpunimit të bojërave apo mjeteve, qysh nga ato që janë përdorur për të gdhendur figurat e kafshëve të egra, të zbuluara nga periudha të hershme të njerëzimit në shpella dhe guva, e deri te arti digjital, ku përmes programeve kompjuterike dhe teknologjisë prodhohen instalacione apo vepra të artit fraktal, artit algoritmik, datamoshing etj.

rave. Natyrisht që teknologjinë dhe artin pamor i ka bashkuar në vazhdimësi edhe teknologjia e prodhimit dhe e përpunimit të bojërave apo mjeteve, qysh nga ato që janë përdorur për të gdhendur figurat e kafshëve të egra, të zbuluara nga periudha të hershme të njerëzimit në shpella dhe guva, e deri te arti digjital, ku përmes programeve kompjuterike dhe teknologjisë prodhohen instalacione apo vepra të artit fraktal, artit algoritmik, datamoshing etj.





Akoma më interesante bëhet kjo marrëdhënie kur e shikon se si është zhvilluar ajo midis letërsisë dhe teknologjisë. Jo vetëm teknikat e shkrimit, ku përfshihet stili, gjuha, figurat, apo ku vepra letrare, qoftë në prozë a qoftë në vargje, ka një strukturë të organizuar si një mekanizëm i cili duhet të përcjellë ide dhe emocione, por edhe sa u përket temave të disa prej romaneve më të njohura dhe të pëlqyera ndër vite, tregojnë për

prezencën e shkencës dhe teknologjisë brenda letërsisë. Romanet e letërsisë njohur si letërsia dystopike, shumë afër letërsisë apokaliptike, analizojnë strukturën politiko-ekonomike të shoqërisë duke i vendosur personazhet dhe ngjarjet e tyre në kohët e së ardhmes së zhvilluar teknologjike. Disa nga veprat më të njohura të letërsisë dystopike janë: “1984” i George Orwell-it, romani “Ne” i shkruar në vitin 1921 prej Yevgeny Zamyatin, ku predikohet për



një të ardhme apokaliptike të një shoqërie të ndërtuar mbi sisteme dhe modele të një zhvillimi teknologjik dhe mekanik, apo edhe “Fausti” i J.W.Goethe. Marrëveshja që Fausti bëri me djallin për t’i shitur atij shpirtin, në këmbim të një fuqie dhe kontrolli mbi botën, interpretohet shpesh si një metaforë ndaj pasionit dhe etjes për të kontrolluar botën dhe shoqërinë përmes teknologjisë dhe zhvillimit industrial. Një tjetër vepër letrare, në të cilën elementi teknologjik vjen në formën e këndvështrimit dystopik të shoqërisë, është romani Portokalli mekanik i Anthony Burges, histori mbi të cilin është realizuar edhe filmi me të njëjtin titull i regjisorit Stanley Kubrick.

Krahas përfitimeve që zhvillimi i teknologjisë dhe përdorimi i saj ka sjellë në gjini dhe zhanre të ndryshme të artit, pa dyshim nuk kanë munguar edhe rastet e kundërta. Ka disa momente të rëndësishme në historinë e artit botëror ku aplikimi i zbulimeve teknologjike ka ndikuar duke sjellë ndryshime thelbësore, deri edhe në mënyrën e perceptimit të një veprë arti. Përpyekjet për të fiksuar imazhet në një letër apo pllakë metalike të ndjeshme ndaj dritës

përmes praktikave të oksidimit, janë fillesat e asaj që më vonë do të sillte shpikjen e aparatit fotografik dhe më vonë të kamerës. Për artistët, jo vetëm piktorë, të cilët historikisht kanë qenë në përpjekjet e tyre për lënë dëshmi të jetës, të personazheve të njohur, të jetës kulturore, të ngjarjeve më të rëndësishme apo dhe, thjesht, të imazheve të botës rreth tyre, shpikja e aparatit fotografik duket se ka qenë një sfidë e madhe. Shpikja e aparatit fotografik në mesin e shekullit të 19 është përjetuar jo vetëm si një çudi e madhe e teknologjisë, shkencës, por edhe e artit. Njerëzit e kuptuan shpejt se përmes kësaj shpikjeje të re dëshmitë e ngjarjeve dhe imazhet e botës jo vetëm që mund të kapeshin dhe të fiksoheshin më shpejt, por edhe mund të shpërndaheshin më me lehtësi, duke u bërë të shikueshme nga një numër më i madh shikuesish dhe të interesuarish. Sfidat që fotografia i ka bërë artit pamor nuk është vetëm sa u përket përparësive që ajo dukej se kishte në drejtim të ruajtjes së një informacioni më të mirë, të detajuar dhe të shumtë, sa u përket nevojave të studimit në fushën e historisë, etnografisë, antropologjisë apo fushave të tjera të cilat deri në atë kohë burim imazhi kishin vetëm veprat e artit pamor; sfida vjen e bëhet edhe artistike. Riprodhimi i veprave të artit përmes fotografimit të tyre, prodhimi i albumeve apo shumë orë dokumentarësh televizivë mbi kryeveprat e shumta të artit ka ndikuar, në njërin anë, për një njohje më të madhe të tyre (duke pasur parasysh se jo kushdo ka mundësinë të vizitojë një vepër arti), por nga ana tjetër, edhe problemeve të shumta në kuptimin e tyre përmes përdorimit të teknologjisë. Dallimin e mes kuptimit të veprës kur atë e sodit përballë (nga vendi ku ajo ndodhet) dhe soditjes përmes teknologjisë e ka vënë në dukje edhe kritiku anglez John Berger. Në një cikël dokumentarësh televizivë të titulluar “Mënyrat e të parit” kriti-

ku shpjegon pikërisht atë që ndodh me një vepër arti kur mbi të veprojnë edhe faktorë të tjerë. Një kolonë muzikore e cila mundet të ketë lidhje rastësore dhe jo thelbësore me veprën e artistit, këndet e ndryshme që kameramani ka zgjedhur për ta sjellë veprën në sytë e shikuesit, teksti shpjegues i kritikut apo gazetarit janë elemente të cilat ndërhyjnë midis veprës dhe shikuesit. “Në kohët e sotme pikturat mund të ndryshohen në një mënyrë tjetër: në momentin e riprodhimit ato kthehen në një lloj informacioni që transmetohet në mënyrë të vazhdueshme dhe aty atyre u duhet të ruajnë informacionin e tyre përkundrejt të gjithë informacioneve të tjera që vërtiten rreth saj, për të dalë në të njëjtën faqe ose në të njëjtin ekran. Kuptimi i një imazhi mund të ndryshohet sipas asaj që ju shikoni përçark saj, ose pas asaj që e pason atë”, shpjegon John Berger gjatë emisionit të tij. Madje, kritiku sjell në vëmendjen tonë edhe fakte në dukje fare të parëndësishme, si p.sh. ambienti i dhomës nga ku je duke e parë veprën e artistit në televizor. “Orenditë që ndodhen në ambientin përreth, - shpjegon Berger, - bëhen sfondi apo shoqëruese të objektit të artistit duke ndikuar apo duke e modifikuar mesazhin që vepra do ta transmetonte nëse do të vizitohej në vendin ku ajo ndodhet. Edhe nëse do të kalonim nga njëri kanal televiziv te kanali tjetër, “Në secilin rast impakti i pikturës së Goya-s modifikohet”, thotë Berger gjatë emisionit të tij.

Teatri është pjesë e realitetit artistik, i cili raportin me teknologjinë e ka prej zanafillës së tij. “Një herë e një kohë zëri ishte teknologjia e re”, thotë regjisori i filmave Peter Jackson. A nuk ndihmonte maska në fytyrën e aktorëve në antikitet në forcimin e zërit të tyre? A nuk mund të konsiderohet kjo si fillesa e teknologjisë skenike, e cila amplifikon zërin e artistit në skenë? Amplifikimi i zërit që ka filluar të përdoret sot rëndom në produksionet skenike, bash-

kë me lehtësimin e komunikimit midis skenës dhe audiencës ka prodhuar edhe disa probleme. Një zë i amplifikuar nuk të lejon që të kuptosh apo të përjetosh ngjyrimet e timbrit njerëzor. Shumë prej cilësive dhe nuancave të zërit të artistit humbasin kur ai përfundon në veshin e spektatorit. Kjo është edhe arsyeja që disa gjini të artistit skenik, si opera, ku cilësia vokale e zërit të këngëtarit lirik është përcaktuese për cilësinë e veprës muzikore, përipiqen ta mbajnë larg me fanatizëm përdorimin e kësaj teknologjie në artin e tyre. Teprimi dhe keqpërdorimi që i bëhet sot teknologjisë në produksionet e skenës, sidomos në ato raste kur synimi i regjisorit është për të perfeksionuar iluzionin e së vërtetës në skenë, është rrjedhojë e një qëndrimi të caktuar estetik dhe filozofik ndaj artistit dhe realitetit: konceptit estetik, i cili e përcakton artin si një imitim apo pasqyrim me besnikëri të realitetit. Sipas këtij përcaktimi estetik, vepra e artistit mbetet një kopje, sado e ngjashme apo me besnikëri ta pasqyrojë originalin.

DEBATI

Mendimet e kundërta mbi atë nëse teknologjia e përmirëson gjendjen njerëzore, apo e përkeqëson atë, e kanë drejtuar debatin edhe në fushën e filozofisë. Teori dhe lëvizje pro dhe kundër janë zhvilluar duke prodhuar mendim filozofik. Neoludizmi, anarho-primitivizmi dhe lëvizje të ngjashme kritikojnë përhapjen e teknologjisë, duke argumentuar se kjo dëmton mjedisin dhe i largon njerëzit; nga ana tjetër, përkrahësit e ideologjive, të tilla si transhumanizmi dhe techno-progresivizmi, e shohin përparimin e vazhdueshëm teknologjik si të dobishëm për shoqërinë dhe gjendjen njerëzore.

TEATRI

Duke iu kthyer edhe një herë teatrit, raporti midis tij dhe teknologjisë dallon të jetë thelbësor dhe i rëndësishëm në estetikën teatrore të disa prej emrave më të rëndësishëm të teatrit botëror. Koncepti estetik i përmbledhur në titullin “Drejt një teatri të varfër”, i regjisorit polak Jerzy Grotowski, është një argument i shtjelluar mirë dhe saktë edhe mbi rolin që duhet të ketë teknologjia e skenës në raport me atë se si e shikon misionin e teatrit dhe raportin e tij me spektatorët ky regjisor. Një tjetër emër i rëndësishëm i teatrit evropian, regjisorin rus Anatoli Vassiliev, në shumë raste përdor dritën natyrale në shfaqjet e tij. Prej dritareve të mëdha të godinës në rrugën Povarskia, në Moskë, ku ai ka themeluar shkollën e tij të teatrit, hyn drita drejt e në vendin ku luajnë aktorët. Nuk mungojnë rastet edhe në teatrin shqiptar ku një qëndrim estetik i caktuar kushtëzon në mënyrën e përdorimit të teknologjisë skenike.

Brenda fushës së artit, kur vjen puna për të bërë dallimin midis një vepre origjinale dhe kopjes së saj, bëhen studime, debate dhe shpenzohet shumë energji deri sa të zbulohet cila nga veprat është kopje dhe cila është origjinali. Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e traditës së artit pamor, prej vitit 1400 deri në 1900, ka synuar kryesisht të kopjojë a të imitojë me saktësi format dhe ngjyrat që percepton syri te trupi njerëzor, portreti i tij apo natyra që e rrethon. Edhe pse raporti që duhet të ketë arti me realitetin është pjesë e një diskutimi dhe debati tjetër estetik, teknologjia dhe përdorimi që një artist i bën asaj në punën e tij luan një rol të rëndësishëm në këtë drejtim. Shembuj të një raporti tjetër midis artit dhe teknologjisë, i cili buron prej konceptit estetik që arti nuk është imitim apo pasqyrim i realitetit, por është pjesë e realitetit, nuk mungojnë. Sipas kësaj estetike, realiteti artistik mbetet për t'u zbuluar përmes rrugës nga e zakonshmja tek e jashtëzakonshmja, nga e përkohshmja tek e përjetshmja, nga e përgjithshmja tek e veçanta dhe e papërsëritshmja; kjo është rruga që bën sot dallimin midis punës së zanaçtut dhe


veprës së artistit. Artisti është në kërkim të dritës, ndryshe nga zanaçtut i cili është në kërkim të ngjyrës dhe formës. “S’ia dole të shohësh dritën për arsye se e humbe mendjen në ngjyra dhe në forma. Kur erdhi nata, ngjyrat u mbuluan, atëherë e kuptove se ngjyrat dhe format mund të shihen vetëm përmes dritës”, e qorton artistin përmes vargjeve të poezisë së tij një poet i vjetër arab.

Duke iu kthyer edhe një herë teatrit, raporti midis tij dhe teknologjisë dallon të jetë thelbësor dhe i rëndësishëm në estetikën teatrore të disa prej emrave më të rëndësishëm të teatrit botëror. Koncepti estetik i përmbledhur në titullin “Drejt një teatri të varfër”, i regjisorit polak Jerzy Grotowski, është një argument i shtjelluar mirë dhe saktë edhe mbi rolin që duhet të ketë teknologjia e skenës në raport me atë se si e shikon misionin e teatrit dhe raportin e tij me spektatorët ky regjisor. Një tjetër emër i rëndësishëm i teatrit evropian, regjisorin rus Anatoli Vassiliev, në shumë raste përdor dritën natyrale në shfaqjet e tij. Prej dritareve të mëdha të godinës në rrugën “Povarskia”, në Moskë, ku ai ka themelu-

ar shkollën e tij të teatrit, hyn drita drejt e në vendin ku luajnë aktorët. Nuk mungojnë rastet edhe në teatrin shqiptar ku një qëndrim estetik i caktuar kushtëzon në mënyrën e përdorimit të teknologjisë skenike. Prodhimi i fundit në Teatrin Kombëtar i tragjedisë “Makbeth” apo prodhimi tjetër skenik “Qefharami” ose “Edipi sipas Ioneskos”, ndërtuar mbi parimet dhe estetikën e teatrit polifonik janë disa nga këta shembuj. Për ta qartësuar disi më shumë mënyrën se si qëndrimi estetik është përcaktues në rolin dhe në mënyrën e përdorimit të teknologjisë në një vepër arti, po citoj këtu një paragraf nga estetika e teatrit polifonik.

“Fjalëve në letërsi, përmes metaforizimit, u zgjerohet maksimalisht fusha semantike (kuptimore) duke arritur kështu te një përdorim plastik i tyre. Edhe në teatër duhet të kërkohet i njëjti proces. Gjesti, lëvizja komunikimi dhe i gjithë ambienti skenik nuk mund të jenë një imitim i asaj çfarë shikojmë dhe dëgjojmë në jetën e përditshme; ndryshe përse duhet të kemi nevojë për të? Artisti i skenës duhet të jetë në kërkim të një gramatike të re teatroreë cila ndihmon që komunikimi me spektatorët të realizohet përmes së vërtetës dhe jo iluzionit të së vërtetës.”

Rendja pas iluzionit ka sjellë dobësimin e komunikimit të vërtetë duke e zëvendësuar atë me komunikimin virtual brenda një realiteti virtual. Produkt i realitetit virtual është edhe “vetmia digjitale” e cila po kthehet në një shqetësim të madh social. Simon Mainwaring, një specialist i mediave sociale dhe autor i librit “Ne të parët”: Si marka dhe konsumatorët përdorin mediat sociale për të ringritur kapitalizmin dhe për të ndërtuar një botë të re shkruan se: “Teknologjia na mëson se duhet të mbetemi njerëz”, por a po ndodh kjo? A është koha për ta riparë raportin me teknologjinë? A duhet të rishikojmë mënyrën se si e përdorim dhe rolin e saj në aktivitetin tonë njerëzor? A po i transformon teknologjia shijet, kon-



“ Gjesti, lëvizja komunikimi dhe i gjithë ambienti skenik nuk mund të jenë një imitim i asaj çfarë shikojmë dhe dëgjojmë në jetën e përditshme; ndryshe përse duhet të kemi nevojë për të? **Artisti i skenës duhet të jetë në kërkim të një gramatike të re teatroreë cila ndihmon që komunikimi me spektatorët të realizohet përmes së vërtetës dhe jo iluzionit të së vërtetës.**”

ceptet dhe vetë mënyrën e të jetuarit? Në këtë situatë, kur përdorimi i teknologjisë rrezikon të kontrollojë përditshmërinë e shoqërisë njerëzore shprehja e historianit norvegjes Christian Lous Lange se “Teknologjia është një shërbyese e mirë, por një pronare e rrezikshme” mbetet një paralajmërim me vlerë.

Rrugët për të realizuar një kontroll dhe një bashkudhëtim më të mirë me teknologjinë mundet të jenë të ndryshme dhe të shumta, por njëra hapet pas shprehjes së Stiv Jobs. “Arsyeja se përse Apple është i aftë për të prodhuar produkte si iPad është sepse ne gjithnjë jemi përpjekur të punojmë në pikën ku takohet arti me teknologjinë.” ■

Liberalizimi i tregut farmaceutik dhe, sidomos, teknologjitë e përpunimit të shtesave ushqimore (vitamina, integratorë mineralë dhe me origjinë bimë), kanë bërë që, sidomos në disa zinxhirë me emër farmaceutikë, të humbasë kufiri mes ushqimit dhe barnave.

Vetë integratorët vitaminikë, që po përdoren gjithnjë e më tepër, janë zona gri gjithnjë e më e trashë në këtë kufi. Nëse do të vëzhgojmë kompanitë që prodhojnë ushqime artificiale ose konservantë, ngjyrues apo çfarëdo duhet për to, do të mësojmë se së fundmi ato po blihen nga multinacionalet farmaceutike.

KUR NE VËMË TË ZIEJË NJË ÇAJ MALI, në fakt jemi duke përgatitur një lekoks, ose një nga aktet më të vjetra të teknologjisë në farmaci. Kjo për të treguar sa e lashtë është teknologjia në farmaci dhe si e ka shoqëruar ajo njerëzimin. Po përgatitja e verës, distilimi i rakisë? Për të mos folur pastaj për jetët që ka shpëtuar penicilina gjatë luftërave botërore.

Po të ndalemi pak, kuptojmë se farmacia, vetë, dhe teknologjia e përdorimit të saj janë pionere të zhvillimit, të cilat kanë turbulluar (dhe po e bën akoma) më shumë





Teknologji në kapsulë



ADA ÇAPI

DEBATI

Farmaceutica dhe zhvillimi i saj teknologjik, për vite me radhë, janë parë shpesh si ai djali plangprishës që askush s'e do por që të gjithë ia kanë nevojën. Ndërkohë, teknologjia vraponte, nuk ecte. Ndërkohë, njerëzimi përmirësonte çdo detaj të jetës. Atëherë pse na tremb ne zhvillimi në teknologjitë farmaceutike? Jemi të gatshëm që të përdorim antibiotikët më të fundit, insulinat që vetinjektohen, antiviralët që AIDS-pozitivët i marrin si vitamina të përditshme, por kur vjen puna te tabletat që impiantohen nën lëkurë dhe lëshojnë ilaçin në mënyrë të ngadaltë (dhe të kontrolluar) për një kohë të gjatë, kemi frikë. E mbani mend shiringën prej qelqi, burim i kaq shumë hepatiteve? E pra, shiringat e para njëpërdorimshme, hasën rezistencë dhe pak besueshmëri në personelin mjekësor. Vetëm para pak vitesh, kur flitej për barna antitumorale që përftoheshin nga plazma e gjakut dhe që luftojnë në mënyrë specifike vetëm qelizat kanceroze, shumë prej nesh e krahasuan përparimin me Star Trekun. Sot, këto barna i gjen edhe në qendrën spitalore universitare.

ujëra dhe ndërgjegje sesa po bën sot interneti. Kujtoni vitet e pasluftës, atëherë kur zhvillimi ekonomik dhe rritja e popullsisë shkonin krah për krah me familjen e buzëqeshur konservatore të viteve '50? E imagjinoni dot bumin që shkaktoi atëherë pikërisht pilula kontraceptive apo preservativi? Së bashku me abortin, ato janë shnërruar, ndoshta, në bombën më e madhe etike mbi shoqërinë e pasluftës. Por shoqëria jonë nuk është bërë imune në pranimin e së resë, aq më shumë kur kjo vjen me pankartën e zhvillimit. Sfidat e fundit është ajo e ruajtjes dhe e përdorimit për kurimin e sëmundjeve gjenetike të materialit gjenetik të placentës. Ende sot, sidomos në shoqëri me rrënjë të forta fetare, mbetet një limit.

Farmaceutica dhe zhvillimi i

saj teknologjik, për vite me radhë, janë parë shpesh si ai djali plangprishës që askush s'e do por që të gjithë ia kanë nevojën. Ndërkohë, teknologjia vraponte, nuk ecte. Ndërkohë, njerëzimi përmirësonte çdo detaj të jetës. Atëherë pse na tremb ne zhvillimi në teknologjitë farmaceutike? Jemi të gatshëm që të përdorim antibiotikët më të fundit, insulinat që vetinjektohen, antiviralët që AIDS-pozitivët i marrin si vitamina të përditshme, por kur vjen puna te tabletat që impiantohen nën lëkurë dhe lëshojnë ilaçin në mënyrë të ngadaltë (dhe të kontrolluar) për një kohë të gjatë, kemi frikë. E mbani mend shiringën prej qelqi, burim i kaq shumë hepatiteve? E pra, shiringat e para njëpërdorimshme, hasën rezistencë dhe pak besueshmëri në personelin mjekësor. Vetëm para pak vitesh,

kur flitej për barna antitumorale që përftohën nga plazma e gjakut dhe që luftojnë në mënyrë specifike vetëm qelizat kanceroze, shumë prej nesh e krahasuan përparimin me Star Trekun. Sot, këto barna i gjen edhe në qendrën spitalore universitare.

Atëherë, çfarë na tremb te përdorimi i teknologjive në mjekësi, e specifikisht, në farmaceutikë?

Sipas meje, kemi të drejtë të kemi frikë dhe ajo që na tremb është vetja. Le të shpjegohe mi: Në ditët e sotme informacioni përbën sfidën e re të farmaceutikës. Sa më i plotë, i shpejtë, e i personalizuar të jetë ai, aq më mirë dyshja “mjek familjeje-farmacist” i shërben pacientit. Në Shqipëri ka hyrë që tani “zh”-ja e këtij informacioni, që është receta elektronike. Megjithatë nuk kemi akoma “a”-në e tij, që është databaza e pacientëve apo kartela klinike e çdo pacienti, përsëri përbën një hap shumë të rëndësishëm përpara. Shpresoj, shumë shpejt, edhe te ne do të mbyllet online cikli “vizitë te mjeku i familjes-farmacit/recetë elektronike-asistencë spitalore”. Në qendër të këtij cikli është pacienti me kartelën e tij online. Por, a jemi në gjendje ne të ruajmë 100% të dhënat private të kësaj karteje, kur bankat që tani na dërgojnë sms nëpërmjet operatorëve telefonikë? A është gati shoqëria civile, shoqatat në mbrojtje të pacientit të dëgjohen në mbrojtje të këtyre të dhënave që do të peshoheshin me flori nga kompanitë farmaceutike?

Kjo është çështja e parë. Por ekziston ende faktori kosto. Në ndryshim nga sa thuhet, shëndetësia kushton dhe kushton shumë. Barnat e reja për të cilat folëm, ato që shpëtojnë ose zgjasin jetë të kërcënuara nga kanceri, kushtojnë jashtëzakonisht shtrenjtë dhe nga ana tjetër, për shkak të ndotjes, duhanpirjes apo jetesës jocilesore, sëmundje si kanceri, leucemia po shtohen shumë.

Kush dhe si vendoset se cili pacient ka

të drejtë për mjekim? Nëse spitali i ofron falas, a e mbulon ai/shteti të gjithë kurën, apo në përjekje për të kuruar sa më shumë pacientë, i lë përgjysëm këto kura rrugës?

Le të kthehemi tani te banaku i farmacistit, ai i sotmi. Në vendet e zhvilluara, gjithnjë e më shumë analiza diagnostikimi kryhen tashmë në farmaci. Në fakt, vetë firmat farmaceutike që prodhojnë pajisje diagnostikimi, prodhojnë së fundmi edhe pajisje të përshtatshme për përdorim të thjeshtë nga ana e farmacistit. Sot matet glukozja, kolesteroli, niveli i hormoneve në gjak, matet dendësia e kockave e kaq e kaq teste të tjera. Kjo bën që mes recetës elektronike, analizave në farmaci, pacienti ta kthejë pothuajse të gjithë raportin me mjekun online. Edhe shitja e shumë barnave online, e lejueshme në mjaft shtete, e bën shërbimin mjekësor të ardhshëm pothuajse të gjithin online.

Por a ka besim pacienti te ky shërbim? A





do ta zëvendësonte mamaja ime farmacistin e saj të besuar të lagjes me një zë kompjuterik? Këto pyetje lënë vend për diskutim, por duhet thënë që edhe ime më, si shumë prindër të tjerë, është e detyruar të përdorë Skype.

Ndërkaq sfidat në botë janë të tjera. Sot shtrohet një pyetje sa e thjeshtë, aq e ndërlikuar: përballë farmacistit, sot, kemi një pacient, apo një klient? Mendoj se janë të dyja.

Liberalizimi i tregut farmaceutik dhe, sidomos, teknologjitë e përpunimit të shtesave ushqimore (vitamina, integrorë mineralë dhe me origjinë bimore), kanë bërë që, sidomos në disa zinxhirë me emër farmaceutikë, të humbasë kufiri mes ushqimit dhe barnave. Vetë integrorët vitaminikë, që po përdoren gjithnjë e më tepër, janë zona gri gjithnjë e më e trashë në këtë kufi. Nëse do të vëzhgojmë kompanitë që prodhojnë ushqime artificiale ose konservantë, ngjyrues apo çfarëdo duhet për to, do të mësojmë se së fundmi ato po blihen nga multinacionalet farmaceutike.

Për ta thjeshtuar idenë, mund të themi se është vetëm çështje kohe që do të ushqehemi me pilula! Pra, në farmacinë e së ardhmes, do të kemi farmacistin që ka në dorë të gjithë kartelën tonë klinike qysh nga lindja, farma-

cistin që na bën gjithnjë e më shumë teste në farmaci, që na lëshon recetën dhe që na kujton me shkrim në celular nëse ka kaluar koha e marrjes së ilaçit. Do të kemi farmacistin që ndryshon kurën në bashkëpunim me mjekun dhe që, njëkohësisht, do të na shoqërojë te reparti ngjitur për të marrë ushqimin/integratorin e duhur për të ulur kolesterolin.

Nuk është kaq e largët, më besoni! Diçka më larg (për ne) janë aparaturat që bëjnë të mundur monitorimin shëndetësor dhe farmaceutik të një të moshuari që jeton vetëm nga farmacisti i tij. Diçka akoma më larg (për botën) janë dispozitivët që parashikojnë statistikisht prirjen e zhvillimit të një sëmundje gjenetike apo të një tjetre te pacienti. Por, me zhvillimin dhe vëmendjen që ka industria farmaceutike për pacientin, edhe për atë me sëmundje të rrallë, më besoni, nuk është kaq larg. Për shembull "Takeda", një nga industritë farmaceutike më me emër, së fundmi ka kërkuar nga kompanitë ajrore të deklarojnë deri në detaje përbërësit e dietës ushqimore, në mënyrë që të shmangen problemet e pacientëve me IBS (irritable bowel syndrome).

A jemi gati? A jemi gati t'ia lëmë në dorë nënës nëse do të ndërhyjë gjenetikisht për të shëruar sëmundjen te fëmija? A jemi gati ne të paguajmë taksa të tilla që të mund të kurohen një grusht njerëzish me sëmundje të rralla me barna të shtrenjta? A jemi gati të marrim gjithnjë e më shumë pilula me barna, bimë, vitamina, minerale, megjithëse e dimë se, sot, trupat e vdekur treten në trefishin e kohës që treteshin më parë për shkak të konservantëve?

Unë them se po! Po, nëse ngremë zërin të kontrollojmë multinacionalet që të ulin çmimet, nëse kontrollojmë atë çka shkruhet mbrapa asaj që konsumojmë, nëse luftojmë që të ruhet privatësia e të dhënave nga kush do t'i përdorë për përfitim.

Dhe në këtë luftë, kemi nevojë për informacion, kemi nevojë për farmacistin e besuar. ■



CATERING

TEL: +355 67 20 46 540



#Icebreaker */First of it's kind in the hospitality market of Tirana/*

+355 (0) 422 112 21 ♦ info@plazatirana.com ♦ www.plazatirana.com


THE
PLAZA
TIRANA
☆☆☆☆
Excellence redefined.